JETA E SAHABËVE

Ebu Bekri *r.a.*

Pishtari i Besnikërisë

RESHIT HAJLLAMAZ



PRIZMI

Ebu Bekri

Pishtari i Besnikërisë

Ebu Bekri

Pishtari i Besnikërisë

Reshit Hajllamaz

PRIZMI

© Të gjitha të drejtat janë të rezervuara

Ndalohet shumëfishimi, botimi, fotokopjimi dhe depozitimi
elektronik, mekanik apo me anë të ndonjë sistemi tjetër regjistrimi
i teksteve dhe figurave të krejt librit apo të një pjese të tij,
pa leje me shkrim nga shtëpia botuese

EBU BEKRI

Pishtari i Besnikërisë

Përktheu: Erjon H. SUKAJ
Redaktoi: Arbër QEMALI

Design: Indrit ISUFI

ISBN: 978-9928-156-06-8

Shtëpia Botuese "PRIZMI"
Adresa: Rr. Kajo Karafili
P.Bimbashi, A.4, Tiranë
www.prizmi.com

Shtypur në shtypshkronjën Emal, 2013

PËRMBAJTJA 09

Parathënie 9
Ambienti ku lindi dhe u rrit 11
Emri dhe titulli 13
Një profesion në zë 16
Muhamed i besueshmi 17
Lidhjet e gëzueshme 19
Të gjithë ishin të vetëdijshëm për praninë e tij 24
Kujtime të paharrueshme 27
Statusi shoqëror i Ebu Bekrit në Mekë 29
Drejt bashkimit të lumtur 31
Fitimi i një jete të tërë 40
Duke përdorur pozitën shoqërore 41
Ebu Bekri ndihmon të varfrit 43
Garë në shërbim të njerëzimit 46
Udhëtimi në Abisini 55
Bojkoti 60
Besniku 62
Emigrimi i shenjtë dhe shpirti i miqësisë 65
Vitet e para në Medinë 74
Funhasi dhe Ebu Bekri 77
Drejt betejës së Bedrit 80
Njeriu i betejave 83
Pozita e Ebu Bekrit pranë Profetit 86

Maturia dhe aftësia e tij për të kuptuar 90
Shenjat e para të largimit 93
Njeriu i besueshmërisë dhe sigurisë 95
Modesti dhe sinqeritet 98
Filantropisti 100
Dita e triumfit 106
Lideri i pelegrinëve 110
Haxhi i lamtumirës 111
Koha e ribashkimit 112
Drejt Kalifatit 117
Kundërshtim i pavlerë 121
Sjellja e tij ndaj trashëgimtarëve 123
Hixhazi tronditet nga polemikat 125
Zgjidhje e sigurt ndaj refuzimit të zekatit 127
Episode të daljes nga feja 129
Profetë të rremë 130
Ushtria e Usames 132
Paqe dhe qetësi 136
Vështirësi ekonomike 138
Devotshmëria dhe frika ndaj Allahut 140
Bashkimi me Umu Ejmenin 144
Dy vite të bekuar 146
Kur bie perdja 147
Trashëgimia e tij 151
Jeta familjare 153

PARATHËNIE

Njeriu është përgjegjës për detyrat që Allahu i Plotfuqishëm dhe i Dërguari i Tij i ngarkojnë, pavarësisht nga pozita që ai ka në shoqëri. Së bashku me namazet ditore, agjërimin, zekatin dhe kryerjen e Haxhit, vepra të tilla si, të ndash bukuritë e besimit me të tjerët, t'i paralajmërosh ata për rrugët e gabuara, t'i udhëzosh ata në rrugën e lumturisë së përjetshme dhe të përpiqesh të ndërtosh një jetë sociale në të cilën fryjnë puhizat e Parajsës përmes një atmosfere hyjnore, mund të konsiderohen gjithashtu si obligime fetare. Kjo do të thotë se të ftuarit e njerëzve në rrugën e drejtë është detyrë e çdo myslimani, pavarësisht nga gjinia, pozita, apo dhuntitë personale të karakterit.

Në lidhje me këtë, Ebu Bekri radijallahu anhu, mund të merret shembull si njeriu që arriti majat midis Sahabëve. Që nga çasti kur u takua me Profetin Fisnik paqja qoftë mbi Të!, Ebu Bekri u bë një model për njerëzimin. Historia magjepsëse e jetës së tij fillon në tregun e qytetit. Një jetë në përpjekje të pandërprerë e cila do ta ngrinte atë në rangun e Kalifit. Këmbëngulja, qëndrueshmëria dhe lavdia e Ebu Bekrit shërben si burim frymëzimi për të gjithë myslimanët e sotëm.

Të japësh të gjithë pasurinë në rrugën e Allahut në kohë të vështira, tregon një sakrificë të paimitueshme. Për më tepër, ta dorëzosh jetën tënde të çmuar në emër të Atij që jep jetë, është një virtyt që të nderon me përjetësinë. Ata të cilët arrijnë nivele të tilla të virtytit do të jenë të mbrojtur nga gërryerja shpirtërore e kohës. Gjithashtu, ata do të lundrojnë drejt hapësirave magjepsëse të

dhuruara nga Zotëruesi i Vërtetë i kohës dhe i hapësirës. Si mund të fitohet një nder i tillë? Në këtë libër do të lexoni një jetë që shërben si shembull. Le të përfitojmë të gjithë nga jeta e Ebu Bekrit, simbolit të besnikërisë!

AMBIENTI KU LINDI DHE U RRIT

Babai i tij ishte Osman ibn Amr (*Ebu Kuhafe*) ndërsa e ëma Selma bint Sehr (*Umu Hajr*). Ai lindi 3 vjet pas ngjarjes së elefantit, kur Ebreheja, mbreti i Jemenit, erdhi për të pushtuar Mekën me ushtrinë e tij me elefantë. Nëna e Ebu Bekrit ishte e vajza e xhaxhait të Ebu Kuhafes.

Ato kohë, Selma, e mbiquajtur edhe "nëna e bekimeve" nga banorët e Mekës, po kalonte një periudhë të vështirë, pasi të gjithë fëmijët meshkuj që kishte lindur më parë nuk i kishin jetuar. Zemra po i digjej nga dëshira për të pasur një djalë. Kishin kaluar 2 vjet nga ngjarja e elefantit dhe Selma ishte përsëri shtatzënë. Gëzimi mund të lexohej qartë në sytë e saj. Kësaj radhe kishte një parandjenjë të mirë. Ajo ishte shumë e sigurt se ky fëmijë do të ishte djalë. Megjithatë, ndjeu se duhet të bënte diçka ndryshe në mënyrë që dëshira e saj të bëhej realitet. Prandaj, ajo bëri një premtim që djali t'i shërbente Qabesë nëse do të jetonte. Këtë premtim e shpalli haptazi. Asokohe, ky lloj premtimi konsiderohej i shenjtë dhe duhej përmbushur me përpikëri.

Koha kishte ardhur dhe "nëna e bekimeve" filloi të ndjente dhimbjet e lindjes. Ajo do të sillte në jetë një fëmijë të bekuar. Megjithëse ishte pothuajse e sigurt se do të lindte djalë, vazhdonte të ishte e shqetësuar. Arsyeja e këtij ankthi ishte frika për jetën e tij. Ajo u betua se sapo të lindte djalin, do të shkonte pranë Qabesë dhe do t'i lutej përgjëruesherm Zotit të saj. Synimi i saj ishte kjo lutje e përvuajtur: "Allahu im! Dhuroji jetë të gjatë fëmijës tim! Shpëtoje atë për hatrin tim!"[1]

[1] Ibn Haxher, *el Isabe*, 4/171.

Shkalla e sinqeritetit në lutjen e saj ishte garancia më e madhe për pranimin. Sigurisht që një përgjërim aq i thellë nuk mund të kthehej mbrapsht, djali i Ebu Kuhafes kishte lindur gjallë.

EMRI DHE TITULLI

"Nëna e bekimeve" nuk ishte një grua që shkelte premtimin. Duhej gjetur një emër për të porsalindurin. Ajo ia vuri emrin Abdul Ka'be, që do të thotë shërbëtor i Qabesë. Ebu Kuhafe nuk e kundërshtoi sepse Qabeja ishte një vend i nderuar. Për më tepër, akoma nuk ishte harruar fati i kobshëm i ushtrisë së Ebrehesë që kishte ardhur për ta shkatërruar.

Si mund të mos e respektoje Qabenë? Ajo ishte shtëpia e parë në Tokë e ndërtuar për adhurimin e Allahut. Qabeja ishte gjithashtu një vend ku çdokujt i kujtohej Allahu dhe sa herë që përmendej Allahu njerëzit mendonin për Qabenë. Për këtë arsye Ebu Kuhafe e thërriste shpesh të birin me emrin Abdullah, që do të thotë shërbëtor i Allahut. Ai dëshironte që i biri të bëhej një shërbëtor i devotshëm i Qabesë.

Në shoqërinë paraislamike të Mekës femrat nuk gëzonin konsideratë dhe ishin pa vlerë, kështu që vetëm e ardhmja e meshkujve merrej seriozisht. Prandaj, emri që Selma kishte zgjedhur për të birin u harrua shpejt dhe mekasit filluan ta thërrasin fëmijën Abdullah ibn Osman. Këtë emër e kishte zgjedhur Ebu Kuhafe.

Asokohe njerëzit njiheshin nga titujt e tyre. Për pasojë, atij iu dha titulli "Atik" sepse ndryshe nga fëmijët e tjerë para tij, ai kishte jetuar. Veç kësaj ai vinte nga një familje fisnike. Fjala Atik do të thoshte "një njeri që del nga robëria në liri" ose "një njeri që kishte devijuar nga rruga e tyre përpara tij dhe kishte mbijetuar."

Banorët e Mekës e kishin miratuar këtë titull për Abdullah ibn

Osmanin thjesht sepse fjala Atik kishte edhe kuptimin e bukurisë dhe ata që shihnin fytyrën ndritshme të Abdullahut mbusheshin me admirim.

Gjuha arabe është shumë e pasur në sinonime, kështu që fjala Atik nuk kufizohej vetëm në këto interpretime. Ajo gjithashtu i referohej personave që njiheshin për bujarinë e tyre në popull. Pa dyshim, Ebu Bekri do të ishte gjithmonë i pari në këtë garë.

Gjithsesi, ai do të njihej më vonë si Ebu Bekri, që do të thoshte "babai i Bekrit". Nuk dihet si e mori ai këtë emër, sepse ai kurrë nuk pati një djalë me emrin Bekr. Sidoqoftë, kur analizojmë kuptimin e emrit Bekr, mund të bëjmë disa parashikime. Fjala Bekr mund të jetë rrënjë e shumë kuptimeve si, të sulmosh, të drejtosh, pika e parë e shiut, agim i mëngjesit, të falësh namazin në kohën e duhur, të arrish predikimin në kohë, mjalti i bërë nga lulet e para të pranverës, frutat e para të pemës dhe tokë pjellore, etj.

Sipas një këndvështrimi tjetër, kjo fjalë përdoret për të përshkruar një fis të madh dhe të fuqishëm. Nëse e analizojmë fjalën nga një pikëpamje terminologjike, arrijmë në përfundimin se pothuajse të gjitha përkthimet e mësipërme mbartin kuptimin e të qenit i pari. Për pasojë, pavarësisht nga prejardhja apo nga kuptimet që ai mbart, emri i Ebu Bekrit përputhet plotësisht me jetën e tij të pashembullt. Ai ishte burri i parë që përqafoi besimin dhe i ofroi mbështetje të Dërguarit të Allahut paqja qoftë mbi Të!. Ai ishte gjithashtu një lider në shumë lëvizje dhe aktivitete të ndërmarra nga Profeti Fisnik. Të gjithë janë të një mendimi se emri i Ebu Bekrit qëndron i pari pranë atij të Profetit paqja qoftë mbi Të!.

Pionieri i besnikërisë, i cili njihej me emrat Abdul Ka'be, Abdullah, Atik dhe Ebu Bekr, pas ditës kur dëshmoi Njëshmërinë e Allahut në prani të Profetit Fisnik, e harroi titullin e tij Abdul Ka'be. Ai e kishte përqafuar Islamin shumë shpejt pas kthimit të Profetit nga shpella Hira. Tashmë, i Dërguari i Allahut e thërriste

atë Abdullah dhe Atik, një burrë që kishte shpëtuar veten nga zjarri i Xhehenemit.

Një ditë, Profeti i Nderuar e kishte parë Ebu Bekrin duke ardhur nga larg. Ai u kthye nga ata që kishte pranë dhe tha:

"Nëse ndonjë nga ju dëshiron të shikojë një njeri që e ka shpëtuar veten nga zjarri i Xhehenemit, le të shikojë këtë që po vjen."[2]

Tipari më i përshtatshëm që përputhej me emrin Ebu Bekr ishte titulli Siddik, që do të thotë "Besnik." Më vonë ai do të njihej vetëm me këtë titull. Ai kishte hedhur hapin e parë në këtë rrugë dhe kishte zënë vendin e parë në besnikëri dhe besueshmëri. Ashtu si emri, edhe jeta e tij shërben si një shembull për brezat e mëvonshëm.

Për më tepër, atij i kishin vënë titullin "*Sahib*"[3] për praninë e tij me Profetin paqja qoftë mbi Të! në shpellë, gjë e cila ishte përshkruar edhe në Kuran; "*Atka*"[4] për atributin që Kurani përdor për ata që e shpenzojnë pasurinë e tyre në rrugën e shenjtë dhe që lirojnë skllevërit; "I dyti nga ata të dy,"[5] në përshkrimin që bën Kurani Famëlartë për qëndrimin e tyre në shpellë gjatë Hixhretit; dhe "*Euuah*,"[6] për natyrën e tij të ndjeshme, dhembshurinë, frikën dhe nënshtrimin e thellë ndaj Allahut.

[2] Hakim, *el Mustedrek*, 3/64 (4404).
[3] Teube, 40.
[4] Lejl, 17.
[5] Teube, 40.
[6] Ibn Sa'd, *Tabakatu'l Kubra*, 3/170.

NJË PROFESION NË ZË

Meka ishte një qytet i njohur për tregtinë dhe tregtarët e zotë. Kurejshët në veçanti bënin tregti me karvanë gjatë gjithë vitit në Jemen dhe në Damask. Në këto kushte, të rinjtë e Mekës qëndronin gjithë kohën nëpër tregje për të mësuar dhe marrë përvojë në tregti.

Ebu Bekri ishte një djalosh i ri që sapo kishte lënë lojërat e fëmijërisë dhe kishte filluar të ndiqte karvanët për në Jemen dhe Damask. Për të qenë tregtar i suksesshëm duhet të kishe aftësi të mira, cilësi këto që Ebu Bekri i zotëronte më shumë se kushdo. Ebu Bekri kishte lënë përshtypjen e një njeriu të besueshëm dhe të ndershëm tek ata njerëz që kishte takuar. Ai nuk e shihte udhëtimin për tregti si një aventurë, as nuk e përdorte pasurinë e tij për të shtypur të tjerët. Kështu ai ishte bërë një tregtar i njohur në të gjithë zonën. Në shumë pak kohë pasuria e Ebu Bekrit kishte arritur në dyzetmijë dirhemë.[7]

Ebu Bekri ishte bërë i njohur jo vetëm për aftësitë në tregti, por edhe për edukatën dhe mirësjelljen. Ai shpalosi një tjetër maturi dhe seriozitet në krahasim me bashkëmoshatarët e tij. Ndryshe nga të rinjtë e tjerë, ai nuk adhuronte idhujt, nuk pinte alkool dhe nuk ishte përzier në imoralitet.

Pavarësisht se jetonte në një ambient injorance dhe shthurjeje, askush nuk mund të gjente gabimin më të vogël tek Ebu Bekri dhe as ta kritikonte atë për sjellje jo të mira. Ai ishte aq i pastër, saqë e vetmja gjë që idhujtarët nuk pëlqenin tek ai ishte besimi.

[7] Ibn Ebi Shejbe, *Musannef*, 7/12 (33862).

MUHAMED I BESUESHMI

Në Mekë ishte një person të cilin Ebu Bekri e ndiqte me admirim. Virtytet e këtij njeriu bëheshin të dukshme gjithnjë e më shumë dhe të tjerët kishin filluar ta thërrisnin "I besueshmi" (*El Emin*). Megjithëse një pjesë vazhdonin ta thërrisnin Muhamed, shumica e mekasve i referoheshin me këtë titull.

Muhamed i besueshmi ishte dy vjet më i madh se Ebu Bekri. Për këtë arsye Ebu Bekri e respektonte atë si vëllain e madh. Muhamedi dhe Ebu Bekri ishin rritur së bashku thjesht sepse Meka ishte një qytet i vogël dhe të gjithë njiheshin me njëri tjetrin. Mekasit ishin mësuar t'i shihnin gjithmonë së bashku, kështu që miqësia e tyre ishte e qartë në sytë e të gjithëve. Nëna e tij, Selma, një herë kishte thënë: "Ata dukeshin si binjakë."[8]

Ata ngjanin shumë në karakter dhe në sjellje. Prandaj kishin një miqësi aq të konsoliduar që nga dita e parë që ishin takuar. Ebu Bekrit i pëlqente shoqëria e Muhamedit dhe kur largohej nga Meka për arsye tregtie e ndjente mungesën e shokut të tij të ngushtë. Ai ishte personi i parë që takonte kur kthehej nga udhëtimet. Muhamed i besueshmi ishte njeri i veçantë. Ai përhapte një ndjenjë besimi dhe sigurie tek ata që e rrethonin. Kjo vlente edhe për Ebu Bekrin. Për këtë arsye, ai u gëzua pa masë kur mori vesh se Muhamedi do të shkonte me karvanin e radhës për tregti. Ky ishte një shans i madh për Ebu Bekrin. Gjatë udhëtimit ai përjetoi momente të cilat nuk do t'i harronte gjatë gjithë jetës. Ebu Bekri ishte pjesëtar i karvanit që drejtonte Muhamed i be-

[8] Halid Muhamed, *Xhae Ebu Bekr*, 30

sueshmi. Ky karvan i përkiste Hatixhes së nderuar. Një incident që ndodhi ende pa u larguar nga Meka, ishte një shenjë për ngjarjet e mahnitshme që do të ndodhnin gjatë këtij udhëtimi. Sapo ishin nisur në shkretëtirën përvëluese, një re e vogël u shfaq mbi kokën e Muhamedit. Kjo re misterioze që e ndiqte ngado dukej sikur donte ta mbronte nga të nxehtit duke i bërë hije. Gjatë këtij udhëtimi, Ebu Bekri u bë dëshmitar i fjalëve të murgut të krishterë Nastura. Murgu deklaroi se Muhamed i Besueshmi do të ishte Profeti i fundit të cilin njerëzimi e priste prej shumë kohësh. Së bashku me Mejserën, Ebu Bekri kishte dëgjuar me lot në sy parashikimin që murgu kishte bërë për "burrin që po pushonte nën hijen e pemës".

Ky lajm për Muhamedin nuk i habiti të pranishmit, pasi edukata dhe sjellja e tij e kishte shfaqur me kohë karakterin e tij. Ai e kishte mbajtur gjithmonë fjalën dhe kishte përmbushur çdo premtim plotësisht. Kjo sjellje e tij ishte pasqyruar tek i gjithë karvani duke u bërë i besueshëm për tregtarët e tjerë.

Historitë që Ebu Bekri kishte dëgjuar nga dijetari plak Uaraka ishin akoma të freskëta në mendjen e tij. Në një kohë ku errësira e injorancës kishte pllakosur mbi shoqërinë arabe, ishin të pakët njerëzit që flisnin për nevojën e Dritës. Historitë që kishte dëgjuar dhe ndodhitë e jashtëzakonshme që kishte parë gjatë udhëtimit po e çonin Ebu Bekrin tek i njëjti person. Ai nuk ishte tjetër veçse shoku i tij i dashur, Muhamedi.

Pas martesës së Muhamedit me Hatixhen, këta të fundit u vendosën në shtëpinë e Hatixhes, e cila banonte në një lagje me Ebu Bekrin. Këto zhvillime të fundit i mundësuan Ebu Bekrit të takohej më shpesh me Muhamedin.

Për më tepër, ata të dy kishin edhe lidhje farefisnore. Emri Murrah ibn Ka'b, ishte i përbashkët në pemën gjenealogjike të Muhamedit dhe të Ebu Bekrit.

LIDHJET E GËZUESHME

Ebu Bekri jetoi në një epokë ku injoranca kishte arritur kulmin. Ngjarjet negative që ndodhnin përreth ishin të atilla që mund ta paralizonin botën shpirtërore të njeriut. Megjithatë, kjo nuk do të thoshte se nuk kishte progres në emër të virtytit dhe të drejtësisë. Megjithëse të pakët, ende kishte njerëz që i kishin shpallur luftë injorancës dhe idhujtarisë. Këta njerëz flisnin vazhdimisht për moralin dhe të drejtën. Ebu Bekri kishte interes të madh në këto çështje dhe i ndiqte mbledhjet e tyre rregullisht. Në veçanti ai vizitonte me dëshirë disa persona si, Uaraka, Zejd ibn Amr dhe Kus ibn Said. Sytë e këtyre njerëzve gjithnjë ishin të drejtuar drejt së përtejmes. Ata kërkonin të Dërguarin e fundit që do t'i sillte njerëzimit shpëtimin. Kjo ishte arsyeja më e fortë që mbante lidhjen dhe dashurinë e tyre për njëri-tjetrin. Ata thurnin poezi kur flisnin për Të ose kur përmendnin emrin e Tij midis njerëzve.

Një ditë Ebu Bekri dëgjoi një bisedë ndërmjet Zejd ibn Amrit[9] dhe Umeje ibn Ebi Selt[10].

Zejdi i tha Umejes:

"Asnjë fe nuk ka vlerë në Ditën e Gjykimit, përveç asaj që Allahu ka dërguar dhe të qenit *Hanif* (monoteist)."

Zejdi vazhdoi me një ton serioz:

[9] Zejd ibn Amri ishte një nga personat që kishte dhënë lajme të Profetit të fundit. Kur ardhja e Profetit po vonohej, ai mendoi se mund të kishte ardhur në një vend tjetër. Kështu u largua nga Meka në kërkim të Profetit dhe u vra gjatë udhëtimit. Ibn Sa'd, *Tabakatul Kubra*, 3/379; ibn Haxher, *Tehdhibu Tehdhib*, 3/364.
[10] Umeje ishte një poet nga epoka e injorancës. Ibn Haxher, *el Isabe*, 1/249.

"Ki kujdes! A do të dalë Profeti i pritur nga populli ynë, apo nga toka e Palestinës?"[11]

Ebu Bekri po dëgjonte me vëmendje bisedën midis dy shokëve. Ata po flisnin për çështje të botës tjetër dhe kjo nuk mund të mos merrej seriozisht. Për më tepër ata të dy ishin ndër më të diturit dhe më të zgjuarit në Mekë.

Kjo bisedë e kishte bërë shumë kureshtar Ebu Bekrin. Menjëherë rendi tek Uaraka ibn Neufel, një tjetër njeri i ditur. Ai ishte një burrë sytë e të cilit shikonin gjithnjë drejt së përtejmes. Ebu Bekri u ul pranë tij dhe i tregoi bisedën që kishte dëgjuar në Qabe. Pastaj e pyeti Uarakën se çfarë do të thoshte e gjithë kjo. Uaraka i tha me përzemërsi:

"O djali i vëllait tim! Njerëzit e Librit dhe dijetarët e tjerë janë të një mendimi të përbashkët se Profeti i fundit do të dalë nga zemra e popullit dhe shoqërisë arabe. Unë kam njohuri të mira të gjenealogjisë. Fisi yt vjen po ashtu nga zemra e popullit arab."

Me fjalët që tha, Uaraka i tërhoqi vëmendjen Ebu Bekrit për tek fisi i tij. Në fakt ai po e këshillonte që ta kërkonte të Shumëpriturin në fisin e tij. Kur dëgjoi këtë, Ebu Bekri e pyeti: "O xhaxhai im! Çfarë do të sjellë dhe çfarë do të kërkojë ky Profet?"

"Ai do të thotë ato gjëra që do t'i shpallen atij. Kur të mbërrijë ai, tirania dhe shtypja do të marrë fund"[12], u përgjigj Uaraka.

Në një rast tjetër, Ebu Bekri dëgjoi Zejd ibn Amrin të thoshte:

"O njerëz të Kurejshëve! Betohem në Atë, në dorën e të cilit është shpirti im, se askush nga ju nuk ndjek rrugën e Ibrahimit alejhi selam përveç meje! Tani unë po pres ardhjen e një Profeti nga familja e Ismailit. Shpresoj të jetoj aq gjatë sa për ta parë atë."

Një burrë i moshuar, i njohur me emrin Amr ibn Rebia, pasi e

[11] Sujuti, *Hasaisul Kubra*, 1/42.
[12] Hindi, *Kenzul Ummal*, 1/2483 (35357).

dëgjoi Zejdin, i tha:

"Nëse jeton dhe e shikon atë, çoji përshëndetjet e mia gjithashtu!"[13]

Nëse këta dijetarë të vjetër po tregonin të vërtetën, atëherë banorët e Mekës i prisnin surpriza të mëdha. Ata ishin aq të sigurt në parashikimet e tyre, saqë ishte e pamundur ta shpërfillje lajmin. Për më tepër, ata të gjithë ishin të të njëjtit mendim se kishte afruar koha e ardhjes së Profetit të fundit.

Që nga ky çast, botëkuptimi i Ebu Bekrit mbi botën kishte ndryshuar. Herë pas here ai vizitonte Qabenë për të parë gjendjen e mjerueshme në të cilën jetonin një pjesë e gjindjes. Ai ishte i bindur se adhurimi i idhujve ishte një besëtytni dhe ai ia kujtonte vazhdimisht vetes këtë gjë.

Historitë që kishte dëgjuar nga këta burra të mençur ia kishin trazuar gjumin. Edhe ëndrrat madje i ishin mbushur me shenja të ardhjes së Profetit të Shumëpritur. Si mund të mendonte ndryshe? Të gjithë ata dijetarë ishin të një mendimi dhe të gjithë shokët e tij recitonin të njëjtat vargje.

Nga njëra anë kishte njerëz që jepnin receta për të shëruar botën nga korrupsioni moral dhe nga ana tjetër ishin po ata që përshkruanin në detaje Profetin e Ardhshëm. Ata ishin aq të saktë në përshkrimet e tyre saqë dihej titulli i tij si dhe veçoritë e atyre që do ta ndiqnin.

Një herë, Ebu Bekri kishte shkuar në Damask për tregti. Gjatë qëndrimit atje pa një ëndërr të çuditshme, sikur Hëna ishte thyer në copa. Pastaj kishte zbritur dhe ishte futur në çdo shtëpi të Mekës. Më pas copat u bashkuan përsëri për të formuar Hënën e plotë e cila hyri në shtëpinë e Ebu Bekrit. Ai u zgjua i trembur duke bërtitur. Ëndrra e kishte emocionuar aq shumë sa nuk mundi ta përmbante veten.

[13] Ibn Haxher, *Tehdhibu Tehdhib*, 3/364.

Ebu Bekri vendosi të zbulonte se çfarë do të thoshte kjo ëndërr dhe shkoi tek një murg. Ai i shpjegoi çdo gjë që kishte parë. Murgu u ngazëllye pa masë kur dëgjoi ëndrrën e Ebu Bekrit. Më pas i tha:

"Pa dyshim që koha e tij ka ardhur!"

Ebu Bekri ishte konfuz. Ai po kërkonte një shpjegim për ëndrrën nga ky burrë, por ai po fliste për gjëra që Ebu Bekri nuk i kuptonte. Ai e pyeti përsëri:

"Për çfarë e ke fjalën?"

Nga shikimi i tij kuptohej se Ebu Bekri e kishte nuhatur nënkuptimin e murgut, por dëshironte një konfirmim. Kështu që vijoi me pyetjen tjetër:

"Mos je duke folur për Profetin e Fundit?"

Murgu pohoi me kokë dhe iu përgjigj:

"Po! Ti do të përqafosh fenë e tij dhe do të bëhesh një nga mbështetësit e tij më të mëdhenj ndër të gjithë njerëzit."[14]

Gjatë kthimit nga Damasku në mendjen e Ebu Bekrit ishte vetëm një njeri, Profeti i Fundit. Herë pas here ai ngrinte duart lart dhe thërriste: "Kush do të recitojë një poezi të Umeje ibn Ebi Seltit?" Një person nga karvani përgjigjej: "Umeje ka shumë poezi. Cilën do që të recitojmë?" Ebu Bekri iu përgjigj: "Vërtet, Ne kemi Profetin tonë..." Menjëherë pas kërkesës, një person nga karvani filloi të recitonte poezinë:

Vërtet, Ne kemi Profetin tonë. Do të sjellë lajme prej së ardhmes!

Jemi të sigurt se nëse nuk ka përfitim nga mençuria, do të kishim vënë në shpatë njëri tjetrin.

O Zoti im! Mbromë nga idhujtaria dhe mbushma zemrën me besim sa të jem gjallë në botë.

[14] Ebu Xhafer Taberi, *Rijadu Nadira*, 1/413 (333).

Sepse unë kërkoj ndihmë nga e keqja tek Ai, i vetmi Krijues, për të cilin njerëzit vizitojnë Qabenë dhe mbajnë flamurin e fesë.[15]

Rruga e kthimit për në Mekë kalonte nga krahina e Basrës ku jetonte një prift me emrin Bahira. Ebu Bekri donte t'ia shpjegonte ëndrrën e tij Bahiras. Kështu ai shkoi menjëherë në manastirin ku jetonte ai.

Ebu Bekri i shpjegoi ëndrrën që kishte parë në Damask. Ndërsa po dëgjonte, sytë e Bahiras ishin hapur nga habia. Menjëherë e pyeti Ebu Bekrin se nga ishte. "Nga Meka", iu përgjigj ai me qetësi. Bahira donte më shumë informacion dhe kjo ishte e dukshme. Prandaj e pyeti: "Nga cila pjesë e Mekës dhe nga cili fis?" "Nga fisi Kurejsh", iu përgjigj Ebu Bekri i habitur. Kjo përgjigje përsëri nuk ishte e mjaftueshme për të, prandaj prifti vazhdoi: "Çfarë pune bën për të jetuar?" "Unë jam tregtar", iu përgjigj Ebu Bekri.

Në këtë pikë, Bahira filloi të flasë më hapur për gjëra që do të shuanin kureshtjen e Ebu Bekrit. "Pa dyshim që Allahu do të mundësojë që ëndrra jote të bëhet realitet! Së shpejti një Profet do të dalë nga fisi yt. Ti do të jesh mbështetësi i tij gjatë jetës dhe Kalifi i tij pas vdekjes!"

Ebu Bekri ishte hipnotizuar nga ato që dëgjoi. Ai nuk dinte se ç'të pyeste më tepër. Një pohim i tillë që i jepte një nder të veçantë, e bëri që të tregohej akoma më i thjeshtë. Meqë emri i tij ishte përmendur nga parashikimi i Bahiras, ai vendosi të mos i tregonte njeriu për këtë. Ai do ta mbante sekret deri në ditën e bashkimit.[16]

[15] Ali Muhamed, *Biogarafia e Ebu Bekr Siddikut*, fq.34.
[16] Ebu Xhafer Taberi, *Rijadu Nadira*, 1/413 (333).

TË GJITHË ISHIN TË VETËDIJSHËM PËR PRANINË E TIJ

Çdo ditë që kalonte Ebu Bekri kuptonte se po afrohej më shumë me Profetin. Kjo ndjenjë i dha atij një afrimitet tjetër. Prania e Profetit të Pritur ishte aq e dukshme, si Hëna e plotë që ngrihet në qiellin e errët. Edhe mekasit ishin të vetëdijshëm për këtë.

Pas një debati të gjatë, mekasit kishin vendosur të rikonstruktonin Qabenë e cila ishte vjetruar nga pesha e viteve. Për Mekën Qabeja ishte një burim i madh të ardhurash asokohe. Çdo vit ajo vizitohej nga një numër i madh pelegrinësh. Kjo kishte bërë që të shtohej tregtia dhe të rriteshin të ardhurat. Megjithëse adhurimi dhe praktikat lidhur me Qabenë kishin pësuar transformime të shumta, ajo konsiderohej ende një vend i shenjtë.

Rikonstruksioni kishte përfunduar dhe ishte koha për të vendosur Gurin e Zi në vendin e vet. Papritur, nisi një konflikt i paparashikuar midis fiseve arabe. Secili fis pretendonte se i takonte atij nderi të vendoste gurin. Ndërkohë që po diskutoheshin argumentet, u dëgjua zëri i fuqishëm i Umejes. Ai propozoi një zgjidhje. Ai u sugjeroi se personi i parë që do të hynte në Qabe, do të gjykonte për çështjen.

Umeje ishte një nga liderët e Mekës. Ai ishte një burrë i moshuar, mendimi i të cilit respektohej. Ata lanë çdo debat dhe po prisnin me ankth se kush do të ishte ai që do të futej në Qabe. Ebu Bekri ishte mes turmës. Nuk kaloi shumë dhe u dëgjuan hapa. Dikush po afrohej. Të gjithë i kishin sytë të fiksuar nga hyrja. Tensioni në ajër po rritej. Kush do të ishte ai person që do të merrte vendimin final për të vendosur Gurin e Zi?

Papritur dikush filloi të thërriste me zë të lartë: "I besueshmi! Muhamed i besueshmi!"

Ata tashmë kishin rënë dakord që do t'i bindeshin vendimit të personit të parë që do të hynte në Qabe. Të gjithë u çliruan kur panë se ky person ishte Muhamedi, ndërsa ky i fundit nuk e kishte aspak idenë për vendimin e tyre. Paria e fiseve i shpjeguan si qëndronte çështja dhe i kërkuan që të gjente një zgjidhje. Muhamed i besueshmi u tha:

"Më sillni një rrobë!"

Nxituan dhe e sollën menjëherë. Megjithëse nuk e dinin qëllimin e tij, askush nuk hezitoi për të plotësuar kërkesën e tij. Kur Muhamed i besueshmi kërkonte diçka, ishte e sigurt se ai kishte një arsye logjike. Rrobën e vunë në tokë dhe mbi të vendosën gurin. Pastaj Muhamedi tha:

"Secili kryetar fisi të kapë një cep të rrobës dhe të ngrejë gurin!"[17]

Kjo ishte një zgjidhje e shkëlqyer, pasi çdo fis do të kishte nderin të ngrinte gurin. Guri ishte ngritur nga të gjithë kryetarët e fiseve dhe ishte afruar në vendin ku do të vendosej. Pastaj Muhamedi e mori gurin me duart e tij të bekuara dhe e vendosi në vendin e vet. Vendimi i tij kishte parandaluar një konflikt që mund të degjeneronte në dhunë. Njëkohësisht, ky gur i cili ishte mbajtur nga shumë profetë në të kaluarën, tani kishte qenë edhe një herë në duart e një Profeti. Ky kishte qenë caktimi i Allahut.

Ebu Bekri e kishte parë të gjithë skenën me habi të madhe dhe kujtimet e kishin kthyer pas në kohë, në tregun e Ukazit. Ai kujtoi fjalët e plakut Kus ibn Said:

"Pa dyshim që koha do të mbërrijë kur caktimi të jetë përmbushur dhe fletët e librit të jenë hapur!"[18]

[17] Ahmed ibn Hanbel, *Musned*, 3/425.
[18] Halebi, *Siratu Halebije*, 1/319.

Në të vërtetë, dhuntia e Allahut kishte triumfuar dhe kaderi ishte përmbushur. Në këtë ngjarje, Ebu Bekri ishte njeriu më i lumtur lidhur me zgjidhjen e problemit.

KUJTIME TË PAHARRUESHME

Shumë vite më vonë, i Dërguari i Allahut paqja qoftë mbi Të! kishte pyetur sahabët nëse ndonjëri prej tyre kishte takuar ndonjëherë Kus ibn Saidin dhe kishte marrë ndonjë këshillë prej tij. Heshtja ishte thyer nga shoku i tij i ngushtë, Ebu Bekri:

"O i Dërguari i Allahut, më kujtohet si tani", tha ai dhe vazhdoi: "Isha në tregun e Ukazit. Ibn Saidi hipi në devenë e tij gri dhe i foli turmës:

O njerëz! Më dëgjoni me kujdes, mbajini mend fjalët e mia dhe përfitoni nga këto që do ju them!

Çdo gjë e gjallë do të zhduket; ato do ta lënë këtë botë për të mos u kthyer më kurrë.

Nuk ka dyshim se ka shumë shenja në qiej dhe shumë prova në Tokë nga të cilat duhet të nxjerrim mësime.

Toka është si një shtrat i rregulluar dhe qiejt lart janë si çati.

Yjet janë si anije që lundrojnë dhe detet nuk avullojnë e zhduken.

Mahnitu me natën që vesh një petk të errët dhe me yjësitë e zodiakut lart në qiej!

Unë po ju them se është një fe e Allahut e cila është më e bukur se ajo që keni tani!

Allahu ka një Profet, ardhja e të cilit është e afërt. Prania e tij është mbi kokat tona dhe koha e tij ka ardhur.

Pse ata që e lënë këtë botë nuk kthehen më kurrë?

A kanë gjetur ata lumturinë e vërtetë atje apo janë të harruar në gjumin e përjetshëm?

Pa dyshim koha do të vijë kur premtimi të përmbushet dhe libri të shpallet!"[19]

Si mund t'i harronte Ebu Bekri këto fjalë? Pasi e kuptoi që i Dërguari ë Allahut u kënaq me këtë histori, ai i recitoi një poezi nga Kus ibn Saidi.

Ishte e qartë se Ebu Bekri nuk kishte dyshime mbi ardhjen e Profetit të fundit. Ai e besonte këtë me gjithë zemër. Ndoshta, nëse do ta kishte ditur sa afër ishte me të që nga fillimi, njerëzimi do të kishte qenë dëshmitar i një besnikërie të jashtëzakonshme që nga momenti i parë që Ebu Bekri ishte takuar me të.

[19] Po aty.

STATUSI SHOQËROR I EBU BEKRIT NË MEKË

Për shkak të suksesit në tregti, Ebu Bekri ishte bërë një nga tregtarët më të pasur të Mekës. Përveç pasurisë ai kishte fituar gjithashtu edhe respektin e bashkësisë përmes ndershmërisë dhe besnikërisë. Fuqia e tij ekonomike ishte e pakrahasueshme dhe reputacioni i tij midis kurejshëve kishte arritur majat.

Ai ishte një nga burrat e parisë së Mekës, një kryetar fisi i respektuar dhe anëtar i një elite personash që merrnin vendime dhe drejtonin punët në Mekë. Ndër këta mund të përmendim edhe Ebu Sufjanin, Umeje ibn Halefin, vëllezërit Utbe dhe Shejbe, Ebu Xhehlin, Suhejl ibn Amrin dhe Ebu Lehebin. Asnjë vendim nuk mund të merrej pa votën e Ebu Bekrit.

Përmes sjelljes së mirë dhe zgjuarsisë së tij, Ebu Bekri u kthye në një prijës. Midis kurejshëve ai ishte më i dituri në fushën e gjenealogjisë. Madje edhe çështje serioze si vrasja, vjedhja apo dëmshpërblimi, do të silleshin tek ai për t'u dhënë zgjidhje. Ai e kishte fituar reputacionin me anë të ndershmërisë. Kishte vepruar me ndjeshmëri të madhe në mbrojtjen e të drejtave të të tjerëve dhe kurrë nuk kishte trajtuar dikë me padrejtësi. Për këtë shkak, Kurejshët kishin preferuar këshillën e tij mbi atë të kryetarëve të tjerë të fiseve.

Ebu Bekri ishte gjithashtu nga të pakët persona që ishte distancuar nga sjelljet negative të epokës së injorancës. Ky ishte një virtyt që e kishte dalluar nga të tjerët. Megjithëse faqja e shëmtuar e injorancës kishte prekur çdo aspekt të shoqërisë, ajo nuk kishte mundur të futej në shpirtin e dëlirë të Ebu Bekrit. Marrëdhënia e

tij me idhujt asnjëherë nuk kishte qenë e mirë. Edhe në fëmijëri kur i ati e kishte çuar në Qabe, ai kishte parë me habi të madhe se si njerëzit adhuronin objekte që i kishin ndërtuar me duart e tyre. Dëlirësia dhe pastërtia ishin virtyte themelore të karakterit të tij. Ai i kishte bërë një premtim vetes se kurrë nuk do të pinte alkool. Ai e dinte se pirja e alkoolit nuk sillte asgjë përveç së ligës dhe shpeshherë debatonte se ata që përdornin alkool herët a vonë do të humbnin nderin dhe dinjitetin e tyre.[20]

[20] Ebu Xhafer Taberi, *Rijadu Nadira*, 2/146.

DREJT NJË BASHKIMI TË LUMTUR

Më në fund fati e kishte çuar Ebu Bekrin në Jemen. Atje ai takoi një plak i cili njihej për mençurinë dhe diturinë e tij rreth Teuratit dhe Inxhilit. Ashtu si të tjerët, edhe ai ishte në pritje të agimit të shumëpritur. Me të parë Ebu Bekrin plaku u ngazëllye dhe nisi të sillej në mënyrë të çuditshme. Fytyra i ishte zbehur dhe kishte ngrirë i tëri. Ndërsa e shihte Ebu Bekrin drejt në sy, kurioziteti po i shtohej dhe nuk mund të duronte pa e pyetur:

"Besoj se ti je nga populli i Haramit!"

Megjithëse nuk kishin shkëmbyer asnjë fjalë, plaku e kishte kuptuar se Ebu Bekri ishte nga Meka. Çfarë zgjuarsie ishte kjo? Plaku donte të konfirmonte parandjenjën e tij. Abdullahu i tha:

"Po, unë jam nga populli i Haramit!"

Plaku mbeti i shokuar. Dukej se kishte përpara syve diçka që e priste prej shumë vitesh. Ai donte që biseda të vazhdonte, kështu e pyeti përsëri:

"E marr me mend se je edhe nga fisi Kurejsh!"

Edhe një herë Ebu Bekri u përgjigj:

"Po, unë jam nga Kurejshët."

Pyetjet e plakut nuk do të përfundonin me kaq. Ishte e qartë se akoma nuk kishte marrë informacionin që i duhej. Prandaj i bëri pyetjen e radhës:

"Allahu e di më mirë, por ndoshta ti je nga dega Taim e Kure-

jshëve?"

Lista e pyetjeve do të ishte e gjatë. Ebu Bekri e kuptoi se ky njeri donte të dinte gjithçka rreth tij. Plaku dukej si një fëmijë kureshtar që po i bënte pyetje intime një njeriu që sapo e kishte takuar. Mimika e tij tregonte një lloj hezitimi, por ai kishte për të bërë akoma edhe një lëvizje tjetër. Kështu i tha:

"Ka mbetur edhe një gjë që dua të di për ty."

Ebu Bekri nuk po kuptonte asgjë. Pse ky burrë i vjetër po i bënte kaq shumë pyetje. Ata kurrë nuk ishin takuar më parë. Megjithatë Ebu Bekri nuk donte të tejkalonte kufijtë e respektit, prandaj i tha:

"Çfarë do të dish më shumë?"

Vetëpërmbajtja e Ebu Bekrit e qetësoi plakun. Ai e kuptoi se kërkesat e tij nuk do të refuzoheshin. E mblodhi veten dhe i kërkoi Ebu Bekrit të ngrinte rrobën dhe t'i tregonte barkun. Ebu Bekri mendoi se kjo ishte paksa e tepërt. Ai ishte një njeri i turpshëm, prandaj pa hezituar i tha:

"Këtë nuk mund ta bëj!"

Si mund ta bënte një gjë të tillë? Ky burrë plak i panjohur i kishte bërë gjithë ato pyetje personale dhe tani po i kërkonte të ngrinte rrobën dhe t'i tregonte barkun.

Plaku u vu në siklet dhe u zhgënjye shumë nga shprehja në fytyrën e Ebu Bekrit. Ebu Bekri ishte njeri i ndjeshëm dhe nuk donte t'i thyente zemrën këtij burri të vjetër. Për një çast mendoi me vete se plaku do të kishte arsye të fortë përderisa kërkonte me ngulm diçka të tillë. Të thyente zemrën e një njeriu të tillë nuk i shkonte për shtat karakterit të Ebu Bekrit.

"Mirë," i tha ai dhe vazhdoi: "Por do të më tregosh se për çfarë të duhet."

Plaku u qetësua. Kjo ishte një mundësi që vinte një herë në jetë.

Çdo gjë u qartësua kur plaku filloi të shpjegojë arsyet që kishte:

Të dhëna autentike nga burime të sigurta më kanë mësuar se Profeti i Fundit do të dalë nga populli i Haramit. Ndjekësit e tij të parë do të jenë një djalë i ri dhe një burrë i pjekur. Djali i ri që do të qëndrojë pranë tij do të ketë virtyte të tilla si, bujari, kurajë, shkathtësi dhe sjellje fisnike. Për t'i ardhur në ndihmë Profetit ai do të zgjidhë probleme të vështira dhe do të jetë gati të sakrifikojë veten e tij.[21]

Personi tjetër që do të jetë krah tij do të jetë një burrë i hollë me çehre të bardhë. Ai është një njeri i dashur me zemër të butë. Ai ka një nishan mbi kërthizë dhe një shenjë mbi gju. Nëse pranon kërkesën time, atëherë unë do të jem i sigurt për dyshimin tim. Megjithatë, nëse ti refuzon, parashikimi im do të mbetet i pakonfirmuar.

Tashmë, kurioziteti i Ebu Bekrit nuk ishte më i vogël se ai i plakut. Ai kishte mbetur pa fjalë. Në të vërtetë, ai kishte dëgjuar edhe më parë për Profetin e Fundit, por kurrë në kaq detaje. Plaku nuk po fliste vetëm për ardhjen e Profetit, por ai po përshkruante edhe karakteristikat e personave të parë që do ta rrethonin atë. Për më tepër, ai po pretendonte se Ebu Bekri do të ishte një ndër ta. Kurioziteti i tij kishte arritur kulmin. Për të shuar tashmë kuriozitetin e vet, ai duhet t'i tregonte plakut barkun.

Ngriti rrobën. Mbi kërthizën gjendej një nishan i zi. Plaku nuk po i besonte syve ndërsa shihte Abdullah ibn Osmanin. Me sytë të fiksuar tek nishani zuri të thërrasë me të madhe:

"Betohem në Zotin e Qabes, se ti je ai!"

Papritur në dhomë ra heshtja. Plaku ishte i zënë me mahnitjen e tij për konfirmimin e dyshimit që kishte pasur, ndërsa Ebu Bekri

[21] Veçoritë e përshkruara këtu tregojnë për Ali ibn Ebu Talibin, i cili qëndroi pranë Profetit që nga dita e parë e profetësisë.

po ndjehej i turpëruar që karakteri i tij i virtytshëm ishte zbuluar. Fjalët e këtij burri të vjetër ishin pothuajse të ngjashme me ato të murgut gjatë rrugës për në Damask dhe priftit Bahira të Basrës. Ishte përsëri plaku që theu heshtjen:

"Dua të të paralajmëroj për një çështje, në mënyrë që të shmangesh prej saj!"

Sinqeriteti i bisedës kishte formuar një atmosferë të ngrohtë miqësore. Dukej sikur të dy e njihnin njëri tjetrin prej vitesh. Tashmë po fliste eksperienca dhe Ebu Bekri duhet të dëgjonte. Ai e pyeti:

"Për çfarë do të më paralajmërosh?"

Plaku ishte tani më i qetë dhe iu përgjigj:

"Mos u dorëzo përpara joshjeve..."

Më pas duke shikuar thellë në sytë e Ebu Bekrit vazhdoi:

"Qëndro në rrugën e mesme të të drejtëve. Frikësoju Allahut dhe vlerësoji mirësitë që të janë dhuruar!"

Gjithsesi Ebu Bekri ishte në rrugën e drejtë tashmë. Ai kishte mësuar t'u shmangej joshjeve në moshë shumë të re dhe kishte jetuar një jetë të disiplinuar. Megjithatë, ky informacion i ri e këshillonte të ishte më i kujdesshëm që tani e tutje. Të ishe një shok i ngushtë i të Dërguarit të Allahut paqja qoftë mbi Të!, ardhja e të cilit ishte parashikuar nga Profetët e mëparshëm dhe shumë dijetarë, nuk do të ishte e lehtë. Me sa duket, ky ishte një bekim i madh të cilin duhet ta merrte seriozisht. Duhet ta vlerësonte mirë dhe të ruhej me kujdes të madh. Një detyrë fisnike si kjo nuk mund të plotësohej në një ambient ku mbizotëronin joshjet dhe egoizmi.

Rruga e mesme ishte rruga e Profetëve dhe ata që qëndrojnë pranë tyre duhet qëndrojnë po në këtë rrugë. Në mënyrë urdhëruese ata duhet të kishin frikë Allahun në zemrat e tyre dhe

të ishin të ndërgjegjshëm për mirësitë që u ishin dhuruar, përndryshe mund t'i humbnin me lehtësi. Ekzistonte gjithashtu mundësia që pozita dhe pasuria t'u ishin dhënë si sprovë për besnikërinë e tyre.

Më në fund takimi kishte përfunduar dhe Ebu Bekri u largua për punët e tij të tregtisë. Megjithëse kishte një mijë pyetje që i vinin ndërmend, po përpiqej me dëshpërim të sistemonte të gjithë informacionin që kishte dëgjuar. Diçka brenda tij i thoshte se duhet ta vizitonte përsëri plakun. Një mundësi e tillë nuk do t'i vinte më gjatë gjithë jetës. Pasi përfundoi punët e tregtisë, u kthye tek plaku për të cilin tashmë kishte respekt të veçantë. Plaku u gëzua pa masë kur e pa. Ai i tha:

"Kisha dëshirë të të jepja disa poezi që kam shkruar për Profetin e Shumëpritur."

Ebu Bekri i mori poezitë dhe i vendosi përkrah atyre që kishte shkruar vetë. Sipas plakut, adresa e tyre ishte mëse e qartë. Ebu Bekri mblodhi të gjithë informacionin që kishte dëgjuar më parë dhe atë që plaku i kishte treguar. Ai e kuptoi që të gjitha rrugët të çonin drejt Mekës dhe të gjitha parashikimet tek shoku i tij i ngushtë, Muhamed Emini.

Në këtë moment nuk kishte njeri më të lumtur në botë sesa Ebu Bekri. Ky udhëtim në Jemen i kishte sjellë shumë më tepër përfitime nga ç'e kishte menduar.

Më në fund kishte ardhur koha për t'u kthyer në Mekë. Përgjatë udhëtimit, mendimet ishin trazuar nga tregimet e plakut nga Jemeni. Po priste me padurim që t'i tregonte çdo gjë Uaraka ibn Neufelit. Këto mendime kishin ndikuar edhe në ritmin e udhëtimit. Për Ebu Bekrin ky udhëtim nga Jemeni në Mekë nuk kishte qenë kurrë kaq i gjatë.

Ndërkohë në shpellën Hira, Muhamedi, shërbëtori i dashur i Allahut, pati një përjetim të papërshkrueshëm. Kishte ndodhur

takimi i shumëpritur. Profeti i fundit i Allahut, që po pritej prej kaq kohësh, kishte ardhur. Muhamedi u kthye në Mekë bashkë me misionin e shenjtë të thirrjes së njerëzve në rrugën e drejtë. Ky mision ishte t'u përcillte njerëzimit mesazhin e sjellë nga Xhebraili, engjëlli i Shpalljes Hyjnore. Fatkeqësisht, reagimi i mekasve ndaj këtyre zhvillimeve të reja nuk ishte shumë mikpritës.

Ebu Bekri ishte vetëm disa orë larg Mekës e cila ishte tronditur nga lajmet e fundit. Në afërsi të saj ai vuri re një grup njerëzish të cilët dukeshin se po prisnin dikë. Ndërsa u afrua disi, vuri re se grupi përbëhej nga persona të parisë së Kurejshëve. Midis tyre kishte individë të njohur si, Ukbe ibn Ebi Muejt, Shejbe, Rabia, Ebu Xhehli dhe Ebu Bahtare. Kjo mbledhje nuk ishte shenjë e mirë. Kuptohej se diçka kishte ndodhur kur ai kishte qenë larg Mekës. Me kureshtje, Ebu Bekri pyeti:

"Çfarë paska ndodhur gjatë mungesës sime? A ka ndonjë zhvillim të ri?"

Të gjithë e kishin pritur këtë pyetje. Prandaj filluan të shpjegojnë çdo gjë me urrejtje dhe përbuzje:

"O Ebu Bekr ky lajm është i pabesueshëm! Jetimi i Ebu Talibit pretendon se është Profet. Nëse nuk do të kishte qenë për ty, do ta kishim hequr qafe tashmë. Megjithatë, ti je tani mes nesh dhe jemi të sigurt që do të gjesh një zgjidhje."

Vërejtjet e tyre kishin dy mundësi kuptimi. Ndoshta ata po linin të kuptohej se ishte koha që Ebu Bekri të prishte lidhjet me këtë njeri që kishte filluar të sillej çuditshëm. Gjithashtu, ata mund të ishin duke nënkuptuar që Ebu Bekri të zbulonte se çfarë fshihej prapa sjelljes së shokut të tij të ngushtë.

Sidoqoftë, meqë kjo ishte një situatë e pazakontë, paria mekase besonte se ajo duhet të merrte një zgjidhje të menjëhershme. Sipas Ebu Bekrit ky ishte një zhvillim i parakohshëm. Papritur, çdo gjë

që kishte dëgjuar dhe çdo njeri me të cilin kishte folur i kaluan para syve si një film i rrufeshëm. Fjalët e Zejd ibn Amrit, murgut të krishterë Bahira dhe të plakut të mençur nga Jemeni filluan të merrnin kuptim tani. Të gjitha të çonin tek një njeri.

Si mundej një burrë që nuk kishte thënë gënjyer kurrë në dyzet vite të jetës së tij, qoftë edhe për shaka, të thoshte gënjeshtra për Allahun? Ai ishte Muhamed Emini… Mund të thuhej pa hezitim se koha për të kishte ardhur.

Ebu Bekri e qetësoi turmën dhe u premtoi se do të merrej personalisht me çështjen. Ebu Bekri ishte njeri i respektuar midis tyre dhe ata kishin besim tek fjala e tij. Për këtë arsye kurejshët vendosën të mos ndërmerrnin asnjë veprim për momentin. Ndoshta donin të qëndronin larg një çështjeje që mund t'u shkaktonte konfuzion në mendje.

Ebu Bekri nuk kishte kohë për të humbur. Vendosi të takonte Uaraka ibn Neufelin. E përshkoi me vrap rrugën për tek shtëpia e Hatixhes. Fati e kishte shpënë në këtë rrugë dhe askush nuk mund ta ndalonte.

Pas pak u gjend përpara shtëpisë së Hatixhes. Trokiti në derë rrëmbimthi. Dera u hap nga ai njeri të cilin po kërkonte. Si mund të ekzistonte mashtrim në një fytyrë të tillë? Kureshtja e madhe po ia brente mendimet. Gjithsesi, duhet të ishte i sigurt. Fillimisht mbajti distancë ndërsa e pyeti:

"O Muhamed! A e ke hedhur poshtë fenë dhe traditën e të parëve tuaj?"

Muhamedi paqja qoftë mbi Të! dinte si t'i përgjigjej një njeriu që kishte qenë shoku i tij për shumë vite. Ai e njihte Ebu Bekrin më mirë se çdokush tjetër. Ai u përgjigj:

"O Ebu Bekr, unë jam i Dërguari i Allahut!"

Më pas vazhdoi:

"Allahu më ka dërguar për ju dhe për mbarë njerëzimin, dhe unë do të përcjell mesazhin e Tij. Unë ju ftoj për tek Ai! O Ebu Bekr, betohem në të Lartësuarin se unë po ju ftoj në të vetmin Zot të vërtetë. Ne nuk adhurojmë tjetër veç Tij. Eja dhe beso në Allahun Një!"

Ebu Bekri po e trajtonte çështjen me shumë delikatesë. Ai donte të ishte i sigurt, ndaj e pyeti:

"Cila është prova jote?"

I Dërguari Fisnik e kuptoi gjendjen e tij. Ai e dinte se Ebu Bekri donte një provë për të qenë i sigurt. Ndoshta i duhej një provë e mbinatyrshme. Iu përgjigj me qetësi:

"Plaku nga Jemeni."

Ebu Bekri shtangu. Ndoshta ai kishte dëgjuar për udhëtimin në Jemen, por si mund ta dinte për plakun e mençur? Mos vallë ai e dinte për bisedën me plakun në Jemen? Sidoqoftë nuk e dha veten. I mblodhi forcat dhe i tha:

"Kam takuar shumë burra të vjetër në Jemen."

Kjo ishte një përpjekje për të fituar kohë ndërsa i duhej të mendonte përsëri. Megjithatë, ai po fliste me një udhëzues të bekuar, i cili dinte si të maste pulsin e një njeriu. Profeti i nderuar donte ta zgjidhte çështjen sa më shpejt të ishte e mundur. Edhe një herë ai i tha me siguri të plotë:

"Plaku që të dha poezitë!"

Kjo provë ishte mëse e mjaftueshme. Ebu Bekrin nuk po e mbanin gjunjët. Nuk kishte ç'të thoshte më tepër. Fjalët e vetme që i dolën ishin:

"Kush t'i tregoi këto mik i dashur?"

I Dërguari fisnik u përgjigj:

"Engjëlli që i ka ardhur edhe atyre përpara meje…"

Ebu Bekrit i kishte mbetur vetëm një gjë për të bërë. I mori dorën Profetit dhe me sinqeritet dhe dorëzim të plotë i tha:

"Më jep dorën se dua të të jap besën."

Me një ton prekës të zërit, Ebu Bekri deklaroi dorëzimin e shpirtit të tij:

"Dëshmoj se nuk ka Zot tjetër përveç Allahut, dhe se Muhamedi është robi dhe i Dërguari i Tij."[22]

Vërtet që Ebu Bekri ishte dorëzuar! Ky ishte një dorëzim që nuk do të thyhej më kurrë. Ai u prek aq shumë saqë filloi të qajë me ngashërim si një fëmijë.

Këto ishin lot gëzimi dhe Ebu Bekri nuk ishte i vetmi që u përlot. Askush nuk mund të ishte më i lumtur se i Dërguari i Allahut. Pas Hatixhes, gruas së tij të dashur, shërbëtorit të devotshëm, Zejd ibn Harithit dhe djalit të xhaxhait Ali ibn Ebu Talibit, një shpirt i ri kishte përqafuar besimin.

Ebu Bekri kishte kohë që përgatitej për këtë moment. Pikërisht atë ditë ai mori një vendim aq shpejt dhe pa hezitim, saqë Profeti e përshkroi futjen e tij në Islam me admirim: "Përveç Ebu Bekrit, çdo njeri që kam ftuar në Islam ka pasur një periudhë mëdyshjeje. Ebu Bekri ishte ai që e pranoi ftesën time pa hezitimin më të vogël."[23]

[22] Ebu Xhafer Taberi, *Rijadu Nadira*, 1/415.
[23] Buhari, *Sahih*, 4/1701.

FITIMI I NJË JETE TË TËRË

Një tregtar i suksesshëm si Ebu Bekri dinte t'i bënte mirë llogaritë para se të merrte vendime. Ai nuk mund të vinte në rrezik veten në fushën e tregtisë. Në ato ditë të pranoje Islamin dhe të ndihmoje Profetin do të thoshte të përballeshe me të gjithë botën duke filluar nga Meka. Megjithatë, Ebu Bekri shpalosi një besnikëri të pashembullt në krah të Profetit. Ai e dinte se megjithëse do të haste vështirësi dhe humbje të mëdha për shkak të këtij vendimi, shpërblimi në të ardhmen do të ishte i pamatshëm. Njëherazi, kur të tjerët zgjodhën rrugën e kundërt, devotshmëria e tij do ta ngrinte atë në një rang të tillë që do ta duartrokisnin banorët e qiejve.

Për më tepër, Allahu po u premtonte atyre që do të ndiqnin rrugën e Tij, lumturinë në këtë botë dhe në tjetrën.[24] A kishte një tregti më me përfitim se të fitoje kënaqësinë e Allahut dhe të përfitoje mëshirën e Tij të pafundme. Zgjedhja e bërë nga Ebu Bekri ishte një tregues i mendjes së tij të shkëlqyer në lidhje me tregtinë. Synimi i tij ishte të merrte përfitimin më të madh me rrezikun më të vogël.

[24] Al Imran, 148.

DUKE PËRDORUR POZITËN SHOQËRORE

Pas pranimit të Islamit, Ebu Bekri filloi të përdorte pozitën e tij shoqërore dhe marrëdhëniet e tij tregtare për të ftuar njerëzit në besim. Një numër i konsiderueshëm personash e njohën Islamin nëpërmjet Ebu Bekrit, Allahu qoftë i kënaqur me të. Sa herë shkonte të vizitonte Profetin, merrte një shok me vete. Midis tyre kishte emra të rëndësishëm si, Osman ibn Afvan, Talha ibn Ubejdullah, Abdurrahman ibn Auf, Zubejr ibn Auam dhe Sa'd ibn Ebi Uakas. Secili nga këta personalitete të dalluar e gjeti të vërtetën nëpërmjet Ebu Bekrit.

Ndërsa vetë Ebu Bekri kishte gjetur paqe dhe strehim tek i Dërguari i Allahut. Për këtë arsye ai dëshironte ta ndante këtë qetësi shpirtërore me të tjerët. Ai ishte i gatshëm të përdorte të gjitha mjetet për ta arritur këtë. Për kauzën e shenjtë ai ishte gati të luftonte me jetën dhe pasurinë e tij. Ebu Bekri e dinte se jeta e sakrifikuar dhe pasuria e harxhuar në këtë rrugë do t'i sillte cilësi të përjetshme. Në thelb, besimi solli përgjegjësi në zemrat ku ishte futur. Prandaj, Ebu Bekri nuk do të ishte asnjëherë i kënaqur plotësisht derisa edhe të tjerët të përfitonin nga burimi i ushqimit të tij shpirtëror.

Si fillim ai përdori reputacionin dhe pozitën e tij shoqërore për të ftuar njerëzit në Islam. Individë si Bilali dhe Amari ishin të varfër, kështu që kurejshët nuk do t'u vinin veshin atyre. Ndërsa Ebu Bekri ishte një lider i respektuar. Ai ftoi si fillim në Islam personat e pasur dhe me pushtet në Mekë. Respekti i ndërsjellë që ekzistonte midis tyre nuk ishte thyer ende, kështu që Ebu Bekri po

përdorte çdo mundësi për t'u folur atyre për Allahun dhe Profetin. Përpjekjet e tij dhanë frytet e para dhe pesë sahabë, të cilët do të ishin gjithashtu ndër dhjetë të përgëzuarit me Xhenet, pranuan Islamin. Ata ishin njerëz të rëndësishëm të cilët kishin mundësi të ndikonin qindra njerëz rreth tyre. Koha do ta tregonte se nëpërmjet Ebu Bekrit, Allahu do të çonte shumë persona tek i Dërguari i Tij i dashur. Këta individë do të ishin arkitektët shpirtërorë të së ardhmes.

NË NDIHMË TË TË VARFËRVE

Ebu Bekri kishte gjetur rrugën e vërtetë. Ai kurrë nuk do të largohej nga shoqëria e Profetit. Dukej sikur ishte bërë këmba dhe dora e tij. Ai ishte person tejet i ndjeshëm dhe nuk mund të qëndronte duarkryq ndërsa shihte të dobëtit dhe të pafuqishmit të torturoheshin për shkak të besimit të tyre. Një njeri si Ebu Bekri nuk mund t'i neglizhonte të varfrit dhe ata në nevojë. Sa herë që do të paraqitej mundësia, ai do të vraponte për t'i ndihmuar. Gjithmonë u përpoq me çdo kusht të lironte skllevërit dhe të ndihmonte njerëzit në nevojë.

Askush nuk mund të krahasohej me Ebu Bekrin në këtë aspekt. Ai ishte model i paarritshëm i lirisë. Një ditë kishte dëgjuar një rënkim vajtues që jehonte në të gjithë Mekën. Ndali dhe u kthye andej nga vinte zëri. Këto ishin britmat e Bilalit që po torturohej.

"Një…një!", psherëtinte ai në përpjekje për të rezistuar.

Ebu Bekri nxitoi në drejtim të zërit. Aty u përball me një skenë të llahtarshme. Menjëherë u tha:

"A nuk e shihni këtë njeri të gjorë? A nuk i frikoheni Allahut? Çfarë doni të arrini me këtë?"

Tiranët e pamëshirshëm filluan të mallkojnë Ebu Bekrin duke i thënë:

"Ti je ai që ia ka shpëlarë trutë këtij? Atëherë eja dhe shpëtoje!"

Ky ishte një rast i artë për Ebu Bekrin. Ai e pranoi ofertën dhe i propozoi një shkëmbim. Ebu Bekri kishte një shërbëtor që ad-

huronte idhujt. Ai ofroi atë në shkëmbim të Bilalit. Umeje kishte përdorur çdo mënyrë të mundshme për të "edukuar" skllavin e tij. Për fat të mirë kishte dështuar. Ishte e qartë se ai nuk kishte ç'të bënte më me Bilalin, kështu që pranoi shkëmbimin pa hezituar.

Kjo marrëveshje e shpëtoi Bilalin nga torturat. Për më tepër ai tashmë ishte në rrugën drejt lirisë. Qëllimi i Ebu Bekrit nuk ishte marrja e një skllavi, por t'i jepte mundësinë Bilalit të ishte një mysliman i devotshëm në krah të Profetit paqja qoftë mbi Të!. Sipas dëshmisë së Omer ibn Hatabit, Ebu Bekri ishte një zotëri që kishte liruar një tjetër zotëri.[25]

Në një rast tjetër ai dëgjoi se një grua po torturohej vetëm për shkak se kishte pranuar Islamin. Rendi menjëherë te vendi ku kishte ndodhur incidenti. Ishte një skenë e dhimbshme. E kishin rrahur aq shumë, saqë sytë nuk i dukeshin nga enjtja. Kishte humbur shikimin në një sy. Fëmija iu ul pranë nënës. E tmerruar nga skena që kishte parë, vajza e vogël kishte shtangur dhe qante me ngashërim. Si mund ta duronte zemra e një njeriu një dhunë të tillë? Ebu Bekri pa u menduar i bleu vajzën dhe nënën e saj duke i shpëtuar nga duart e përbindëshave me fytyrë njeriu. Pastaj, pa humbur kohë, dhe pa kërkuar asgjë si shpërblim, u fali lirinë nënës dhe vajzës së vogël.[26]

Ebu Bekri shpëtoi edhe shtatë skllevër të tjerë nga tortura të tilla dhe u dha atyre diçka që nuk e kishin parë as në ëndërr… lirinë.

Babai i Ebu Bekrit, Ebu Kuhafe, e kishte vënë re këtë sjellje të pazakontë tek i biri. Ai nuk po gjente një arsye për këtë, ndaj dhe e paralajmëroi:

"O bir i dashur, nuk kam kundërshtim që ti po liron kaq skllevër por, a nuk duhet të zgjedhësh ti më të fortët, në mënyrë që ata të të mbrojnë nga ndonjë rrezik i mundshëm nga idhujtarët?"

[25] Shejban, *Ehad uel Mesane*, 1/202.
[26] Ebu Xhafer Taberi, *Rijadu Nadira*, 2/22.

Ebu Kuhafe kishte arsye të forte që pyeste. Nëse Ebu Bekri ndihej i detyruar të ndihmonte ata që ishin në nevojë, të paktën mund të kishte zgjedhur ata që do të ishin të dobishëm për të. Në këtë mënyrë ai do të merrte diçka në shkëmbim të bujarisë së tij.

Por ky ishte Ebu Bekri. Koncepte të tilla nuk kishin vend në zemrën e tij. Për ata që e kanë shikimin të kufizuar në kënaqësitë e kësaj bote, të ishe bujar për të marrë lavdërime dhe shpërblime ishte diçka normale. Ndërsa për ata që i kishin kthyer sytë nga e përjetshmja dhe kënaqësia e Allahut, ky ishte një investim me vlerë të madhe për të ardhmen. Megjithatë Ebu Bekri nuk kishte ndërmend të ardhmen. Sipas tij, kjo ishte një formë falënderimi dhe vlerësimi për pasurinë që i ishte dhënë atij. Përgjigjja e tij ndaj babait ishte:

"Baba i dashur! S'ka dyshim se unë nuk po e bëj këtë për t'u dukur në sytë e njerëzve, por për të fituar kënaqësinë e Allahut!"[27]

Sigurisht që Ebu Kuhafe nuk e dinte se veprimet dhe karakteri i djalit të tij ishin lavdëruar nga i Dërguari i Allahut. Një herë, Profeti tha se askush nga bashkësia e tyre nuk mund të ishte më i dashur për ta se Ebu Bekri.[28]

Një person i tillë që kërkonte vetëm kënaqësinë e Allahut ishte lavdëruar nga banorët e qiejve. Pak kohë më pas kishin zbritur ajetet kuranore që përmendnin përpjekjet dhe devotshmërinë e sahabëve me Ebu Bekrin në krye. Kurani i Shenjtë i premtonte një jetë të përjetshme në lumturi atyre të cilët i frikësoheshin Allahut si dhe atyre që vazhdimisht mendonin për të tjerët, jepnin me bujari, ishin dëshmitarë të së vërtetës dhe kërkonin të drejtën.[29]

[27] Hakim, *Mustedrek*, 2/572.
[28] Tirmidhi, *Sunen*, 5/664.
[29] Lejl, 5-7.

GARË NË SHËRBIM TË NJERËZIMIT

Ebu Bekri nuk kishte humbur asnjë rast për t'i shërbyer vlerave në të cilat besonte. Ai dëshironte të përdorte përvojën dhe zgjuarsinë e tij vetëm në këtë rrugë. Ebu Bekri zotëronte dije të thella në fushën e gjenealogjisë. Këtë dije ai e vuri në shërbim të Profetit duke i siguruar atij informacion për persona të ndryshëm që vinin në Mekë për të dëgjuar për Islamin. Kështu Profeti kishte një informacion përpara se të takohej me këta njerëz. Ebu Bekri në këtë mënyrë i ndihmoi ata për të kuptuar më mirë Islamin dhe ua bëri më të lehtë kthimin në myslimanë.

Një sjellje e tillë ishte e papranueshme në Mekën e atyre ditëve. Të pasurit dhe fisnikët po përqafonin Islamin njëri pas tjetrit. Ndërkohë të varfrit gjenin mbështetje dhe skllevërit liroheshin nga robëria. Meka po "kërcënohej" nga të dyja anët. Nga njëra anë qytetarët e pasur po pranonin Islamin dhe nga ana tjetër shërbëtorët dhe skllevërit po pakësoheshin dita ditës.

Kurejshët nuk mund të qëndronin duarkryq dhe të shikonin Ebu Bekrin teksa sugjestiononte njerëzit e tyre; dhe në fakt nuk e bënë. Nuk zgjati shumë dhe filluan të armiqësoheshin ndaj tij. Ata nuk mund të toleronin më që Ebu Bekri t'i ftonte njerëzit hapur në Islam. Ai ndërkohë kishte filluar të lexonte Kuran dhe të falte namazet ditore hapur në publik. Kushdo që e kishte dëgjuar të lexonte Kuran apo kishte qëndruar pranë tij, i kishte vënë re ndryshimet në karakterin e tij. Ata dëgjonin recitimin të mahnitur, ndërsa lotët rridhnin në faqet e tij.

Jobesimtarëve nuk u pëlqente kjo gjë dhe ndërmorën një fush-

atë përndjekjesh të dhunshme ndaj shokëve të tyre, me të cilët jo shumë kohë më parë kishin ngrënë dhe pirë në një vend. Objektivi i tyre ishte i qartë, të eliminonin personat e deklaruar si armiq të fesë së tyre. Dhuna dhe armiqësia ndaj besimtarëve bëheshin çdo ditë e më të ashpra. Ato ditë, numri i myslimanëve nuk i kapte të dyzetat. Ebu Bekri këmbëngulte të ftonte njerëz në Islam hapur dhe në sy të publikut. Ai kërkoi lejen e Profetit për këtë. Në fillim Profeti fisnik shpjegoi diferencën e rëndësishme në drejtpeshimin e pushtetit, dhe i tregoi se ata ishin ende vetëm një grusht njerëzish. Megjithatë ai nuk donte t'ia thyente zemrën Ebu Bekrit, kështu që shkuan të dy në Qabe. Ebu Bekri filloi t'u shpjegonte Islamin një grupi të vogël personash që u mblodhën atypari. Ky veprim i dha gjithashtu atij nderin për të qenë i pari orator i Islamit.

Kurejshët nuk lëshonin pe për zhvillime të reja në bashkësinë e tyre po të mos ishin miratuar nga ta. Papritur, një grup rrugaçësh sulmoi Ebu Bekrin. Ata godisnin pa mëshirë këdo që u dilte përpara me çfarë të kishin në duar. Shënjestra kryesore ishte Ebu Bekri. Ata arritën ta rrëzonin përtokë dhe filluan ta godasin ndërkohë që ai përpiqej të mbronte kokën me duar. Utbe ibn Rebia ishte banditi kryesor. Ai e urrente aq shumë Ebu Bekrin saqë donte ta rrihte për vdekje. Fytyra e Ebu Bekrit ishte mbuluar me gjak dhe hunda i ishte thyer. Ai nuk ishte në gjendje të rezistonte më tepër. Ata u larguan vetëm kur panë se trupi i Ebu Bekrit nuk reagonte dhe e pandehën të vdekur.

Të afërmit e Ebu Bekrit kishin nxituar në vendngjarje. Nxituan ta ngrinin trupin e tij të pavetëdijshëm dhe e dërguan në shtëpi. Kur panë gjendjen serioze në të cilën gjendej Ebu Bekri, një grup nga të afërmit e tij u kthyen në Qabe dhe u betuan:

"Për Allah! Nëse Ebu Bekri vdes, ne do ta vrasim Utben!"

I gjithë fisi ishte mbledhur në shtëpinë e Ebu Bekrit. Ata po përpiqeshin me dëshpërim ta ringjallnin. I kërkuan të flasë sepse

donin të dinin nëse ishte gjallë apo jo.

Disa orë më vonë Ebu Bekri filloi të shfaqte shenja jete ndërsa përpiqej të lëvizte gjymtyrët. Ishte gjallë. Gjithsecili lëshoi një psherëtimë çlirimi. Ky incident mund të shkaktonte një luftë gjakmarrjeje që mund të zgjaste për vite të tëra.

Ebu Bekri kishte një qëllim në jetë dhe ai e kishte të qartë këtë. Zemra e tij nuk mbante tjetër gjë përveç dashurisë së Tij. Ai ishte i përgatitur për ditë si këto që nga momenti kur kishte vendosur të vinte jetën dhe pasurinë e tij në rrugën e Allahut dhe të Profetit. U përpoq të ngrihej, por e kishte të vështirë. Në përpjekje për të thënë diçka, murmuriti ca fjalë nëpër buzët që i dridheshin:

"A është mirë i Dërguari i Allahut?"

Kjo ishte e pamundur të kuptohej nga të pranishmit. Një burrë i cili sapo ishte kthyer nga vdekja, pyeste për shëndetin e dikujt tjetër. Askush nuk ia vuri veshin dhe filluan ta ushqejnë. Ata nuk e dinin se ushqimi i tij nuk ishte buka dhe uji. Si mund të hante ai kur akoma nuk dinte gjë për shëndetin e Profetit? Ai s'mund të pinte një gllënjkë ujë pa u siguruar për shëndetin e Profetit.

Të afërmit u larguan me mendimin se Ebu Bekri ishte mirë tani. Ai kishte mbetur i vetëm me nënën e tij të dashur. Kur hapi sytë sërish, e ëma po qëndronte te koka me një pjatë supë. Ebu Bekri pyeti edhe një herë me ankth:

"Si është i Dërguari i Allahut? A është mirë?"

E habitur, nëna iu përgjigj:

"Për Allah, nuk di gjë për shokun tënd!"

Si nënë që ishte, zemra po i digjej nga dëshpërimi. Ai ishte djali për të cilin ajo i ishte përgjëruar aq shumë Allahut vite më parë. Tani ai qëndronte i shtrirë përpara saj i mbuluar në gjak.

Ebu Bekri u përpoq furishëm të ngrihej, por këmbët nuk e mbanin.

"Nënë, të lutem! A mund të shkosh tek Umu Xhemilja, bija e Hatabit dhe të marrësh vesh se çfarë i ka ndodhur Profetit?", iu lut së ëmës.

Zemra e dhembshur e një nëne nuk mund të refuzonte kërkesën e birit të saj. Shpejt ajo shkoi tek Umu Xhemilja. Me një ndjenjë dëshpërimi e pyeti:

"Ebu Bekri pyet për gjendjen e Muhamedit, birit të Abdullahut."

Ato ishin ditët ku njerëzit kishin frikë të shpallnin hapur besimin e tyre. Umu Xhemilja po ashtu e kishte pranuar Islamin, por kishte frikë nga egërsia e Kurejshëve.

Fillimisht ajo tha se nuk dinte asgjë për Muhamedin apo Ebu Bekrin. Më pas e kuptoi se kjo çështje ishte urgjente. Nëna e Ebu Bekrit nuk do të vinte me vrap të trokiste në derën e saj po të mos kishte diçka serioze. Pastaj i tha: "Ka diçka të çuditshme këtu…"

Ajo doli së bashku me Umu Hajrin dhe shkuan tek Ebu Bekri. Kur e pa Ebu Bekrin në atë gjendje nuk mundi ta përmbante veten. Për momentin nuk u shqetësua të tregonte besimin e saj dhe bërtiti me të madhe:

"Vetëm këta rebelë mund të kenë bërë një gjë të tillë! I lutem Allahut të hakmerret mbi ata për çfarë të bënë!"

Reagimi i Ebu Bekrit ishte ndryshe:

"A është mirë Dërguari i Allahut?"

Menjëherë ajo e kuptoi se e kishte tepruar. Vendosi të tregohej më e kujdesshme dhe tha:

"Nëna jote është në dhomën ngjitur dhe mund të na dëgjojë."

Ebu Bekri kishte besim të plotë tek nëna e tij. Ai i tha:

"Mos ki merak, prej saj nuk do të të vijë asgjë e keqe. Ajo di të mbajë një sekret."

Kjo ishte e mjaftueshme për Umu Xhemilen dhe më në fund i dha Ebu Bekrit lajmin që priste:

"Ai është shëndoshë e mirë!"

Por Ebu Bekri nuk mund të mjaftohej me kaq. Ai ishte simboli i besnikërisë. Edhe një herë e pyeti:

"Ku është ai tani?"

"Në shtëpinë e Erkamit", u përgjigj ajo.

Ebu Bekrit nuk do t'i ndalonin dhimbjet pa e parë vetë Profetin. Ndërsa përpiqej të ngrihej në këmbë, tha:

"Betohem në të Gjithëfuqishmin se nuk do të fus asgjë në gojë deri sa ta shoh të Dërguarin e Allahut me sytë e mi."

Nuk kishte zgjidhje tjetër veçse ta çoje tek i Dërguari i Allahut. Pritën deri në muzg kur ra qetësia. Atëherë e ndihmuan Ebu Bekrin të ecte drejt shtëpisë së Erkamit.

U fut në shtëpi dhe doli përballë më të Dërguarin e Allahut. Ky simbol i besnikërisë filloi të puthte sytë dhe fytyrën e ndritshme të Profetit. Megjithëse ishte në gjendje shumë të keqe shëndetësore, po sillej sikur t'i kishin falur të gjithë botën. Ishte aq i ngazëllyer sa nuk mund të përshkruhej me fjalë. Ebu Bekri e donte Profetin më shumë se nënën dhe babën e vet. Më pas, i Dërguari i Allahut tha se nëse do të zgjidhte një mik nga bashkësia e tij, ai do të ishte Ebu Bekri.[30]

Në këtë çast të gjithë sahabët e pranishëm u përlotën kur panë plagët e Ebu Bekrit. Atmosfera ishte ngarkuar aq shumë me emocion saqë edhe vetë Profeti nuk mund t'i kontrollonte ndjenjat. Ebu Bekri e dalloi mërzitjen e Profetit. Si mund të qëndronte ashtu e të shihte Profetin të mërzitur për atë që i kishte ndodhur atij? Ebu Bekri ishte njeri i ndjeshëm. Menjëherë i vuri nën kontroll

[30] Muslim, *Sahih*, 1/67.

emocionet e veta dhe tha:

"O Profet Fisnik i Allahut, t'u bëfshin fli nëna dhe baba im! Mos u mërzit për mua. Unë jam mirë. Dhimbja e vetme që kam është kjo plagë në fytyrë ku më goditi një nga idhujtarët."

Çfarë dashurie ishte kjo? Ai po ndjente një tjetër trishtim sepse pamja e tij e kishte mërzitur Profetin. Po përpiqej me dëshpërim t'i tregonte atij se ishte mirë. Atë çast u ndje aq afër me Profetin, saqë nuk deshi të humbiste mundësinë për të bërë diçka për nënën e vet. U kthye nga Umu Hajri dhe me një zë të përvuajtur tha:

"O Profet i Allahut, kjo është nëna ime! Ajo ka një dashuri të madhe për mua dhe i respekton prindërit e saj. Ti je një shpirt i pastër nga mëkatet. A mund ta ftosh atë për tek Allahu? Lute Allahun që ta mbrojë atë nga zjarri i Xhehenemit."

Ebu Bekri kishte treguar një sinqeritet të pashembullt në këtë moment. Morali i tij shfaqi një dëshirë vetësakrifice. Si mund të refuzonte Profeti një kërkesë kaq të përvuajtur? Ai ngriti duart dhe iu lut Zotit të Gjithëmëshirshëm. Ai u përgjërua që fara e besimit të mbinte edhe në zemrën e nënës së dashur të Ebu Bekrit.

Ndoshta ishte çasti i duhur për bekimin më të madh. Nëna e Ebu Bekrit, Umu Hajri përqafoi Islamin aty për aty.[31]

Vetëm para pak orësh Ebu Bekri ishte gjendur përballë me vdekjen, ndërsa tani një gëzim i madh e kishte pushtuar. Edhe në kohë të tilla ai mendonte për shpëtimin e të tjerëve. Përqafimi i Islamit nga nëna e tij kishte shëruar çdo vuajtje. Që nga ky çast e për një muaj të tërë ai qëndroi me Profetin në shtëpinë e Erkamit.

Deri në ato ditë Islamin e kishin përqafuar 39 besimtarë. Xhaxhai i Profetit, Hamzai, e pranoi Islamin në të njëjtën ditë kur Ebu Bekri ishte rrahur për vdekje.[32]

[31] Ibn Haxher, *el Isabe*, 8/200.
[32] Hejthemi, *Mexhmau Zeuaid*, 9/267.

Një ditë, i Dërguari fisnik kishte shkuar në Qabe. Edhe kësaj here u përball me Kurejshët. Menjëherë filluan ta ngacmojnë Profetin:

"O Muhamed! A po na thua që të heqim dorë nga adhurimi i idhujve që kanë adhuruar të parët tanë?"

"Po, këtë po ju them", u tha Profeti.

Kjo përgjigje ishte një arsye e mjaftueshme për ta. Ata iu vërsulën si një kope e uritur ujqërish. Nuk e dinin se po persekutonin shpëtimtarin e tyre që donte t'i nxirrte nga errësira në dritë. Ukbe ibn Ebi Muejti e kishte lidhur çallmën e tij rreth qafës së Profetit. Po përpiqej ta mbyste deri në vdekje. Ebu Bekri u tmerrua nga ky incident dhe menjëherë u hodh mbi Ukben. Njëkohësisht përpiqej të mbante larg edhe rrugaçët e tjerë. Ashtu si besimtari nga familja e Faraonit që përmendet në Kuran, Ebu Bekri thirri me zë të lartë:

"A po e vrisni këtë burrë sepse tha që Zoti im është Allahu?"[33]

Në të vërtetë, ishte e palogjikshme të rebeloheshe kundër një njeriu që ishte dërguar nga i Plotfuqishmi. Ai kishte ardhur me mesazhe të përjetshme dhe kishte shfaqur disa mrekulli. Askush nuk po i detyronte të besonin. Ata ishin të lirë të ndiqnin besimet e tyre. Megjithatë nëse do të kishin pranuar, do të kishin shansin të ecnin së bashku me të drejt Parajsës së Përjetshme. Atyre po u ofrohej rruga për shpëtim dhe ishte në dorën e tyre për ta pranuar ose jo.

Kurdo dhe kudo që është shpallur hapur fjala e Allahut dhe drejtësia, gjithmonë ka pasur nga ata që kanë kundërshtuar. Për këtë arsye ka lindur nevoja për njerëz si Ebu Bekri, që i mbrojnë të dashurit me çdo kusht dhe me lot në sy.

Atë mbrëmje kur Ebu Bekri u kthye në shtëpi, vuri re një plagë në kokë. Për momentin nuk e kishte ndjerë gjatë përleshjes. Një nga idhujtarët ia kishte shkaktuar kur e kishte tërhequr nga flokët.

[33] Ibn Hibban, *Sahih*, 14/526; Mu'min, 28.

Shumë vite më vonë, gjatë Kalifatit të Aliut, një bisedë i dërgoi mbrapa në kohë. Aliu pyeti të pranishmit në mbledhje:

"O njerëz! Kush është më guximtari dhe trimi i të gjithë njerëzimit?"

Të gjithë thanë pa hezituar:

"Ti je, o prijësi i besimtarëve!"

Kur dëgjoi përgjigjen e tyre, Aliu tundi kokën në shenjë mohimi dhe pastaj tha:

"Kur përballem me armikun, gjithmonë mundohem të jap maksimumin për ta eliminuar. Sidoqoftë, Ebu Bekri është zotëruesi i vërtetë i trimërisë."

Pas këtij pohimi, Aliu nguli sytë në horizont dhe vazhdoi:

"Një ditë, ndërsa po ngrinim një tendë, po diskutonim kush do ta mbronte Profetin nga ndonjë atentat i mundshëm. Betohem në Allah se Ebu Bekri ishte më trimi nga ne të gjithë."

Bisedimi për ngjarje të kaluara i solli akoma më shumë kujtime. Ai gjithashtu i tregoi ngjarjen që e kemi përmendur më parë ku Ebu Bekri kishte thënë: "A po e vrisni këtë burrë vetëm se tha që Zoti im është Allahu?" Ndërsa Aliu tregonte këto ngjarje, emocionet e pushtuan dhe fjalët po i ngecnin në grykë. Po fliste dhe qante me ngashërim njëherazi. Herë pas here përdorte shaminë për të mbuluar fytyrën në mënyrë që mos tregonte dëshpërimin, por mjekra e tij kullonte nga lotët. Nuk zgjati shumë dhe të gjithë të pranishmit po lotonin. Pas pak, Aliu e mblodhi veten dhe pyeti:

"Tani më thoni, kush është më i shenjtë, besimtari nga familja e Faraonit apo Ebu Bekri?"

Kjo elitë personash e kuptoi si ishte puna. Ndërsa e nënkuptuan përgjigjen, filluan të qajnë përsëri. Ata po vajtonin me aq dhembshuri saqë askush nuk pati fuqi t'i përgjigjej pyetjes. Prandaj Aliu

vendosi t'i përgjigjej vetë:

"Betohem në të Plotfuqishmin! Të qëndroje me Ebu Bekrin ishte më mirë se çdo gjë në botë, përfshirë edhe besimtarin nga familja e Faraonit, sepse ky i fundit e fshehu fenë e tij ndërsa Ebu Bekri e shpalli hapur."[34]

[34] Hejthemi, *Mexhmau Zeuaid*, 9/47.

UDHËTIMI NË ABISINI

Meka ishte kthyer në një vend të rrezikshëm për besimtarët. Për më tepër, emigruesit e parë në Abisini kishin sjellë lajme të mira. Ashtu si ata, edhe Ebu Bekri kërkoi leje të emigronte në Abisini. Kërkesa ishte e arsyeshme, kështu që Profeti i dha leje. Urrejtja dhe dhuna kundrejt myslimanëve ishte rritur së tepërmi në Mekë, por kjo s'do të thoshte se nuk kishte një zgjidhje. Toka është mjaft e gjerë për të jetuar në paqe. Ebu Bekri u largua nga Meka me një kushëririn e tij. Ai ishte i lumtur sepse do të takohej me sahabët e tjerë që kishin emigruar para tij. Myslimanët në Abisni praktikonin lirshëm besimin e tyre dhe adhuronin Zotin e tyre në mënyrën që i kishte mësuar Profeti. Një arsye tjetër që Ebu Bekri ishte i gëzuar ishte se do të praktikonte fenë e tij në liri të plotë.

Pak kohë më vonë ata takuan Ibn Dugunën, një burrë të respektuar nga e gjithë Meka. Ai ishte një nga shokët e vjetër të Ebu Bekrit. Ai u habit shumë kur e pa Ebu Bekrin në rrugë dhe e pyeti me kureshtje:

"Ku po shkon kështu?"

Ebu Bekri u përgjigj:

"Fisi im më përzuri nga qyteti im. Më persekutuan dhe më kërcënuan me jetë."

Ibn Duguna u shokua. Si mund të vihej në një pozitë të tillë një person si Ebu Bekri? Ai ishte një njeri i virtytshëm me një zemër të mrekullueshme dhe një karakter që pëlqehej nga e gjithë bashkësia e Mekës. Ibn Duguna pyeti përsëri:

"Pse ta kanë bërë diçka të tillë? Betohem në Allah se ti ia ke kaluar të gjithëve në ndihmën që u jep të varfërve, në mbështetjen e atyre në nevojë dhe kujdesjen e atyre që ke në përgjegjësi. Kthehu mbrapsht. Që nga ky moment, ti do të jesh nën mbrojtjen time."

Ebu Bekri, në të vërtetë, e kishte lënë zemrën e tij në Mekë. Si mund të duronte ai një jetë në emigrim kur mësuesi i tij i dashur ishte në Mekë? Ai duhet të kthehej dhe të qëndronte në krah të Profetit. Kjo ishte sjellja që pritej nga një njeri që njihej si shembull i besnikërisë. Oferta e Ibn Dugunës ishte një propozim historik që nuk mund të injorohej, dhe ai e pranoi me kënaqësi të madhe.

Kështu, u kthyen së bashku në Mekë. Sapo u futën në Mekë, Ibn Duguna e kapi Ebu Bekrin për dore dhe e çoi në Qabe. Aty ai i foli me zë të lartë turmës që ishte mbledhur:

"O njerëz të Kurejshëve! Unë e kam marrë nën mbrojtjen time të birin e Ebu Kuhafes! Që nga kjo ditë, askush të mos guxojë t'i bëjë keq atij!"

Kurejshët nuk donin ta zhgënjenin Ibn Dugunën. Megjithatë ata kishin një kusht. Ebu Bekri nuk duhet të falte namazet në publik dhe nuk duhet t'i ftonte njerëzit në Islam.

Ebu Bekri ndërtoi një vend në një cep të shtëpisë së tij për të adhuruar Allahun. Aty falte namazet dhe lexonte Kuran me zërin e tij të qetë. Çdo ditë përgjërohej në lot për mëshirë nga Krijuesi. Devotshmëria dhe sinqeriteti i Ebu Bekrit po tërhiqnin vëmendjen e shumë personave të cilët vinin rregullisht dhe ndiqnin faljet dhe këndimin e Kuranit. Shtëpia e tij ishte kthyer në një vend mbledhjeje për skllevërit, gratë dhe fëmijët.

Ftesa në besim përmes praktikës, ishte mënyra më e mirë për të fituar zemrat e shumë personave. Ebu Bekri po e arrinte këtë pa e kuptuar. Megjithatë, nuk u desh shumë që kurejshët të kuptonin

ndryshimet që po ndodhnin tek banorët e tyre. Pa humbur kohë erdhën tek Ibn Duguna dhe i thanë:

"Pa dyshim që ti nuk po e mbron Ebu Bekrin që ai të jetë barrë mbi ne. Megjithatë, kur ai fal namazet dhe këndon Kuran, u tregon njerëzve një sjellje të tillë, sa ne kemi frikë se mos gratë dhe fëmijët tanë pranojnë Islamin."

Ata nuk e kuptuan se me thënien e këtyre fjalëve po pranonin bukurinë e besimit të Ebu Bekrit. Fatkeqësisht, kryeneçësia dhe paragjykimi ishte bërë një pengesë e pakapërcyeshme që i pengoi ata ta përqafonin këtë besim. Ajo që i pengonte më shumë ishte se besimet e tyre false nuk kishin shans të dominonin mbi të vërtetën Hyjnore. Ata po i bënin bisht realitetit dhe po fshihnin dobësinë e tyre nga të tjerët. Pak kohë më vonë u kthyen tek Ibn Duguna dhe i thanë:

"Shko dhe thuaji të qëndrojë në shtëpinë e tij. Atje mund të bëjë ç'të dojë."

Kurejshët po i kërkonin që Ebu Bekri të falej dhe të këndonte Kuran në shtëpinë e tij. Ibn Duguna, i ndikuar nga qëndrimi këmbëngulës i kurejshëve. Ai shkoi tek Ebu Bekri dhe i tha:

"Unë nuk të mora në mbrojtje që ti t'u bëhesh barrë këtyre njerëzve. Ti po i shqetëson ata. Shko dhe falu në shtëpinë tënde."

Për Ebu Bekrin nuk ishte e drejtë të qëndronte nën mbrojtjen e një mosbesimtari, kushti i të cilit ishte që ai të mos ftonte njerëzit në Islam, të mos lexonte Kuran dhe të mos kryente faljet në publik. Në një gjendje të tillë veprimi më i drejtë ishte të kërkoje strehim tek mëshira e Allahut. Gjendja e tij të kujtonte një luan të mbyllur në kafaz. Njerëzimit i duhej zelli dhe thirrja e Ebu Bekrit. Prandaj, Ebu Bekrit iu desh të këputste zinxhirët dhe të bënte detyrën pa marrë parasysh pasojat. Ai po peshonte mundësitë që kishte. Nëse do të vepronte sipas rregullave të tyre, nuk do të kishte problem

për praktikimin e fesë në shtëpinë e tij. Megjithëse, bazat e besimit të tij tregonin që kjo nuk ishte një fe individualiste. Përndryshe, pse do të duronte Profeti kaq shqetësime? Përveç përgjegjësive personale, është detyrë e çdo myslimani të marrë edhe të tjerët për dore dhe t'i prezantojë atyre vërtetën Hyjnore. Kështu, një njeri si Ebu Bekri bëri gjënë e duhur. Shkoi tek Ibn Duguna dhe i tha se nuk do të ishte më nën mbrojtjen e tij dhe se tashmë kishte kërkuar mbrojtje në mëshirën e Allahut.[35]

Fatkeqësisht një pohim i tillë atë kohë konsiderohej një ftesë për telashe. Ebu Bekri kishte këputur zinxhirët e shtrëngimit. Që nga ajo ditë ai do të kryente faljet në Qabe. Megjithëse kjo nuk ishte diçka e lehtë. Kurejshët e morën këtë veprim si provokim të hapur. Të irrituar nga sjellja e Ebu Bekrit, mendonin të ndërhynin dhe vendosën ta ndiqnin në çdo hap që bënte.

Një ditë Ebu Bekri po falej në Qabe. Aty erdhi një prej rrugaçëve të Kurejshit, i cili mori një grusht dheu nga toka dhe e hodhi mbi kokën e Ebu Bekrit, teksa ishte në sexhde, duke e sharë dhe ofenduar. Ndërsa Ebu Bekri po përpiqej të largonte pisllëkun nga koka, erdhi pranë tij një nga të parët e Mekës i cili po e shikonte thellë në sy.[36]

A ishte dëmtuar me të vërtetë ndokush nga sjelljet e tij? Kush mund të justifikonte një egërsi të tillë? Duke shpresuar në një fije ndjeshmërie njerëzore të mbetur tek ky person, Ebu Bekri tha:

"Shiko se ç'më ka bërë ky maskara!"

Fatkeqësisht ky njeri nuk kishte pikën e dhembshurisë dhe u përgjigj:

"Ja ke bërë vetes këtë!"

Nga kjo nënkuptohej se Ebu Bekri duke ikur prej mbrojtjes së Ibn Dugunës, kishte hapur shteg për rrugaçët e Mekës. Ndoshta

[35] Buhari, *Sahih*, 2/804.
[36] Sipas transmetimeve, ky person ishte As ibn Uejl ose Uelid ibn Mugira.

nuk kishte më asgjë për të thënë. Këto ishin vërejtje të një njeriu të pavëmendshëm. Ebu Bekri nuk kishte tjetër zgjidhje por të kërkonte ndihmën e Zotit të tij. Ai ngriti duart lart dhe filloi të përgjërohej:

"Ti je i Gjithëmëshirshmi! Ti je i Gjithëmëshirshmi! Ti je i Gjithëmëshirshmi!"[37]

Lutja e Ebu Bekrit përshkruante mëshirën e pafundme të Allahut, sepse ai tregoi durim të pashembullt kundrejt këtyre huliganëve, të cilët e kishin kthyer në zakon që ditën ta paraqisnin natë dhe të bardhën të zezë. Ebu Bekri shpalosi habinë e tij për mëshirën e Allahut që përfshinte edhe ata që rebeloheshin kundër Tij.

[37] Ibn Hisham, *Siretu Nebeuije*, 2/218.

BOJKOTI

Urrejtja e kurejshëve ndaj myslimanëve nuk kishte të sosur. Ajo rritej nga dita në ditë. Ata dërguan një lajmëtar në Abisini. Një grup burrash me dhurata të çmuara i kërkuan mbretit të Abisinisë t'ua dorëzonte emigrantët atyre. Kjo kërkesë nuk ishte pranuar dhe mbreti i kishte kthyer mbrapsht dhuratat. Kurejshët u kthyen në Mekë duarbosh. Për ta ky ishte një dështim i madh, sepse kjo do të thoshte se myslimanët kishin gjetur një vend ku mund të jetonin dhe të praktikonin të lirë fenë e tyre. Nga dita në ditë, autoriteti i kurejshëve po binte kundrejt myslimanëve. Të sulmoje dhe të ofendoje të varfrit dhe të dobëtit nuk do të ishte e lehtë tani.

Për më tepër, figura të rëndësishme si Hamzai dhe Omer ibn Hatabi kishin përqafuar Islamin. Liderët e Mekës u mblodhën në një takim urgjent për të gjetur një zgjidhje për situatën. Në fund ranë dakord të merrnin masa kufizuese ndaj besimtarëve. Do të ndërprisnin çdo lidhje familjare dhe tregtie me to. Edhe gjëra më të vogla si shitja e ushqimeve do të ndalohej. Myslimanët u shpërngulën nga Meka në një vend aty afër në shkretëtirë. Ata u lanë atje të vdisnin për 3 vjet të tërë.

Ebu Bekri ishte ndër ata që u nxorën nga Meka. Ebu Talibi me shpirtin e tij të dhembshur ia kishte mbushur mendjen që të qëndronin në një pronë të tijën në shkretëtirë. Myslimanët ngritën tenda me çfarë mund të gjenin dhe u përpoqën të mbijetonin në kushtet e vështira të shkretëtirës.

Këto vite dëshpërimi do të ishin një sprovë e madhe. Uria dhe epidemitë e sëmundjeve përfshinë të gjithë bashkësinë. Britmat

trishtuese të fëmijëve që vdisnin nga uria dhe sëmundjet, dëgjoheshin pothuajse çdo ditë. Ebu Bekri ishte ndër ata burra që u përpoqën me çdo kusht të ndihmonin njerëzit me çfarëdo që t'u gjendej.

Tre vitet e dhimbjes kaluan nën retë e errëta të vuajtjes dhe ankthit. Megjithatë, kishte akoma për të hequr. Mbështetësi më i madh i Profetit, Ebu Talibi, ndërroi jetë. Ndërkohë që ishte pikëlluar për xhaxhain e tij, bashkëshortja e tij e dashur, Hatixhja ndërroi jetë gjithashtu. Këto ishin vitet e trishtimit dhe të dëshpërimit…

BESNIKU

Më në fund kishte mbërritur nata e Israsë dhe Miraxhit në të cilën Allahu i Madhërishëm nderoi Profetin e Tij. Me anë të saj Allahu i Plotfuqishëm tregoi se ishte bashkë me Profetin në çdo hap të tij, pavarësisht sprovave të vështira me të cilat ishte përballur myslimanët. Brenda një kohe shumë të shkurtër Profeti kishte përshkuar një distancë marramendëse dhe ishte kthyer me njohuri të panjohura më parë rreth kësaj bote dhe asaj të përtejmes. Koha e shumë viteve ishte tkurrur në pak sekonda në të cilat Profeti ishte bekuar me përgëzime të pakursyera.

Ditën e nesërme ky udhëtim i pabesueshëm ishte tema kryesore në qytet. Mekasit po talleshin me këtë ngjarje dhe po ashtu me pretendimin e Profetit. Ndërsa Ebu Xhehli po kalonte pranë Qabesë, pa disa burra të mbledhur rreth Profetit. Ai u afrua dhe me një ton shpotitës i pyeti:

"Ç'thonë të rejat e fundit? Çfarë ka ndodhur mbrëmë?"

I Dërguari i Allahut u kthye nga Ebu Xhehli dhe u përgjigj me qetësi:

"Mbrëmë Zoti im më çoi në *Bejtul Makdis*[38]."

Ebu Xhehli i hutuar e pyeti:

"Më pas u ktheve në Mekë përsëri?"

Ai e dinte mirë se një udhëtim i tillë i mundimshëm zgjaste disa muaj. Kjo pyetje e tij kishte arritur në sarkazëm. Profeti u përgjigj

[38] Bëhet fjalë për Mesxhidi Aksanë, në Jerusalem.

pa ngurrim:

"Po, unë fala namaz me vëllezërit e mi, Profetët e mëparshëm."

Kur dëgjoi këtë, Ebu Xhehli u hodh nga gëzimi. Kjo ishte një mundësi shumë e mirë për të. Më në fund, mendoi se mund ta zinte në gabim Profetin. Me një ton të butë iu drejtua:

"Nëse e mbledh këtu fisin, a do t'ua thuash edhe atyre këto fjalë?"

Për Profetin nuk kishte asnjë arsye që ta fshihte këtë ngjarje. Kjo ishte një dhuratë e çmuar që Allahu i kishte dhuruar atij. Njerëzit duhet të njoftoheshin, kështu që Profeti pranoi sugjerimin e Ebu Xhehlit. Ky i fundit u gëzua pa masë kur mori premtimin e Muhamedit paqja qoftë mbi Të! Menjëherë filloi të thërrasë me të madhe:

"O bij të Ka'bit! Ejani shpejt këtu!"

Tashmë çdo njeri kishte dëgjuar për pretendimin e jashtëzakonshëm të Muhamedit. Shkuan menjëherë tek Ebu Bekri. Ata ishin të sigurt se sapo Ebu Bekri ta dëgjonte këtë, rruga e tij me atë të Muhamedit do të ndaheshin përgjithmonë. Ky do të ishte fundi i Profetit. Sapo Ebu Bekri hapi derën, i thanë:

"O Atik! Ajo çfarë na ka thënë deri tani shoku yt ka qenë deri diku e logjikshme dhe kanë qenë gjëra jo të ngatërruara. Sidoqoftë, eja dhe dëgjo se çfarë po thotë sot!"

Ebu Bekri ishte njeri i butë dhe kishte frikë se diçka e keqe mund t'i ndodhte mësuesit të tij. I zënë nga paniku, ai u përgjigj:

"Turp të keni! Çfarë i keni bërë kësaj here?"

Duke e vështruar Ebu Bekrin me cinizëm iu përgjigjën:

"Ai është në Qabe dhe po u thotë njerëzve si ka udhëtuar mbrëmë nga Meka në *Bejtul Makdis*."

"Ai pretendon se është kthyer brenda natës!", ndërhyri një tjetër.

Ebu Bekri po i vështronte me keqardhje dhe pastaj u përgjigj:

"O të mjerë! E çfarë ka të çuditshme këtu?"

Ai mendoi të prekte ndjenjat e tyre dhe vazhdoi:

"Unë kam besuar gjëra më të mëdha se këto. Unë besoj se atij i vjen shpallja nga përtej qiejve, ditën dhe natën. Unë dëshmoj para jush për këtë!"

Idhujtarët kishin shkuar në derën e Ebu Bekrit me shpresën për ta futur në dyshime lidhur me vërtetësinë e shokut të tij, dhe ishin të sigurt se ky pretendim i Profetit do të shkëputste lidhjet midis tyre. Por, për çudi, mbetën të habitur nga reagimi i Ebu Bekrit. Të gjithë përtypën krenarinë dhe entuziazmin e tyre, ndërsa Ebu Bekri bëri pohimin që do të mbetet në histori:

"Nëse vetë Muhamedi e ka thënë këtë, atëherë është e vërtetë!"[39]

Këto ishin fjalët e jashtëzakonshme të Ebu Bekrit. Ai nuk i kishte mësuar ato nga ndonjë paraardhës. Për Ebu Bekrin, vërtetësia e një pohimi nuk varej nga ajo çfarë populli i Hixhazit thoshte, por nga fjalët e Muhamedit, të Dërguarit të Allahut, i cili ishte arkitekti i shpirtit dhe mendjes së tij. Për këtë arsye ai nuk bëri pyetje të tilla si: "A jeni të sigurt që e dëgjuat mirë?" apo "A ishte me të vërtetë ai që e tha këtë?" Ebu Bekri nuk kishte shprehur më të voglin dyshim. Ky ishte një zhgënjim i madh për idhujtarët. Me këtë pohim Ebu Bekri kishte marrë titullin "besniku". Që nga ajo ditë ai do të njihej si "*Siddik*", "besniku". Pas kësaj përballjeje me mosbesimtarët, Ebu Bekri nxitoi për në Qabe dhe dëgjoi të gjithë ngjarjen nga goja e Profetit. Edhe një herë ai bëri të njëjtin pohim para Profetit. Në shkëmbim, i Dërguari i Allahut i tha:

"O Ebu Bekr! Ti je një *Siddik*, "Besnik"!"[40]

[39] Ebu Xhafer Taberi, *Rijadu Nadira*, 1/403.
[40] Po aty.

EMIGRIMI I SHENJTË DHE SHPIRTI I MIQËSISË

I Dërguari i Allahut ndjehej aq afër me Ebu Bekrin saqë e vizitonte atë ditë e natë. Ndërkohë, ishte dhënë leja për të emigruar dhe hixhreti për në Medine kishte nisur tashmë. Ashtu si ata që kishin emigruar para tij, edhe Ebu Bekri shkoi tek Profeti për të kërkuar leje për të emigruar. Profeti Fisnik i tha:

"Mos u nxito! Ndoshta Allahu të jep ndonjë shok."

Ebu Bekri e kuptoi shumë mirë se çfarë donte të thoshte i Dërguari i Allahut. Falënderoi Zotin e tij për këtë dhuratë të paçmuar. Menjëherë filloi përgatitjet për udhëtimin jetik që e priste. U bë gati në një kohë të shkurtër. Tani priste vetëm urdhrin e Profetit.

Pak ditë më pas i Dërguari i Allahut shkoi në shtëpinë e Ebu Bekrit në një kohë jo të zakontë. Normalisht vizitat në mes të ditës nuk ishin traditë në atë shoqëri, prandaj Ebu Bekri e kuptoi se diçka e re kishte ndodhur. Po priste me ankth që Profeti të fliste. Në fillim ai i kërkoi që të flisnin vetëm. Ebu Bekri u përgjigj me qetësi:

"Mos ki merak o i Dërguari i Allahut! Ato janë vajzat e mia. Çfarë ka ndodhur?"

Profeti fisnik u përgjigj aty për aty:

"M'u dha leja për të emigruar."

Ebu Bekri u gëzua pa masë nga ajo që dëgjoi dhe e pyeti përsëri:

"A do të shkojmë bashkë o i Dërguari i Allahut?"

"Po, bashkë.", iu përgjigj i Dërguari me qetësi.

Ky vendim do të ndryshonte rrjedhën e historisë. Edhe kësaj here Ebu Bekri ishte nderuar me bekimin që do të ishte shoqëruesi i të Dërguarit të Allahut në këtë udhëtim të shenjtë. A kishte mirësi më të madhe se kjo? Shenjat për këtë ngjarje kishin qenë të dukshme dhe Profeti e kishte nënkuptuar më parë, por dëgjimi i këtyre fjalëve nga goja e Profetit do ta gëzonte pa masë Ebu Bekrin, saqë nuk mundi t'i përmbante lotët.

Kush e di se çfarë mendimesh i kaluan ndërmend ato çaste. Lajmet që kishte dëgjuar nga Uaraka ibn Neufel, sihariqet që i kishte dhënë plaku nga Jemeni dhe parashikimet e bëra nga murgu Bahira, duhet të kenë qenë të vetmet në mendjen e tij. Paracaktimi Hyjnor po bëhej realitet. Ashtu si Profetët e mëparshëm, edhe Profeti Muhamed po largohej nga vendlindja e tij.

Megjithatë, duhet të tregoheshin shumë të kujdesshëm sepse udhëtimi me deve nuk do të ishte i lehtë. Për këtë arsye, ata bënë një marrëveshje me një udhërrëfyes që ishte Abdullah ibn Urejkit. Ai ishte një idhujtar nga fisi Abd ibn Adij.[41]

Ky burrë i njihte mirë viset përreth dhe ishte i besueshëm. Ishte e qartë se në raste të tilla të rrezikshme duheshin njerëz të kualifikuar. Pasi bënë një plan vendosën të takoheshin në Theur pas tre ditësh. Udhërrëfyesi i tyre do të sillte dy deve në vendtakim. Këto deve i kishte blerë Ebu Bekri posaçërisht për udhëtimin.

Ebu Bekri porositi vajzën e tij, Esmën që të takohej me ta në Theur. Sipas planit, ajo do të sillte ushqime dhe lajme nga Meka. Motra e saj, Aishja na bën të ditur më vonë, se Esma i kishte fshehur ushqimet në brezin e saj, të cilit i kishte bërë një shtesë të posaçme. Ajo i solli këto në Theur. Për këtë arsye ajo u quajt edhe "Dhunitakajn", mbajtësja e dy brezave.[42]

Ebu Bekri kishte marrë dhe një masë tjetër paraprake me anë të bariut Amr, i cili kujdesej për delet e tij. Ai i kishte thënë Amrit që

[41] Po aty.
[42] Dher', *Zadul Mead*, 3/52.

t'i ndiqte me tufën e deleve që të fshihnin gjurmët.[43]

Më në fund koha kishte ardhur. I Dërguari i Allahut kishte dalë së bashku me Ebu Bekrin nga shtëpia, ndërsa një grup idhujtarësh kishin rrethuar shtëpinë e tij dhe kërkonin ta vrisnin. Profeti fisnik kishte marrë një grusht dhè dhe ua kishte hedhur në fytyrë politeistëve ndërsa recitonte ajete nga Kurani. Vrasësit as nuk e panë fare Profetin kur ai kaloi përmes tyre. I Dërguari i Allahut e dinte se edhe pse po largoheshin nga Meka, politeistët nuk do t'i linin të qetë. Prandaj duhet të merrte masa të sigurta. Ai kishte planifikuar të shkonte në drejtim të një kodre të quajtur Theur. Atje do të mund të fshiheshin në një shpellë dhe të ndiqnin ngjarjet që do të zhvilloheshin në Mekë.

Ebu Bekri u fut vetë i pari në shpellë. Ai ishte shumë i merakosur për jetën e të Dërguarit të Allahut. Përpara se të futej Profeti, Ebu Bekri deshi të kontrollonte vendin. Kishte frikë se mos gjendej aty ndonjë gjarpër. Mbylli sa mundi të gjitha vrimat dhe të çarat që kishte shpella. Përdori çdo gjë për këtë, madje grisi një copë të rrobës së tij.

Të dy qëndruan në shpellë për tri ditë. Ebu Bekri ishte gjithmonë në gatishmëri gjatë këtyre ditëve në mal. Në fund të çdo dite, kur mekasit futeshin në shtëpitë e tyre për të pushuar, djali i Ebu Bekrit, Abdullahu, u sillte atyre lajme të reja nga Meka.

Ndërkohë, në Mekë, idhujtarët kishin shpërthyer shtëpinë e Profetit për ta vrarë, por në vend të tij, kishin gjetur Aliun në shtrat. Profeti u kishte ikur nga duart dhe tashmë po skërmisnin dhëmbët nga inati. Muhamedi duhet të gjendej patjetër. Për këtë vunë një shpërblim të majmë për kokën e tij, gjallë apo vdekur. Kurejshët ishin gati të bënin çdo gjë për të kapur Muhamedin.

Ebu Xhehli ishte një njeri dinak. Sapo dëgjoi që Profeti ishte larguar nga Meka, shkoi në shtëpinë e Ebu Bekrit. Filloi të merrte

[43] Buhari, *Sahih*, 3/1087.

në pyetje të bijën, Esmën. Fillimisht e pyeti se ku ishte i ati. Esma i tha se nuk e dinte, por ai u irritua shumë. Me tërbim e goditi në fytyrë dhe gati i shqeu vathin që kishte në vesh. Në rrethana të tjera, ky veprim i dhunshëm ndaj një vajze të re do të konsiderohej një turp i madh. Megjithatë, ky ishte Ebu Xhehli. Kur Esma e kujton më vonë këtë ngjarje do të thoshte: "Ai njeri ishte një mëkatar i ndyrë!"[44]

Ndërkohë, disa ekspertë të gjurmëve kishin rënë në gjurmët e tyre deri në Theur. U ngjitën në mal për t'i kërkuar, por dështuan në përpjekjet e tyre. Dy shokët e shpellës kishin Allahun të tretin. Idhujtarët iu afruan aq shumë shpellës, saqë Ebu Bekri mund t'u shikonte këmbët dhe të dëgjonte murmuritjet nëpër dhëmbë. Ai u shqetësua aq shumë saqë ankthi mund t'i lexohej në fytyrë. Meraku i tij i vetëm ishte jeta e Profetit. Edhe kësaj here, i Dërguari Fisnik e qetësoi shokun e tij. Ai ishte si një vëlla për Profetin. Ai shikoi thellë në sytë e Ebu Bekrit dhe i tha me qetësi: "O Ebu Bekr! Pse shqetësohesh kur Allahu është i treti prej nesh?"[45]

Kështu foli i Dërguari i Allahut. Ai i tregoi që Allahu e kishte informuar se do ta mbronte nga çdo e keqe që mund t'i vinte nga njerëzit.[46] Profeti ishte i sigurt për këtë. Ai e dinte se Allahu do ta ndihmonte Vulën e Profetëve, ashtu siç kishte bërë edhe me profetët paraardhës. Pa dyshim, i Gjithëmëshirshmi do të sillte paqe dhe harmoni mbi Profetin e Tij dhe nuk do ta braktiste në duart e Kurejshëve. Më në fund ndjekësit u larguan. Tashmë udhëtimi i tyre ndoshta do të ishte pa andralla. Pas pak erdhi Amri me dy devetë. Ai gjithashtu kishte marrë me vete udhërrëfyesin e tyre nga fisi i Abdullah ibn Adij.

Ebu Bekri zgjodhi devenë më të mirë dhe ia dha Profetit:

"Tu bëfshin kurban nëna dhe baba im! Hip mbi këtë deve o i

[44] Buhari, *Sahih*, 3/1419.
[45] Ebu Nuajm, *Hiljetul Eulija*, 2/56.
[46] Buhari, *Sahih*, 3/1337.

Dërguari i Allahut!"

Megjithatë përgjigjja e Profetit ishte e paparashikuar:

"Unë nuk do të hipi mbi një deve që nuk është e imja!"

Ebu Bekri mbeti i shtangur dhe nuk dinte ç'të bënte. Ai tha:

"O i Dërguari i Allahut! Deveja është e jotja!"

Oferta e Ebu Bekrit nuk e zgjidhi problemin. Profeti këmbënguli:

"Nuk do të pranoj deri sa të paguaj shumën me të cilën ti e ke blerë devenë."

Për Ebu Bekrin nuk mbeti zgjidhje tjetër përveç se të tregonte shumën që kishte paguar për devenë. Më pas Profeti tha:

"Do të ta blej për të njëjtën sasi parash."

Edhe gjatë kësaj ngjarjeje me rëndësi të veçantë në histori, Profeti Fisnik po i jepte njerëzimit një mësim me vlerë.

Tashmë kishte ardhur koha të largoheshin nga shpella për t'u nisur drejt destinacionit të tyre, Medinës. Të vetmit persona që shoqëronin Profetin në këtë udhëtim rraskapitës ishin Ebu Bekri dhe një udhërrëfyes jobesimtar. Shumica e ndjekësve idhujtarë ishin kthyer në Mekë duarbosh. Sidoqoftë, disa prej tyre nuk hoqën dorë nga shpërblimi i majmë për kokën e Profetit.

Pasi kishin bërë një copë rrugë në drejtim të Medinës, vunë re një re pluhuri prej së largu. Përsëri Ebu Bekri nisi të shqetësohej. Kësaj here nuk ishin në shpellë dhe nuk kishin ku të fshiheshin. Për më tepër nuk kishin as armë për t'u mbrojtur. Ebu Bekri po frikësohej për jetën e Profetit. I zënë nga paniku, thirri me zë të lartë:

"O i Dërguari i Allahut! Ata po afrohen!"

I Dërguari Fisnik e qetësoi përsëri:

"Mos ki frikë, Allahu është me ne!"

Sigurisht, askush nuk mund t'i bënte keq një njeriu të cilin Allahu e kishte zgjedhur si të dërguar. A kishte vend më të sigurt sesa mëshira e Allahut për t'u strehuar? Ndërsa njëri nga ndjekësit po afrohej, vunë re se ishte Suraka. Ebu Bekri ishte bërë nervoz ndërsa Profeti po e shikonte Surakën drejt në sy. Ishte e qartë se Profeti po përpiqej ta bënte për vete atë me shikimin e tij. Qëllimi i tij ishte ta gjunjëzonte armikun vetëm me të parë.

Ishte një çast nënshtrimi hyjnor. Buzët e Profetit po lëviznin. Ai po i lutej Zotit të tij. Papritur këmbët e para të kalit të Surakës u zhytën në rërë. Kafsha e kishte hedhur Surakën disa metra më tutje. Një re pluhuri u ngrit aty ku ai u rrëzua dhe për çudi, Suraka kishte ngecur në rërë.

Në fillim ai kujtoi se ishte një aksident. Megjithatë kjo ngjarje nuk dukej si aksident. Çfarë mund ta kishte shkaktuar diçka të tillë? Nuk kishte një shpjegim të arsyeshëm. A ishte Muhamedi në vërtetë i Dërguari i Allahut? Po sikur të gjitha ato që thuheshin për të, të ishin të vërteta? Surakës i ndërmendi të gjitha këto për një çast. Nuk kishte shpjegim tjetër. Ai e pa Profetin në sy dhe i tha:

"Lutu Allahut që të më çlirojë nga kjo! Nuk do të të ndjek më, të jap fjalën!"

Muhamedi ishte i Dërguari i Allahut. Si mund të refuzonte një kërkesë të tillë, edhe pse vinte nga një jobesimtar? Profeti u lut dhe Suraka u ngrit menjëherë në këmbë, sikur asgjë të mos kishte ndodhur. Për një moment, mendoi për shpërblimin e majmë. I hipi shpejt kalit dhe u nis drejt Profetit përsëri. Edhe një herë këmbët e kalit u zhytën në rërë. Kësaj here edhe më thellë. Suraka nuk po i jepte një shpjegim kësaj. Ai kishte kalëruar shumë herë në shkretëtirë, por kurrë nuk kishte hasur një gjë të pazakontë si kjo. "Ebu Xhehli e kishte gabim, Ebu Bekri paska thënë të vërtetën!", mendoi me vete. Ishte e qartë se ata po përpiqeshin t'i bënin dëm njerëzve të mbrojtur nga Allahu. Këtë herë, me sinqeritet të plotë,

foli nga thellësia e zemrës:

"O Muhamed! E kuptova se shkaku i këtyre ngjarjeve të çuditshme janë lutjet e tua. Unë kam disa deve në një vend këtu afër. Merri ato, janë të tuat, vetëm më shpëto nga kjo gjendje. Të premtoj se nuk të ndjek më kësaj here."

"Nuk kam nevojë për devetë e tua.", u gjegj Profeti. Pastaj u lut për Surakën. Suraka u ngrit përsëri nga toka me kalin e tij.[47] Ndërsa qëndronte ashtu i pluhurosur, mijëra mendime i kalonin ndërmend. Ndryshimi i thellë shpirtëror që kishte përjetuar i lexohej në fytyrë. I mahnitur nga e gjithë ngjarja, Ebu Bekri po falënderonte Allahun që kishte mbrojtur të Dërguarin Fisnik. Suraka ishte gati për t'u gjunjëzuar. I Dërguari i Allahut po e vështronte Surakën sikur donte t'i thoshte: "Edhe ti?"

"Po, o i Dërguari i Allahut," u përgjigj Suraka. Pastaj i dha fjalën Profetit duke i premtuar se do të ndalonte këdo që do ta përndiqte atë.[48]

Në një rast të tillë secili duhet të tregojë veten dhe, kur është e nevojshme, edhe duke bërë sakrifica të mëdha. Suraka i ishte bindur Allahut dhe duhet ta tregonte këtë besnikëri duke e mbrojtur Profetin. Pas pohimit të Surakës, Profeti tha:

"O Suraka, çfarë do të bësh atë ditë kur të vësh në dorë byzylykët e Kisras?"[49]

Ky ishte një bekim i trefishtë për Surakën. Ai ishte çliruar pa pagesë, ishte bekuar me Islamin dhe nderuar me një sihariq të çuditshëm. Ky sihariq i Profetit la të kuptohej se një nga dy fuqitë më të mëdha të kohës do të nënshtrohej nga myslimanët dhe Suraka do mbante byzylykët që ishin simboli i mbretit. Suraka nuk po arrinte ta besonte një gjë të tillë, prandaj pyeti:

---

[47] Ibn Hibban, *Sahih,* 14/190.
[48] Muslim, *Sahih,* 4/2309.
[49] Ibn Abdelberr, *el Istiab,* 2/851. (Kisra ishte titulli që mbante perandori pers).

"A po flet për Kisran, të birin e Hurmuzit?"

"Po.", tha Profeti.

Ky ishte njëherazi një objektiv që i jepej Surakës dhe të gjithë atyre që ndiqnin Profetin. Suraka që kishte dalë nga Meka me qëllimin për të vrarë Profetin, tashmë po kthehej si një mysliman me një mision të shenjtë mbi shpatulla.

Shumë vite pas këtij incidenti, sihariqi i Profetit do të bëhej realitet gjatë kalifatit të Omer ibn Hatabit. Persia do të çlirohej nga Omeri, i cili do të hiqte byzylykët nga dora e Kisras dhe do t'ia dorëzonte Surakës. Në këtë ditë historike, Omeri do të bënte pohimin e mëposhtëm:

"O Suraka! Ngriji duart dhe thuaj: 'Lavdia i takon Allahut të Plotfuqishëm që i hoqi këto byzylykë nga dora e Kisras, të birit të Hurmuzit, një njeri që pretendonte se ishte zot i njerëzve, dhe ia dorëzoi Surakës, të birit të Mudlizit, nga një fis arab i shkretëtirës.'"[50]

Emigrimi kishte shkaktuar edhe një incident tjetër për Ebu Bekrin. I ati, Ebu Kuhafe, kishte shkuar në shtëpinë e të birit, por nuk e kishte gjetur. Fjalët që qarkullonin tregonin se ai kishte ikur nga Meka. Kjo çështje nuk ishte shaka. Ai kishte lënë pas çdo gjë për të filluar një jetë të re. Ebu Bekri ishte larguar nga Meka duke lënë pas tregtinë, fëmijët, të afërmit, miqtë dhe prindërit e moshuar. Një shpirt që nuk e ka provuar bukurinë e besimit nuk mund ta kuptonte këtë. Kur besimi hyn në zemrën e njeriut, i jep atij një forcë të paimagjinueshme. Në varësi nga grada e besimit të tij, myslimani mund të arrijë gjëra të pakuptueshme nga ata që nuk besojnë. Kur është e nevojshme, këta njerëz janë gati të largohen nga familjet dhe nga të afërmit e tyre në shërbim të Islamit.

Nuk ka dyshim se kur Ebu Bekri i dha fjalën Profetit Fisnik për ta shoqëruar në këtë udhëtim, as nuk e kishte menduar familjen si pengesë. Shumë vite më vonë, kur po përgatiteshin për luftën

[50] Bejheki, *Sunen*, 6/357.

e Tebukut, Ebu Bekri dha çdo gjë që kishte dhe i tha Profetit se familjes i kishte lënë Allahun dhe të Dërguarin e Tij. Ndoshta në këtë çast po përsëriste fjalët që kishte thënë në momentin që kishte lënë familjen për të emigruar në Medine.

Ebu Kuhafe nuk e kuptonte dot këtë largim të të birit. Ai po pyeste këdo që takonte: "Me të vërtetë ka ikur? Si iku ashtu dhe e la familjen pa asnjë mbrojtje?"[51] Ebu Bekri kishte ikur me të vërtetë, pa e kthyer kokën pas. Ishte pikërisht kjo sakrificë që e ktheu të birin e Ebu Kuhafes, Abdullah ibn Osman në Ebu Bekr. Ebu Kuhafe sapo gjeti mbesën e tij Esmën, i bëri një breshëri pyetjesh për shëndetin e të atit: "Për Allah, ai e ka marrë të gjithë pasurinë me vete apo jo?"

"Jo gjysh! Ai ka lënë një pjesë të madhe të pasurisë këtu.", iu gjegj mbesa.

Ebu Kuhafe ishte një burrë plak që po humbte shikimin me kalimin e viteve. Esma e shfrytëzoi këtë dhe mblodhi ca guralecë. Pastaj i mbështolli me një rrobë dhe i tha Ebu Kuhafes t'i prekte. Gjyshi u bind.[52] Esma tregon më vonë se i ati nuk kishte lënë asgjë në familje atëherë. Prandaj veproi në atë mënyrë për të ngushëlluar Ebu Kuhafen.[53]

[51] Ibn Hisham, *Siretu Nebeuije*, 3/15.
[52] Hakim, *Mustedrek,* 3/6.
[53] Ahmed ibn Hanbel, *Musned,* 6/350.

VITET E PARA NË MEDINË

Emigrimi i shenjtë kishte përfunduar me mbërritjen në Medine. I Dërguari i Allahut ishte ftuar dhe vendosur në shtëpinë e Ejub Ensarit, ndërsa Ebu Bekri në atë të Harixhe ibn Zejdit. Ebu Bekri ishte i tillë që nuk pranonte asgjë si lëmoshë. Ashtu si ensarët e tjerë, Harixhe i ofroi atij gjysmën e pasurisë, por Ebu Bekri refuzoi me mirësjellje. Ai kishte 5 mijë dirhemë kapital që donte t'i përdorte për tregti. Ebu Bekri ishte tregtar i zoti dhe nuk mund të qëndronte duarkryq. Ai e nisi sërish tregtinë në Medine. Ky ishte një mësim tjetër që ai u jepte atyre që qëndronin pranë Profetit.

Pak kohë më vonë, i dërgoi lajm të birit, Abdullah që ta sillte pjesën tjetër të familjes në Medine. Ndryshimi i klimës kishte ndikuar keq në shëndetin e Ebu Bekrit, i cili ishte sëmurur disa herë. Kishte zënë shtratin dhe ishte me temperaturë të lartë. Familja e tij tashmë po kërkonte momentin më të mirë për të emigruar. Nuk zgjati shumë dhe Abdullahu solli në Medine nënën e tij Umu Ruman, motrat Esma dhe Aishe, si dhe vajzat e Profetit, Fatimen dhe Umu Kulthumin. Ebu Kuhafe parapëlqeu të qëndronte në Mekë. Megjithëse do të mbetej krejtësisht vetëm, ai nuk mund të kuptonte dot arsyen e këtij emigrimi.

Largimi nga Meka kishte qenë një zgjedhje e vështirë, por myslimanët nuk kishin zgjidhje tjetër. Ditën që Profeti u largua nga Meka, ktheu kokën pas dhe tha: "Betohem në Allah! Ti je vendi më i dashur për Allahun në rruzullin tokësor. Pa dyshim, unë kurrë nuk do të isha larguar prej teje nëse nuk do të më kishin

detyruar me forcë!"[54]

Për muhaxhirët nuk ishte e lehtë të ambientoheshin me kushtet e reja. Shumë prej tyre u sëmurën. Simptoma më e shpeshtë ishte temperatura e lartë. Aishja i kërkoi leje Profetit të vizitonte të atin. Ebu Bekri ishte në një dhomë me Amr ibn Fuhajran dhe Bilal Habeshiun.

Aishja shkoi tek babai i saj. Ebu Bekri ndjente shumë dhimbje. Nga temperatura e lartë gati humbiste ndjenjat. Aishja e pyeti:

"Baba i dashur! Si ndjehesh?"

Ebu Bekri ishte kredhur në botën e tij në ato çaste dhe u përgjigj:

"Njeriu fle i qetë në rehatinë e shtëpisë së tij, por nuk e di se vdekja është më afër tij se rroba që ka veshur."[55]

Aishja nuk po kuptonte asgjë. Ajo mendoi se i ati ishte në një gjendje të humbur. Ajo iu drejtua Amrit:

"O Amr, si ndjehesh ti?"

Gjendja e Amrit nuk ishte shumë ndryshe nga ajo e Ebu Bekrit. Ai filloi të murmuriste diçka rreth vdekjes dhe qëndrimit larg shtëpisë dhe Mekës. Aishja e kuptoi se ishte e kotë t'i flisje edhe Amrit. Së fundmi u përpoq t'i fliste Bilalit. Ai dukej se ishte pak më mirë se të tjerët. Të paktën ai qëndronte ulur. Ndoshta po e merrte veten sadopak nga sëmundja. Ai foli me zë të ulët:

"A do të më vijë përsëri kjo mundësi? Mundësia që të kaloj natën në luginat e Mekës, mes erës së pemës së Ithirit dhe Xhelilit? A do të pi përsëri nga uji i Mexhanës ndërsa shikoj me ëndje bukurinë e Malit Sham dhe Tafil?"

Gjendja emocionale e të tre burrave ishte e njëjtë. Ishte e dukshme që i kishte marrë malli për Mekën dhe sëmundja e kishte

[54] Ahmed ibn Hanbel, *Musned*, 5/393.
[55] Buhari, *Sahih,* 2/667.

përkeqësuar këtë. Sapo Aishja u kthye në shtëpi ia tregoi Profetit të gjitha. Profeti i Mëshirës menjëherë ngriti duart nga qielli duke u lutur, sepse Allahu i kishte sjellë ata për ta dashur Medinën po aq sa kishin dashur Mekën, dhe për ta larguar nga ky qytet një herë e mirë malarien.[56]

Lutjet e Profetit gjetën përgjigje dhe sëmundja u largua nga Medina për në rrethinat e Xhufës. Që nga ajo ditë, Medina do të bëhej një vatër qytetërimi dhe shtëpia e besimtarëve…

[56] Po aty.

FUNHASI DHE EBU BEKRI

Ftesa e njerëzve në Islam ishte një detyrë e vazhdueshme për të gjithë myslimanët. Natyrisht edhe Ebu Bekri vazhdonte të përçonte mesazhin në Medinë. Ai takohej me shumë njerëz dhe secilit i fliste për bukurinë e besimit të cilin e ndjente thellë në zemër.

Rastësisht Ebu Bekri takoi një burrë të quajtur Funhas. Ky person kishte njohuri të mira të shkrimeve të shenjta. Ai ishte një dijetar që u tregonte histori nga Teurati fëmijëve në Sinagogë. Funhasi edukonte fëmijët në mënyrë që ata të bëheshin dijetarë të së ardhmes. Nëse ky njeri do të pranonte Islamin, shumë njerëz të cilët e respektonin do të ndikoheshin prej tij për të pranuar Profetin e Fundit. Një ditë, Ebu Bekri shkoi për ta takuar dhe filloi t'i fliste për themelet e besimit. Ai u përqendrua në jetën pas vdekjes dhe theksoi pasojat e fshehjes së të vërtetës. Pas një diskutimi të gjatë, Ebu Bekri i tha:

"Turp të kesh o Funhas! Ki frikë Allahun dhe eja në Islam. Ti e di shumë mirë se Muhamedi është i Dërguari i Allahut. Kjo është shumë e qartë në Bibël dhe në Teurat."

Funhasi nuk kishte ndërmend të dorëzohej para Ebu Bekrit. Zuri të tallej me gjërat më të rëndësishme të besimit të Ebu Bekrit.

"O Ebu Bekr, ne nuk kemi nevojë për Allahun. Allahu ka nevojë për ne. Ai kërkon nga ne më shumë sesa ne kërkojmë prej Tij. Ne jemi më të pasur se Ai. Nëse Allahu do të ishte më i pasur, nuk do të kërkonte pjesë nga pasuria jonë, siç thotë mësuesi yt. Ai e ka ndaluar për ju kamatën, por ne na e ka lejuar. Po të kishte qenë më

i pasur se ne, nuk do të na e kishte lejuar edhe neve."

Ebu Bekri ishte njeri me sedër dhe nuk mund të lejonte një ofendim të tillë ndaj Zotit të tij. Funhasi me anë të një loje fjalësh manipuluese po përpiqej ta paraqiste qymyrin si diamant. Për më tepër gjuha e përdorur ishte fyese. Përpara se të përfundonte fjalinë, Ebu Bekri e zuri për fyti. Kjo ishte diçka që nuk e priste. Pastaj Ebu Bekri i tha me zë kërcënues:

"O armik i Allahut! Betohem në të Gjithëfuqishmin që ka në dorë shpirtin tim, se do të ta kisha këputur kokën tani sikur të mos kishim një marrëveshje mes nesh."

Ebu Bekri ishte një njeri i sjellshëm e i edukuar, dhe kjo sjellje ishte e pazakontë për të. Megjithatë, kur bëhej fjalë për cenimin e emrit të Allahut dhe Profetit, ai ishte i patrembur dhe nuk kishte shok në trimëri.

Funhasi kishte mbetur i fyer për shkak të vetë sjelljes së tij të pahijshme. Me shpejtësi shkoi tek Profeti për t'u ankuar për Ebu Bekrin. Sjellja e tij arrogante ishte e dukshme. Sidoqoftë dukej se ai nuk e kishte nxjerrë mësimin akoma, sepse gjatë gjithë kohës përpiqej t'ia hidhte fajin Ebu Bekrit për incidentin. Funhasi nuk tha asgjë për fyerjet që kishte bërë. Profeti fisnik thirri Ebu Bekrin dhe e pyeti përse kishte vepruar në atë mënyrë. Ebu Bekri u turpërua, por duhet të tregonte fytyrën e vërtetë të këtij njeriu. Funhasi po ankohej për një njeri të cilin e kishte ofenduar. Normalisht, Ebu Bekri nuk ishte nga ata që justifikonte veprimet e veta përpara të tjerëve. Por, kësaj here duhet të tregonte çdo gjë ashtu siç kishte ndodhur. Prandaj filloi të shpjegonte:

"O i Dërguar fisnik i Allahut! Ky njeri është armik i Allahut. Ai ka bërë një mëkat të madh. Ai tha gjëra të shëmtuara për Allahun e Plotfuqishëm. Ai tha se Allahu është i varfër dhe se ata janë më të pasur se Ai. Nuk munda ta përmbaj veten, dhe e godita për hir të Allahut."

Funhasin e zuri paniku kur dëgjoi çdo gjë ashtu siç ishte në të vërtetë. Zgjidhja e tij ishte të mohonte pretendimin e Ebu Bekrit.

"Unë nuk kam thënë asgjë nga këto!" u përgjigj.

Çfarë burri ishte ky? Po e akuzonte Ebu Bekrin për gënjeshtër. Ndoshta në momentin kur del e vërteta në shesh, nuk ka më kthim prapa.

Nuk zgjati shumë dhe zbritën ajetet kuranore që vërtetonin besnikërinë e Ebu Bekrit. Qiejt filluan të flasin dhe Xhebraili i solli shpalljen Hyjnore Profetit Muhamed. Vargjet kuranore përmendnin fjalët e thëna nga Funhasi dhe shpjeguan se të tillë njerëz hipokritë do të ndëshkoheshin në zjarrin e Xhehenemit.[57]

[57] Ibn Hisham, *Siretu Nebeuije,* 3/96-97.

DREJT BETEJËS SË BEDRIT

Zemrat e tyre ishin në Qabe dhe në Mekë… Njerëz si Utbe, Ukbe, Shejbe, Ebu Lehebi dhe Ebu Xhehli ishin në Mekë… Besimtarët me udhëzimin e tyre Hyjnor, Profetin Fisnik, po bënin një jetë të qetë në Medine. Harmonia dhe lumturia e kryerjes së detyrimeve fetare në liri ishte e paimagjinueshme. Sidoqoftë, duart e përlyera të idhujtarëve nuk do t'i linin të qetë edhe në Medinë. Ata kishin mbetur të fyer që besimtarët u kishin ikur nga duart dhe zemërimi rritej dita ditës.

Më në fund rrugët e tyre u kryqëzuan në Bedër. Kjo ishte hera e parë që takoheshin në fushën e betejës. Duhet të merreshin masa të rrepta, sepse puna e shumë viteve varej nga ky çast. Kjo ishte dita e llogarisë ku zemrat që rrihnin për Allahun do të përballeshin me një armik tre herë më të madh në numër. Për këtë arsye i Dërguari i Allahut hapi krahët dhe ngriti duart duke kërkuar ndihmë nga Zoti i tij:

"O Allah! Nëse kjo bashkësi e vogël do të mundet, atëherë nuk do të mbetet asnjë në tokë për të të shërbyer Ty! Na jep fitore mbi armikun, O i Plotfuqishëm!"

Ndërsa Profeti i nderuar vazhdonte të lutej, Ebu Bekri ngriti rrobën e cila i kishte rënë nga supet dhe e vuri mbi supet e Profetit. Pastaj e përforcoi lutjen e Profetit me fjalët në vijim:

"Mos u mërzit, i Dërguari i Allahut! Allahu do të të japë fitoren që ke kërkuar!"

Në mendjen e Profetit nuk kishte dyshime. Pak minuta më parë,

ai u kishte treguar sahabëve vendet se ku do të vdisnin një nga një idhujtarët. Pastaj kishte bërë pohimin: "Allahu na ka premtuar fitore!"[58]

Kjo do të thoshte se çdo mysliman duhet ta përmbushte këtë detyrë. Ebu Bekri e dinte me saktësi se çfarë duhet të bënte, dhe kjo ishte mbështetja shpirtërore. Pas faljes së namazit, Profeti fisnik po pushonte nën tendë, kur papritur u ngrit në këmbë dhe pa Ebu Bekrin. Më pas bëri pohimin historik: "Sihariq për ty o Ebu Bekr! Ska dyshim se ndihma e Allahut ka ardhur tek ti! Këtu është Xhebraili duke pritur urdhrat ndërsa qëndron mbi kalin e tij të armatosur rëndë."[59]

Të gjitha përgatitjet ishin bërë dhe ishte koha të zhvishnin shpatat. Profeti fisnik doli nga tenda dhe bëri një shenjë inkurajimi ushtrisë së tij. Më në fund beteja kishte filluar. Nuk zgjati shumë dhe fitorja ishte e dukshme. Kurejshët të cilët kishin ardhur në Bedër për ta mbyllur çështjen një herë e mirë, po ktheheshin në Mekë me parulla hakmarrjeje. Ata kishin pësuar një humbje të madhe. Përveç numrit të madh të të rënëve në betejë, ata po linin pas 70 nga ushtarët e tyre që kishin rënë robër.

Profeti në çdo vendim që merrte zgjidhte rrugën e mesme. Pas betejës ai u këshillua me sahabët se si duhet të vepronin me robërit e luftës. Omeri ibn Hatabi propozoi që robërit të vriteshin. Ndërsa Ebu Bekri tha që të liroheshin kundrejt një shume të caktuar. Ai mendoi se me këto para do të fuqizohej ushtria e tyre. Profeti fisnik po mendonte në të njëjtën mënyrë. Ai pranoi propozimin e Ebu Bekrit. Sipas kësaj marrëveshjeje, robërit që dinin shkrim dhe këndim do të liroheshin pasi t'i kishin mësuar 10 myslimanëve shkrim e këndim. Ata që ishin analfabetë do të liroheshin kundrejt një pagese të caktuar.[60]

[58] Ibn Hibban, *Sahih,* 11/114.
[59] Ebu Xhafer Taberi, *Rijadu Nadira*, 2/35.
[60] Ebu Nuajm, *Hiljetu Eulija,* 1/43.

Fati e kishte caktuar që djali i madh i Ebu Bekrit, Abdurrahmani të ishte në radhët e ushtrisë kurejshe. Ai do të luftonte kundër të atit.

Ndërsa beteja kishte filluar, Ebu Bekri donte të përballej me të birin në dyluftim, por Profeti nuk e lejoi. Ndoshta, Profeti e dinte se një ditë Abdurrahmani do të gjente të vërtetën. Për këtë arsye, Profeti nuk deshi që Abdurrahmani t'i mohonte vetes të vërtetën.

Shumë vite më vonë, kur Abdurrahmani pranoi Islamin[61], midis tyre u zhvillua një bisedë rreth incidentit në Bedër. Kur Abdurrahmani po përshkruante gjendjen e tij atë ditë në Bedër, tha se nëse babai i tij Ebu Bekri do të ishte përballur me të, ai nuk do ta kishte luftuar. Ebu Bekri nga ana tjetër mendonte ndryshe. Ai u betua në Allah se po të ishte përballur atë ditë me të, do ta kishte vrarë.[62]

[61] Abdurrahmani pranoi Islamin gjatë incidentit të Hudejbijes.
[62] Halebi, *Siretu Halebije*, 2/374.

NJERIU I BETEJAVE

Ebu Bekri e kishte treguar trimërinë e tij në Bedër dhe vazhdoi ta tregonte atë duke qëndruar në krah të Profetit në të gjitha betejat që pasuan. Ai ishte njeri i sakrificës së madhe. Në betejën e Uhudit ai kishte qëndruar pranë Profetit në çastet kur gjërat kishin dalë jashtë kontrollit. Kur Profeti fisnik e pa Ebu Bekrin të nxirrte shpatën dhe të sulej i vetëm kundër armikut, i tha:

"Fute shpatën në brez o Ebu Bekr! Mos na trishto duke sakrifikuar veten tënde!"[63]

Ebu Bekri ishte aq i përqendruar në betejë saqë nuk e kishte dëgjuar fare thirrjen e Profetit. Profetit iu desh ta thërriste përsëri. Më në fund, Ebu Bekri e kishte dëgjuar zërin e bekuar të Profetit. Shpejt u tërhoq nga të rënit shehid, gjë të cilën e dëshironte aq shumë.

Ditën e Betejës së Tebukut, i Dërguari Fisnik ia kishte dorëzuar flamurin e Islamit Ebu Bekrit. Ishte një flamur i madh, i zi, të cilin Ebu Bekri duhet ta mbante në betejë kundër ushtrisë bizantine. Ai ishte njeri i ekuilibruar. Kjo veçori unike e Ebu Bekrit kishte dominuar gjithmonë në beteja të tilla si në Bedër, Hendek dhe Hudejbije. Ai kishte qenë gjithmonë i gatshëm për të ndihmuar Profetin të vendoste harmoni ndërmjet sahabëve. Guximi që kishte treguar gjatë gjithë betejave ishte përtej kufijve. Në çdo betejë detyra e tij ishte të mbronte Profetin dhe për këtë çështje ai ishte gati të jepte jetën pa hezitimin më të vogël. Edhe në situata ku emocionet ishin në nivele të larta, ai nuk do të devijonte nga rruga e drejtë. Ai jetonte çdo frymëmarrje me drejtësi. Ishte Ebu Bekri i cili

[63] Ebu Xhafer Taberi, *Rijadu Nadira,* 2/46.

e ngushëlloi dhe e bindi Omerin gjatë konfuzionit në Hudejbije. Megjithëse përmbajtja e marrëveshjes ishte në dukje negative për myslimanët, në të vërtetë Hudejbije ishte një fitore e madhe.

Në atë ditë vendimtare Ebu Bekri e kishte kapur prej dore Omerin në një mënyrë të ashpër duke i thënë:

"S'ka dyshim se ai është i Dërguari i Allahut! Ai nuk mund të rebelohet ndaj Allahut! Ai ka mbështetjen e të Gjithëfuqishmit! Mos e tradhto atë dhe bindiu në çdo rast! Betohem në Allah, se ai është në rrugën e drejtë!"[64]

Ebu Bekri kurrë nuk ishte larguar nga mësuesi i tij i dashur. Ai kishte qenë një mbështetje e madhe në ditët më të vështira, si në Tebuk, edhe Hunejn. Omer ibn Hatabi rrëfen një incident që ndodhi ditën e Tebukut:

"Ishim rrugës për në Tebuk. Tensioni ishte i lartë. Pas një udhëtimi të lodhshëm e të gjatë, ndalëm në një vend për të pushuar. Ishim shumë të etur për ujë. Midis nesh pati të tillë që therën devetë e tyre për të pirë ujin që ato kishin në bark, për të mos vdekur nga etja. Kur e pa Ebu Bekri këtë, shkoi tek Profeti dhe i tha:

"O i Dërguari i Allahut! S'ka dyshim se Allahu i përgjigjet lutjeve të tua. A do të lutesh për ne?"

A kishte rrugë tjetër në këto çaste dëshpërimi sesa t'i drejtoheshe Krijuesit kur shkaqet ishin të pafuqishme? Profeti pyeti:

"Me të vërtetë e dëshiron këtë?"

Përgjigja ishte e shpejtë dhe nga zemra:

"Po!"

Profeti Fisnik ngriti duart lart menjëherë dhe filloi t'i kërkojë ndihmë Allahut. Pa e përfunduar akoma lutjen, re të rënda filluan të mblidhen. Pak më vonë, retë erdhën sipër nesh dhe sollën shiun

[64] Muslim, *Sahih,* 3/1411.

dhe motin e freskët.

Ushtria myslimane shoi etjen dhe u freskua nga shiu i rënë pas lutjes së Profetit. Ndërsa ushtarët përgatiteshin për të marshuar, u përballën me një tjetër mrekulli. Shiu po binte vetëm mbi sipërfaqen që mbulonte ushtria myslimane. Pjesa tjetër rrethuese e kampit kishte mbetur e thatë dhe nën diellin përvëlues."

POZITA E EBU BEKRIT PRANË PROFETIT

Pozita e atyre që i kishin vënë shpatullat kauzës së Islamit edhe në kohë vështirësish ekstreme, duhet të ishte e veçantë. Këta persona kishin zënë një vend unik pranë Allahut. Allahu i Plotfuqishëm e shpjegon këtë dallim në ajetin e mëposhtëm:

"...Nuk janë të barabartë ata që kanë shpenzuar dhe kanë luftuar para fitores me ata që kanë shpenzuar dhe kanë luftuar më pas."[65]

Edhe sjellja e Profetit nuk ishte ndryshe. Ata që kishin qëndruar pranë tij në ditët e hershme të Islamit, kishin vlerë unike. Në fakt, askush nuk mund ta imagjinonte se sa shpërblim të madh kishin fituar ata që qëndruan afër Profetit në kohën kur vështirësitë ishin të rënda. I Dërguari i Allahut ishte një pasqyrë e paimitueshme që reflektonte moralin e Allahut. Si mund t'i trajtonte ndryshe ndjekësit e tij?

Kauza Hyjnore që ishte ngjizur në shpellën Hira, kishte pasur mbështetje të vazhdueshme që në ditët e para. Ata që i kishin qëndruar pranë që në momentet e fillimit, të parët e të parëve, kishin vend të veçantë në zemrën e Profetit. Ai e kishte bërë të qartë këtë në çdo vend ku kishte ardhur mundësia dhe e kishte shfaqur në sjelljen e tij ndaj tyre.

Një ditë, i Dërguari i Allahut ishte ulur me sahabët, teksa pa shokun e tij të dashur të afrohej. Ai dukej i mërzitur. Profeti e kuptoi që larg gjendjen e tij emocionale. Pastaj tha:

"Shokut tonë i ka ndodhur diçka!"

[65] Hadid, 10.

Ai e njihte shumë mirë atë. Fytyra e Ebu Bekrit ishte e zbehtë dhe në trup i dalloheshin shenja rraskapitjeje. Ai erdhi dhe u ul pranë Profetit. Pastaj me zë të ulët filloi të flasë:

"Ndodhi diçka midis meje dhe Omer ibn Hatabit. Më duket se u solla pak ashpër me të dhe i theva zemrën. Në çast u ndjeva fajtor dhe i kërkova falje, por ai nuk e pranoi. Prandaj erdha tek ti, o Dërguari i Allahut."

Profeti u mërzit nga dëshpërimi i Ebu Bekrit. Ai nuk mund ta shikonte në këtë gjendje shokun e tij besnik. Në fillim u lut: "Allahu u tregoftë i butë me Ebu Bekrin!"

Kjo ishte edukata e Profetit. Ai lumturohej nga gëzimi i shokëve të tij dhe mërzitej nga dëshpërimi i tyre.

Papritur atmosfera kishte ndryshuar dhe dukej sikur re të zeza kishin rënë mbi ta.

Ndërkohë, Omeri ishte penduar për sjelljen e tij dhe shkoi në shtëpinë e Ebu Bekrit për t'i kërkuar falje. Ai nuk e gjeti atë në shtëpi, ndaj nxitoi drejt xhamisë. Gjendja e tij shpirtërore ishte e njëjtë me atë të Ebu Bekrit. Ai përshëndeti Profetin dhe hyri në xhami. Ndërkohë që kërkonte një vend për t'u ulur, Omeri e ndjente tensionin. Pendimi i tij ishte i thellë, por ishte tepër vonë. Koha nuk mund të kthehej prapa për të ndryshuar veprimin që kishte bërë. Në atë çast, dukej se Omerit të Madh i kishin shteruar të gjitha energjitë. Zemra e Ebu Bekrit mund të mos e pranonte më atë. Ai ra në këmbët e Profetit fisnik dhe u përgjërua:

"Për Allah! Unë veprova keq! Ishte faji im!"

Ai ishte aq i sinqertë, saqë përsëriste vazhdimisht të njëjtat fjalë me një ton zëri që lutej për falje. Edhe retë e ngarkuara me shi ishin gati të shpërthenin në mëshirë. Profeti fisnik iu drejtua të gjithë të pranishmëve me fjalët e tij:

"Betohem në Allah! Kur Ai më dërgoi mua Profet, ju të gjithë

mendonit se isha mashtrues! Ebu Bekri ishte i vetmi, i cili tha, 'Ti dëshmon të vërtetën!'. Ai më mbrojti mua me jetën e tij dhe me gjithçka kishte! A nuk do ta linit pranë meje mbështetësin tim (besnik)?[66]

Çfarë mund të thuhej pas këtyre fjalëve kaq të sinqerta? Të gjithë pohuan me kokë. Si një kor i heshtur, secili pohonte: "The të vërtetën o Profet fisnik." Edhe kur e kishte zemrën të thyer, Ebu Bekri shqetësohej për ndjenjat e të tjerëve. Ai mendonte për hidhërimin që ndjente personi tjetër dhe qortonte veten si shkaktar. Ndërkohë që Ebu Bekri ishte larguar nga turma, ai kishte qarë në heshtje.

Ky ishte karakteri i tij. E si mund të sillej ndryshe? Por për fat të keq, këto gjëra ndodhnin herë pas here. Në një rast tjetër, ai pati një keqkuptim me Rabiatul Eslemin. Çështja u paraqit përpara Profetit. Ebu Bekri e kishte lënduar me fjalë Rabian. Ai u mundua ta shlyente këtë duke kërkuar nga Rabia që edhe ai t'i thoshte të njëjtat fjalë, por për fat të keq, Rabia nuk pranoi dhe Ebu Bekri tha:

"Ose ti do të marrësh atë që të takon me të drejtë, ose unë do ta çoj këtë çështje tek Profeti."

Rabia nuk ndryshoi qëndrim. Ishte e qartë se e vetmja mënyrë për ta zgjidhur problemin ishte të kërkonin ndihmë nga Profeti. Menjëherë shkuan tek ai. Në atë çast, një grup burrash nga klani i Eslemit, të cilët e kishin marrë vesh incidentin, ishin ulur me Profetin. Ata po e kritikonin sjelljen e Ebu Bekrit, kur Rabia ndërhyri:

"Pushoni! Ju po flisni për Ebu Bekrin, jo për një njeri çfarëdo! Allahu e quan atë *'i dyti prej të dyve'* në shpellën Theur. Mos flisni kundër tij për të më mbrojtur mua! Profeti do të pikëllohet nga dëshpërimi i tij. Pa dyshim, pikëllimi i Profetit do të sjellë zemërimin e Allahut ndaj nesh! Dhe ai do të ishte fundi i Rabias!"

Ebu Bekri shpjegoi gjithçka që kishte ndodhur. Shprehja e fytyrës së Profetit tregonte se ai nuk ishte i kënaqur nga ato që

[66] Buhari, *Sahih,* 4/1701.

kishte dëgjuar. Ai pa nga Rabia dhe i kërkoi atij me një ton zëri të pakënaqur se ç'problem kishte me Ebu Bekrin. Edhe Rabia ishte i mërzitur nga e gjithë ngjarja, megjithatë dëshironte që ta sqaronte atë. Kishte një detaj të cilin ata nuk e kishin vënë re. Rabia tha:

"O Profet fisnik, ai m'u drejtua me disa fjalë jo të mira. Më pas sugjeroi që edhe unë t'i thoja atij të njëjtat fjalë. Megjithatë, unë nuk pranova."

Profetit të Allahut i pëlqeu sjellja e Rabias dhe e këshilloi atë që të lutej:

"Allahu të mëshiroftë ty, o Ebu Bekr!"

Ishte e qartë se Profeti nuk dëshironte që të turbullonte mikun e tij të dashur, i cili kishte qenë përkrah tij që në fillim. Për këtë arsye, ai po i kërkonte Rabias që të lutej për të. Mbështetja e Profetit ndaj tij, edhe në situata ku ai mund të ishte në gabim, e prekën kaq thellë zemrën e Ebu Bekrit, saqë zuri të qante. Sipas dëshmisë së Rabias, Ebu Bekri u ul në një qoshe dhe shpërtheu në lot.[67]

[67] Hakim, *Mustedrek*, 2/189.

MATURIA DHE AFTËSIA E TIJ PËR TË KUPTUAR

Megjithëse ishte një ndër personat më eruditë mes besimtarëve, Ebu Bekri kurrë nuk e përdori këtë si avantazh për të ngritur reputacionin e tij. Ai kishte qenë dëshmitar i pothuajse të gjitha shpalljeve që i zbritën Profetit dhe kishte njohuri për traditat më të respektueshme profetike. Ndoshta, kjo është arsyeja, pse ai ishte një ndër dy njerëzit i cili kishte dhënë fetva ndërkohë që Profeti ishte ende gjallë.

Pavarësisht kësaj, ai e fshihte aq shumë zgjuarsinë e tij, saqë nuk fliste përveç rastit kur i drejtohej një pyetje. Ai preferonte që t'i linte të tjerët të pyesnin Profetin, kështu çdo njeri do të kishte mundësi të merrte informacion prej tij nga afër. Njerëzit si Ebu Bekri, ishin kaq të ndjeshëm, saqë kur uleshin pranë Profetit, silleshin sikur të kishin zogj mbi kokat e tyre. Ata drithëroheshin nga mendimi se mund ta shqetësonin Profetin. Në lidhje me këtë, ai kishte pohuar:

"Cila mbretëri do më pranonte mua, apo nën cilin qiell do të gjeja strehim, nëse bëj vërejtje që kundërshtojnë librin e Allahut."[68]

Një ditë, u shpall ky ajet: "*As dëshirat e tua dhe as ato të Njerëzve të Librit (nuk mund të mbizotërojnë): kushdo që bën keq do të ndëshkohet sipas veprës së tij. Përveç Allahut, nuk do të gjeni tjetër mbrojtës e ndihmues.*[69]

Ebu Bekri u zhyt në mendime të thella pasi dëgjoi këtë ajet. Ai mundohej të kuptonte përmbajtjen e ajetit hyjnor. Dukej se nuk

[68] Ibn Ebi Shejbe, *Musannef,* 6/136.
[69] Nisa, 123.

kishte rrugëdalje për Ebu Bekrin. Si mundej, i biri i Ebu Kuhafes, të flinte në një natë të tillë? Me të shpejtë ai shkoi tek i Dërguari i Allahut. Fytyra i ishte zbehur dhe zemra i rrihte si e marrë. Me zërin që i dridhej, pyeti:

"O Profet i lartësuar! Ky ajet na ka thyer më dysh. A ka ndonjë prej nesh i cili nuk gabon?"

Edhe një herë, i takonte Profetit që të ngushëllonte Ebu Bekrin. Ai ia nguli vështrimin Ebu Bekrit dhe i kujtoi atij mosmarrëveshjet dhe mundimet që njerëzit kalojnë në këtë jetë. Më pas, Profeti tha:

"Këto janë gjërat për të cilat do të shpërblehesh në jetën e përjetshme."[70]

Në një tjetër rast, kur Ebu Bekri ishte ulur bashkë me Profetin, një burrë erdhi dhe filloi ta mallkonte atë. Duke qenë aq pranë Profetit, ai u ndje jashtëzakonisht i poshtëruar. Ai nuk mund t'i jepte asnjë shpjegim fyerjeve të atij personi. Me cepin e syrit ai hodhi vështrimin për të parë reagimin e Profetit. Profeti i lartësuar po buzëqeshte dhe kjo i dha një mbështetje të lehtë zemrës së Ebu Bekrit.

Për fat të keq, burri nuk kishte ndërmend të ndalonte dhe vazhdonte me fyerje dhe sharje. Më në fund, Ebu Bekri nuk duroi më dhe vendosi të ndërhynte me një përgjigje. Përpara se ai të thoshte fjalët në mbrojtje të vetvetes, Profeti i lartësuar u çua dhe u largua prej aty. Ai nuk po buzëqeshte më. Me ta parë këtë gjë, Ebu Bekri po ashtu u ngrit dhe vrapoi pas Profetit. Ai nuk mund të duronte që ta shihte Profetin të mërzitur. Kur e arriti atë, i tha:

"O Profeti fisnik i Allahut! Ti ishe aty kur ai njeri po më fyente. U mundova ta ndalja kur ai i kaloi kufijtë. Përse u largove i zemëruar?", e pyeti ai respektueshëm.

Ebu Bekri u soll me modesti ndërkohë që përpiqej të kuptonte

[70] Ibn Hibban, *Sahih,* 7/170.

mësimin që Profeti i lartësuar po i jepte me anë të sjelljes. Profeti heshti për një çast dhe më pas bëri një pohim, të cilin duhet ta kujtojë çdo mysliman:

"Nuk ka dyshim se ndërkohë që ti qëndroje i heshtur, një engjëll përgjigjej në vendin tënd. Sapo fillove ta mbrosh vetveten, aty erdhi Shejtani. Nuk doja të qëndroja në të njëjtin vend me të."

Pas këtij shpjegimi, Profeti i lartësuar e përgjithësoi çështjen me komentet e mëtejshme:

"O Ebu Bekr! Tri gjëra janë të vërteta:

Allahu do t'i lartësojë dhe do t'i shpërblejë ata të cilët ruajnë qetësinë për hir të Allahut kur të tjerët u bëjnë keq atyre.

Cilido që hap një derë në emër të së mirës dhe i jep me zemërgjerësi atyre që janë pranë tij, Allahu do t'ia shtojë pasurinë dhe mirëqenien.

Cilido që kërkon prej të tjerëve me qëllim për të shtuar pasurinë, Allahu do t'ia shtojë varfërinë."[71]

[71] Ahmed ibn Hanbel, *Musned,* 2/436.

SHENJAT E PARA TË LARGIMIT

Thellësia e zgjuarsisë, shkathtësia dhe mendjemprehtësia e tij ishin në një shkallë të paarritshme. Që në fjalët e para, ai e kuptonte të tërë fjalinë dhe se ç'qëllim kishte ajo. Kur dita e largimit ishte afruar, Profeti Fisnik tha një predikim:

"Allahu e la të zgjedhë shërbëtorin e vet, midis kësaj bote dhe asaj e cila është tek Allahu, dhe shërbëtori zgjodhi këtë të fundit."

Ndoshta askush nuk e kuptoi se ç'donte të thoshte Profeti me këto fjalë, ndërsa Ebu Bekri mbuloi fytyrën me të dyja duart dhe qau me zë të lartë. Ata që e panë atë nuk mund ta kuptonin përse Ebu Bekri reagoi aq fort ndaj një pohimi të tillë. Të paqartë, ata pyesnin përse ai qante. Sipas Ebu Bekrit, personi të cilit i ishte kërkuar të bënte zgjedhjen, nuk ishte tjetër veçse vetë Profeti. Fjalët dëshmonin se ndarja tashmë ishte e afërt. Mendimi i largimit të Profetit pas kaq vitesh së bashku, kishte prekur një pjesë tepër delikate të zemrës së Ebu Bekrit. Ai nuk mund ta ndalonte të qarën.

Edhe një herë tjetër, ishte Profeti Fisnik i cili duhet të ngushëllonte Ebu Bekrin. Profeti e dinte se Ebu Bekri e kishte kuptuar domethënien e fjalëve të tij. Ai tha: "Mos qaj o Ebu Bekr… mos qaj." Pastaj, me zë më të lartë, Profeti tha se kur bëhet fjalë për pasurinë dhe miqësinë, Ebu Bekri është më i besueshmi prej të gjithë njerëzve, dhe nëse do t'i duhej që të zgjidhte një mik të vërtetë, do ta deklaronte Ebu Bekrin si "*Halil*" (miku i sinqertë). Që nga ky moment fillon vëllazëria dhe dashuria në Islam. Mbyllini të gjitha dyert që hapen në Xhami, derën e Ebu Bekrit lëreni të hapur.[72]

[72] Buhari, *Sahih,* 1/77.

Vlera e Ebu Bekrit përkrah Profetit ishte kaq e madhe, sa edhe kur Profeti paralajmëroi largimin e tij nga kjo botë, ai ngushëlloi Ebu Bekrin i cili u brengos nga ky lajm. Për më tepër, Profeti e lavdëroi dhe e komplimentoi atë duke deklaruar se të gjitha dyert do të mbylleshin, përveç asaj të Ebu Bekrit. Ishte e qartë se atmosfera shpirtërore në shtëpinë e Ebu Bekrit nuk ishte e ndryshme nga ajo në xhami.

NJERIU I BESUESHMËRISË DHE I SIGURISË

Pavarësisht nga dijet e thella që kishte për Islamin, ai mbështetej plotësisht mbi të Dërguarin e Allahut. Kur diskutohej një çështje e caktuar, ai mjaftohej me mendimin e Profetit. Nëse ekzistonte ndonjë hadith në lidhje me çështjen në fjalë, atëherë nuk kishte më vend për diskutime. Sipas Ebu Bekrit, fjala e fundit ishte ajo e Profetit.

Në atë kohë ekzistonin dy superfuqi të mëdha, Perandoria Bizantine dhe Perandoria Perse. Midis të dyjave kishte filluar një luftë e përgjakshme, ku Persët që ishin adhurues të zjarrit kishin ngadhënjyer mbi Bizantinët që konsideroheshin si ithtarë të Librit. Bizantinët ishin mundur aq keq, saqë askush nuk mendonte se do të rimëkëmbeshin përsëri.

Çfarë rëndësie mund të kishte kjo fitore mbi krahinën e Hixhazit? Në fakt, ajo kishte pasoja të mëdha, sepse idhujtarët e Mekës, të cilët nxirrnin kuptime nga çdo ngjarje, e përdorën këtë kundër myslimanëve. Kjo luftë mbarte edhe një kuptim tjetër; ishte një luftë ndërmjet besimit në një Zot të vetëm dhe politeizmit. Fitorja e adhuruesve të zjarrit mbi të Krishterët u përdor nga Kurejshët si argument se e njëjta gjë do t'u ndodhte edhe myslimanëve. Kurejshët ishin nga ana e Persëve. Kjo ishte një mundësi për t'u treguar myslimanëve se një fuqi tokësore kishte fituar mbi atë hyjnore. Sipas kësaj logjike, edhe kurejshët që ishin fuqia tokësore, do të triumfonin mbi myslimanët, të cilët konsideroheshin si përfaqësuesit e kauzës hyjnore.

Ndërsa ky debat vazhdonte me ditë të tëra, zbriti surja "Rum", me anë të së cilës, Kurani pohonte se Bizantinët do të triumfonin

mbi Persët për 3 ose 9 vjet. Ky ishte një lajm i madh për Kurejshët të cilët e përdorën për t'u tallur me Myslimanët. Sipas tyre, Kurani kishte parashikuar të pamundurën. Kur Ubej ibn Halef u takua një ditë me Ebu Bekrin, hapi menjëherë bisedën në fjalë. Ai përmendi këtë ajet kuranor dhe filloi të tallej me të. Ebu Bekri nuk kishte dyshime rreth ajetit dhe e mbrojti Kuranin me rigorozitet. Të dy ishin këmbëngulës në argumentet e tyre dhe ranë dakord që në fund të tre viteve, humbësi do t'i jepte 10 deve fituesit.

Pas kësaj Ebu Bekri shkoi menjëherë tek Profeti dhe i tregoi për marrëveshjen. Profeti Fisnik i rikujtoi Ebu Bekrit kohën që nënkuptohej në ajet. Ajeti shprehej qartë se kjo ngjarje do të ndodhte për 3 deri 9 vjet. Megjithatë Ebu Bekri e kishte interpretuar si 3 vjet. Profeti i sugjeroi ta ndryshonte marrëveshjen dhe të rriste numrin e viteve, dhe po ashtu, edhe atë të deveve.

Sapo mori këshillën e Profetit, Ebu Bekri u kthye tek Ubej ibn Halefi dhe i propozoi që periudha kohore të shtyhej deri në 9 vjet dhe numri i deveve po ashtu. Nga ana e Ubejes nuk pati asnjë kundërshtim, pasi askush në Gadishullin Arabik nuk besonte se Persët do të mundeshin. Marrëveshja ishte mbyllur.

Kaluan të 9 vitet dhe në vitin 627 të dy ushtritë ishin sërish përballë njëra-tjetrës. Në betejën e madhe të Ninovës, parashikimi i ajetit kuranor ishte përmbushur. Ushtria Bizantine kishte mundur Perandorinë e madhe Perse. Afërsisht, po në të njëjtën kohë, myslimanët ishin përballur në Bedër me idhujtarët dhe fitorja e premtuar nga Allahu ishte bërë realitet. Myslimanët ishin shumë të gëzuar, sepse kishin mundur idhujtarët për herë të parë në fushëbetejë. Ata falënderuan dhe madhëruan Allahun e Plotfuqishëm. Kurejshët morën një goditje të dytë me lajmin e fitores së Bizantinëve mbi Persët. Gjërat nuk kishin shkuar ashtu siç e kishin menduar ata. Për më tepër, kishin pësuar edhe një disfatë në Bedër. Në kundërshtim me spekulimet e tyre, Kura-

ni kishte triumfuar.[73]

Ubeje kishte ikur tashmë në vendbanimin e fisit të tij. Për këtë arsye, Ebu Bekri shkoi tek familja e tij dhe kërkoi 100 devetë. Tradita e tyre i detyronte t'i përmbaheshin marrëveshjes dhe i dorëzuan Ebu Bekrit 100 devetë. Çfarë mund të bënte një njeri bujar si Ebu Bekri me kaq deve? Natyrisht, do t'i jepte për bamirësi. Ebu Bekri bëri atë që duhej dhe ua dhuroi të gjitha personave në nevojë.[74]

[73] Ajeti pohon qartë se myslimanët do të gëzoheshin në të njëjtën ditë. Rum, 2-5.
[74] Ibn Kethir, *Tefsir,* 3/405.

MODESTI DHE SINQERITET

Një ditë, i Dërguari i Allahut, ndërsa po mbante një predikim, papritur ndali dhe pyeti:

"A ka ndonjë midis jush që agjëron sot?"

Pas një çasti heshtjeje, Ebu Bekri u përgjigj me zë të ulët duke thënë se ai po agjëronte. I Dërguari i Allahut pyeti përsëri:

"A ka ndonjë që ka dhënë sadaka?"

Edhe kësaj here mbizotëroi heshtja e ndjekur nga zëri i turpshëm i Ebu Bekrit:

"Unë kam dhënë o i Dërguari i Allahut."

Pyetjet vazhduan:

"A ka ndonjë që ka falur një namaz xhenazeje sot?

Dukej sikur Profeti po bisedonte me një person të vetëm. Ebu Bekri përsëri u përgjigj:

"Unë kam falur."

Profeti fisnik vazhdoi:

"A ka ushqyer ndonjë nga ju një njeri të uritur sot?"

Asgjë nuk ndryshoi nga më parë. Tani ishte e qartë se i Dërguari i Allahut po u bënte të njohur xhematit se kush ishte shoku i tij i dashur, Ebu Bekri. Ai e dinte se Ebu Bekri kurrë nuk do t'i përmendte këto virtyte po t'i lihej atij në dorë. Edhe një herë ai u përgjigj:

"Unë o i Dërguari i Allahut."

Ishte momenti i fundit ku Profeti do të bënte pohimin përfundimtar. Ai u kërkoi të gjithëve të ishin dëshmitar për këto fjalë:

"Kushdo që bën të gjitha këto vepra të mira në një ditë të vetme, do të jetë i falur nga mëkatet, dhe kësodore do të meritojë Parajsën."[75]

[75] Muslim, *Sahih, 2*/713.

FILANTROPISTI

Ebu Bekri ishte lideri i një grushti besimtarësh që kishin kushtuar jetët dhe pasuritë e tyre në kauzën hyjnore. Teksa sakrifikonte gjithçka në rrugë Allahut, Ebu Bekri nuk mendoi as edhe për një çast të vetëm të ardhmen e tij. Ai kishte dhënë çdo gjë kishte, pa frikë. Ndërsa kishte shpërndarë të gjithë pasurinë, Allahu i kishte dhuruar akoma më shumë, si një shpërblim për sjelljen e tij. Personalisht, Ebu Bekri kishte jetuar si njeriu më i varfër i Hixhazit ndërsa vazhdonte të sillte gjithçka kishte tek Profeti, në mënyrë që t'i shërbente kauzës së tij.

Një ditë, i Dërguari Fisnik i Allahut po mbante një ligjëratë përpara njerëzve kur dikush përmendi kohët e mëparshme në të cilat myslimanët kishin kaluar vuajtje të mëdha. Në ato ditë Ebu Bekri konsiderohej nga njerëzit më të pasur të Mekës. Pasuria që kishte vënë numërohej në 40 mijë dirhemë. Me të përqafuar Islamin, nisi ta shpërndajë pasurinë e tij në emër të Allahut. Aq shumë kishte dhënë në këtë rrugë, saqë kur shkoi në Medine, i kishin mbetur vetëm 5 mijë dirhemë. Profeti Fisnik e përshkroi filantropinë e Ebu Bekrit me pohimin e mëposhtëm:

"Nuk kam parë aq shumë përfitime nga pasuria e askujt, përveç të asaj të Ebu Bekrit."

Një njeri si Ebu Bekri gjithmonë përpiqej t'i fshihte virtytet e tij. Ai u ndje aq i turpëruar, saqë shkoi në një cep të xhamisë dhe filloi të qante me ngashërim, sikur të kishte bërë ndonjë mëkat. Pa dyshim, ai kishte dhënë fjalën që në fillim se do të jepte çdo gjë në rrugë të Islamit. Pak minuta më vonë, pasi e mblodhi veten, u

përgjigj i turpëruar:

"U bëfshin kurban pasuria dhe vetja ime për ty, o i Dërguari i Allahut! Çdo gjë që kam është e jotja!"[76]

Edhe në kohë dëshpërimi, ku të tjerët dhanë me shumicë dhe menduan se e kaluan Ebu Bekrin, ai erdhi dhe dhuroi gjithçka kishte. Pas kësaj askush s'mund ta kalonte Ebu Bekrin në harxhimin e pasurisë në rrugën e Zotit. Ai nuk shqetësohej për të ardhmen. Besimi dhe nënshtrimi i tij ndaj Allahut dhe të Dërguarit te Tij ishin aq të mëdha, saqë edhe familjen e tij e la nën mbrojtjen e Allahut dhe të Dërguarit të Tij. Sinqeriteti dhe Besnikëria e tij ishin të qarta, si kristali.

Në shumë raste ai vuajti urinë për ditë të tëra dhe nuk i tregoi askujt. Prej tij nuk ishte dëgjuar kurrë as ankesa më e vogël. Shpeshherë dilte në rrugë kur nuk kishte diçka për të ngrënë dhe shumicën e rasteve vraponte për tek Profeti. Aty do të prekej nga gjendja e Profetit dhe e harronte veten e tij.

Një ditë Profeti po bisedonte me sahabët e tij. Ebu Bekri ishte ulur në një cep dhe po dëgjonte fjalët që dilnin nga goja e bekuar e Profetit. Ai kishte veshur një rrobë të vjetër, jaka e së cilës ishte kapur me një gjemb. Tashmë, tregtari i pasur nga Meka, Ebu Bekr, jetonte në varfëri. Ai nuk kishte më para as për t'u veshur. Ai nuk ishte në këtë gjendje ngase s'kishte mundësi. Ai kishte sakrifikuar çdo gjë vetëm që të tjerët të mos vuanin. Kjo ishte një veçori që kishte vend të veçantë tek Allahu i Lartësuar. Papritur u shfaq Xhebraili. Ai përshëndeti Profetin dhe pastaj u kthye nga Ebu Bekri . Engjëlli e pyeti:

"O Ebu Bekr! Çfarë është kjo rrobë që ke veshur? Pse e ke kapur jakën e saj me një gjemb?"

Sigurisht që engjëlli e dinte përgjigjen, por ai do të gjykonte në varësi të reagimit të Ebu Bekrit. I Dërguari i Allahut u përgjigj:

[76] Halebi, *Siretu Halebije,* 2/200.

"O Xhebrail! Ky burrë shpenzoi çdo gjë që kishte për kauzën time para triumfit të Mekës!"

Engjëlli kishte gjetur rastin e volitshëm për të dhënë sihariqin:

"Thuaji Ebu Bekrit që Allahu e përshëndet atë! Allahu ka një pyetje për të: 'Si një njeri i varfër, a është ai i kënaqur me Zotin e tij?'"

Çfarë mund të bënte Ebu Bekri në një moment të tillë ku virtytet ia kishte vërtetuar engjëlli Xhebrail? Ai shpërtheu në lot dhe qante me ngashërim. Ebu Bekri kishte marrë përshëndetje nga Allahu dhe tani Ai e pyeste nëse ishte i kënaqur. Duhet të përgjigjej. Foli me vështirësi të madhe.

"Si mund të mos jem i kënaqur me Zotin tim? Unë jam i kënaqur me Ty, o Allahu im… unë jam i kënaqur me Ty, o Allah!"[77]

Ndoshta, për shkak të kësaj, Ebu Bekri dhe Omeri ishin vezirët më të mëdhenj të Profetit në Tokë, ashtu si Xhebraili dhe Mikaili ishin vezirët e qiellit.

Nuk kishte ditë që Ebu Bekri mos të vizitonte Profetin. Qëndrimi i tij në praninë e bekuar të Profetit e bëri atë të ishte në shënjestër të komplimenteve profetike. Një ditë, ndërsa qëndronin mbi malin Uhud, ai u trondit nga një tërmet dhe Profeti thirri me zë të lartë:

"Qetësohu o Uhud! Mbi ty janë një Profet, një Sidik dhe dy shehidë!"

Këto ishin lajme që parashikonin të ardhmen dhe vinin nga qiejt përtej.

Profeti Fisnik, i cili e kishte përgëzuar disa herë me Xhenet Ebu Bekrin, në një rast tha:

"O njerëz! Duhet ta dini se Ebu Bekri kurrë nuk ka bërë diçka

[77] Isfahani, *Hiljetu Eulija,* 7/105.

që të më ketë mërzitur mua!"[78]

Me këtë pohim, Profeti u tregoi atyre rëndësinë e lidhjes që ekzistonte midis bindjes dhe Besnikërisë. Në përgjithësi, 10 Sahabët e përgëzuar me Xhenet, kishin një vend të veçantë në zemrën e Profetit. Kjo ishte mëse e qartë në jetën e përditshme. Këta individë ishin të parët. Gjatë luftërave ata do të rreshtoheshin përpara Profetit dhe në kohë paqeje gjatë namazit ishin menjëherë pas tij. Kjo ishte mëse e zakonshme dhe të tjerët e kishin pranuar atë tashmë.

Ndërmjet gjithë këtyre burrave, Ebu Bekri ishte më i preferuari i Profetit. Profeti e donte atë më shumë se të tjerët. Ai ishte si një krah i djathtë për Të. Ndonjëherë ai e përdorte atë si sekretar të shpalljes Hyjnore dhe kur ishte e nevojshme, Ebu Bekri i mësonte të tjerët si të silleshin kur ishin pranë Profetit kur shkonin për ta vizituar. I Dërguari i Allahut nuk humbiste rast për t'i bërë komplimente Ebu Bekrit. Një herë tha:

"Ashtu siç ti ishe shoku im në shpellë, po ashtu ti do të jesh një zotëri pranë shtëpisë sime në Parajsë."[79]

Ebu Bekri nuk priste asgjë në shkëmbim për të mirat që u bënte njerëzve. Ai shpresonte vetëm në shpërblimin e Allahut. Ai kurrë nuk ua përmendte njerëzve të mirat që u kishte bërë. Ai nuk mund t'i prekte ndjenjat apo nderin e tyre. Profeti fisnik ishte në dijeni të këtij virtyti dhe gjithmonë e urdhëronte për të.

Ai i kishte dhënë për grua vajzën e tij, Aishen, të Dërguarit të Allahut. Aishja ishte nëna e të gjithë besimtarëve. Megjithëse ishte vajza e tij, Ebu Bekri i thërriste asaj në formë respekti "nëna ime". Sipas ajeteve kuranore, Aishja nuk ishte më e bija e Ebu Bekrit, por nëna e besimtarëve.

Kur shpifësit hipokritë e kishin akuzuar Aishen për imoralitet,

[78] Ebu Xhafer Taberi, *Rijadu Nadira,* 1/227.
[79] Tirmidhi, *Sunen*, 5/613.

midis atyre që u përfshinë në thashetheme ishte edhe Mistah ibn Uzase, i cili jetonte në varfëri dhe Ebu Bekri ishte i vetmi person që e ndihmonte.

Ebu Bekri u mërzit shumë kur mori vesh se në shpifje ishte përfshirë edhe Mistahu. Për shkak të ndjeshmërisë që kishte ndaj fesë së tij, Ebu Bekri e ndërpreu ndihmën që i jepte Mistahut. Nuk zgjati shumë dhe zbritën vargjet kuranore:

"Njerëzit e pasur dhe të ndershëm ndër ju të mos betohen se nuk do t'u japin të afërmve, të varfërve dhe të mërguarve në rrugën e Allahut; le t'i falin ata dhe të mos ua marrin për keq! Vallë a nuk doni ju që t'ju falë Allahu? Allahu është Falës e Mëshirëplotë."[80]

Ebu Bekri ishte i tillë që e jetonte jetën në përputhje me ligjet Hyjnore. Ai u pendua në çast dhe tha: "Betohem në Allah, se dua që Ai të më falë!"

Pastaj filloi përsëri ta ndihmonte Mistahun. Ai i kishte bërë një premtim vetes:

"Për Allahun! Unë do të vazhdoj ta ndihmoj pa vonesën më të vogël!"[81]

Ndoshta kjo ishte arsyeja që të gjitha dyert e parajsës ishin të hapura për Ebu Bekrin.

Një ditë Profeti fisnik shpjegoi se për çdo vepër të mirë të kryer nga një person, gjendet një portë e caktuar që hapet në Parajsë. Ebu Bekri u bë kureshtar dhe pyeti:

"A ka një njeri që të mund të hapë të gjitha portat e Parajsës?"

Profeti fisnik u përgjigj:

"Po, dhe unë po ju them që tani se ti je një prej tyre!"[82]

[80] Nur, 22.
[81] Muslim, *Sahih,* 4/2136.
[82] Nesai, S*unen,* 5/9.

Ebu Bekri ishte nga personat e pakët i cili interpretoi ëndrrat në prani të Profetit.

Në mbështetje të vendit të dalluar që ai zinte pranë Profetit, Said ibn Musejeb, një nga ata që patën fatin të takohen me Sahabët e Profetit, ka thënë:

"Ebu Bekri ishte si një këshilltar i Profetit. Ai këshillohej me të për çdo çështje. Ai ishte i dyti që pranoi Islamin, i dyti në shpellë, i dyti në betejën e Bedrit dhe i dyti në botën tjetër. I Dërguari fisnik nuk vinte askënd tjetër në vend të tij."[83]

[83] Hakim, *Mustedrek,* 3/66.

DITA E TRIUMFIT

Idhujtarët kishin thyer kushtet e marrëveshjes së Hudejbijes duke sulmuar dhe derdhur gjak në mes të natës në një fshat myslimanësh. Kjo ishte një shenjë e qartë. Për këtë kishte zbritur një Sure ditën e Hudejbijes e cila thoshte se fitorja mbi Mekën do të ishte e sigurt. Parashikimi i Kuranit jepte sihariqin se Meka do të çlirohej shumë shpejt.[84] Kjo do të thoshte se koha kishte ardhur. I Dërguari i Allahut i tha Aishes të bënte gati plaçkat për rrugë. Megjithatë, kjo duhet të mbahej sekret.

Ndërsa Aishja bëhej gati për udhëtimin, Ebu Bekri erdhi në shtëpinë e saj. Me zgjuarsinë e tij shpejt e kuptoi se diçka po ndodhte. Filloi të bënte pyetje pas pyetje. Megjithatë, Aishja, nëna e besimtarëve, preferoi të mos fliste. Ebu Bekri nuk mundi të nxirrte asnjë fjalë nga Aishja. Një figurë lideri si Ebu Bekri nuk mund të lihej pa u informuar për një ngjarje të tillë me rëndësi. Nxitimthi vrapoi për tek Profeti. Filloi t'i bënte të njëjtat pyetje edhe Profetit Fisnik. Kësaj here mori një përgjigje për të gjitha pyetjet së bashku:

"A po përgatitemi për një ekspeditë luftarake o i Dërguari Fisnik i Allahut?"

"Po!", u përgjigj Profeti.

"Bijtë e Asfarit?"

"Jo!"

"Populli i Nexhidit?"

[84] Fet'h, 27.

"Jo!"

"Atëherë duhet të jenë Kurejshët?"

"Po!"

"Dakord, o i Dërguari i Allahut, po a nuk kemi ne një marrëveshje me ta?"

"Po, e kishim… por nuk e paske marrë vesh se ç'kanë bërë ata në zonën e bijve të Ka'bit?"

Ebu Bekri e kuptoi se dita e madhe kishte ardhur. Me shpejtësi edhe ai filloi të përgatitej për udhëtim.

Më në fund një ushtri prej 10 mijë vetash po nisej nga Medina. Kur u afruan pranë Mekës, i vendosën çadrat në një vend të lartë. I Dërguari i Allahut urdhëroi që çdo person të ndizte nga një zjarr. Kur Kurejshët panë mijëra zjarre rreth e përqark Mekës, u zunë në befasi. Shpejt e kuptuan se nuk kishin mundësi ushtarake të luftonin me një ushtri kaq të madhe. Numri i zjarreve tregonte se ishin afërsisht 50 mijë veta në këtë ushtri afër Mekës. Arsyeja për këtë ishte se në atë kohë ishte traditë që rreth një zjarri të mblidheshin 5-6 veta sëbashku. Sipas kësaj logjike, numri i ushtarëve rreth Mekës duhet të ishte rreth 100 mijë.

Lideri i Mekës, Ebu Sufjani e kuptoi se përballja ishte e kotë për shkak të diferencës së madhe në numër të dy ushtrive. Prandaj vendosi ta zgjidhte çështjen me një marrëveshje. Ai erdhi personalisht për të folur me njerëzit aty në mënyrë që t'i bindte të largoheshin nga Meka. Midis atyre që vizitoi ishte edhe Ebu Bekri. Kur u takua me Ebu Bekrin insistoi që marrëveshja të rishkruhej dhe të rritej kohëzgjatja. Sidoqoftë, Ebu Bekri nuk ishte nga ata burra që të merrte një vendim të tillë me rëndësi pa u konsultuar. Duke menduar për Profetin ai i tha:

"Mendimi im nuk është ndryshe nga ai i Profetit të Allahut. Betohem në Allah! Nëse marr vesh se edhe gruri dhe misri ju kanë

shpallur luftë, unë do t'i mbështes ato."[85]

Ky ishte një shembull zgjuarsie dhe ishte shpalosur në sy të armikut pa kurrfarë trembjeje. Ebu Sufjanit s'i kishte mbetur gjë tjetër veçse të kthehej në Mekë duarbosh. Më në fund, Meka ishte çliruar dhe, emigrantët, të cilët ishin përzënë nga shtëpitë e tyre, po ktheheshin përsëri.

Ebu Bekri kishte një detyrë të rëndësishme që nuk mund të priste. Me nxitim shkoi në shtëpinë e babait të tij të moshuar. Me një ton lutës ai donte të zbuste shpirtin e plakut. Islami kishte triumfuar dhe koha për Ebu Kuhafen kishte ardhur. Ebu Bekri ishte më i lumtur se kurrë. Ai e mori Ebu Kuhafen për dore dhe e çoi tek Profeti.

Kur i Dërguari i Allahut i pa të dy, babë e bir, të afroheshin, u ngrit dhe tha:

"O Ebu Bekr! Pse e ngrite plakun deri këtu? Mund të shkonim ne tek ai."

Kjo nënkuptonte se ishte koha të fitoheshin zemrat dhe shpirtrat e njerëzve. A nuk e meritonte një kompliment të tillë ky plak që i kishte bërë ballë ndarjes nga i biri? Ebu Bekri po ashtu u përlot nga kjo skenë mallëngjyese. Ai mendoi për gjendjen në të cilën ishte Profeti dhe kushtet në të cilat ishin myslimanët që kishin rrethuar Mekën. Pastaj tha:

"Ishte më mirë që ai të vinte pranë teje, o i Dërguari i Allahut."

Pasi Ebu Kuhafe deklaroi shehadetin, të gjithë shpërthyen në lot. "Dëshmoj se nuk ka Zot tjetër përveç Allahut dhe Muhamedi është i Dërguari i Tij!" Profeti ishte aq i gëzuar, saqë e uroi Ebu Bekrin për vendimin e të atit. Ebu Kuhafe ishte një shërbëtor i bindur që tani njihte Zotin e tij. Për më tepër, ky shërbëtor ishte babai i shokut më të ngushtë të Profetit. Për këtë arsye, Profeti e

[85] Ali Muhamed, *Biografia e Ebu Bekr Siddikut*, fq.96.

këshilloi Ebu Bekrin që të kalonte më shumë kohë me të atin dhe i sugjeroi që ai të lyente flokët dhe të ndërronte mënyrën e mbajtjes së tyre.[86]

Ebu Bekri ishte njeriu më i lumtur në botë nga momenti kur i ati pranoi Islamin. Një tjetër gjë e rëndësishme rreth Ebu Bekrit ishte se të gjithë anëtarët e familjes së tij kishin pranuar Islamin duke fituar statusin e Sahabit. Babai, nëna, fëmijët, nipërit dhe mbesat e tij ishin të gjithë myslimanë.

[86] Taberani, *Mu'xhemul Kebir*, 24/88.

LIDERI I PELEGRINËVE

Ishte viti i tetë i hixhretit të shenjtë. Haxhi ishte bërë sakaq një rit i detyrueshëm fetar. Profeti nuk mori pjesë në Haxhin e parë. Ai caktoi Ebu Bekrin si liderin e pelegrinëve të parë. Ata u nisën nga Medina me një grup prej 300 besimtarësh myslimanë. Ky ishte rituali i parë i Haxhit që kryhej.

Pas nisjes së tyre zbritën ajetet kuranore. Profeti Fisnik dërgoi pas tyre Aliun për t'i informuar. Sipas ajeteve të fundit të shpallura, idhujtarët dhe ateistët nuk lejoheshin të futeshin në Qabe. Gjithashtu, kësaj shtëpie adhurimi, ndërtuar vetëm për Allahun, nuk do të lejohej më t'i bëhej tavaf lakuriq. Qabeja ishte vendi i parë i adhurimit i ndërtuar për Allahun.

HAXHI I LAMTUMIRËS

Në vitin e dytë pasi Haxhi u bë një detyrim fetar, Profeti ishte vetë në krye të myslimanëve. Ky ishte haxhi i parë për Profetin dhe ishte e dukshme se do të ishte edhe i fundit. Ndërsa Profeti po mbante hutben në Arafat, fjalët e tij tregonin se kjo do të ishte Hutbeja e Lamtumirës: "Pa dyshim, Allahu e la shërbëtorin e tij të zgjedhë midis kësaj bote dhe asaj pranë Tij."

Përgjatë bisedës, ai bënte ndalesa të shkurtra dhe pyeste: "A e kam përmbushur detyrën?" Përgjigjja prej një zëri e mijëra myslimanëve jehoi përgjatë Arafatit, duke vërtetuar se Profeti Fisnik e kishte përmbushur detyrën, ai ngriti gishtin drejt qiellit dhe tha me zë të lartë: "Ji dëshmitar o Allah!"

Pastaj Allahu i zbriti ajetin që përmbylli Arafatin: "Sot kam përsosur për ju fenë tuaj."[87] Kjo skenë preku thellë zemrat e atyre si Ebu Bekri.

"T'u bëfshin kurban prindërit tanë, o i Dërguari i Allahut!", tha ai.

Ai po përjetonte një dëshpërim të thellë në shpirt. Ai e kuptoi se kush ishte shërbëtori të cilit iu la të zgjidhte midis kësaj bote dhe asaj pranë Allahut. Në ajër ndjehej era e ndarjes dhe e dhimbjes. Ishte e qartë se dita e largimit ishte e afërt. Nëse feja ishte përsosur, atëherë kjo do të thoshte se misioni i Profetit ishte përmbushur. Udhëtimi i përjetshëm ishte i pashmangshëm, përderisa misioni ishte plotësuar.

I tejmbushur me mijëra mendime dhe ndjenja, Ebu Bekri u veçua në një qoshe dhe filloi të qante në vetmi.[88]

[87] Maide, 3.
[88] Muslim, *Sahih,* 4/1854.

KOHA E RIBASHKIMIT

Kjo botë nuk ishte vendi për një miqësi të përjetshme. Kishte ardhur koha që Profeti të ribashkohej me Mikun e Madh. Ndërkohë që momenti i nisjes së tij ishte afruar, Profeti u sëmur dhe në një çast, kishte humbur edhe ndjenjat. Kur u përmend, ai tha:

"Urdhëroje Bilalin të thërrasë Ezanin! Urdhëroje Ebu Bekrin të drejtojë faljen!"

Më pas, Profeti fisnik i humbi sërish ndjenjat. Pak kohë më pas, ai u zgjua dhe pyeti:

"A e falët namazin?"

Mirëpo kjo ishte një situatë e pazakontë dhe ata ende nuk ishin falur. Të gjithë ishin të shokuar dhe nëna e besimtarëve, Aishja, tha:

"Babai im është njeri me zemër të butë; ai nuk mund ta durojë këtë. Do të dëshiroja që të ngarkoje dikë tjetër me këtë detyrë, o Profeti Fisnik i Allahut!"

Pavarësisht këmbënguljes së Aishes, Profeti u zemërua dhe ngriti zërin:

"Urdhëroje Bilalin të thërrasë Ezanin! Urdhëroje Ebu Bekrin të drejtojë faljen!"

Dukej qartë se ky ishte një urdhër i prerë që nuk mund të vihej në diskutim. Urdhri i Profetit duhej përmbushur. Më parë, Profeti kishte pohuar se:

"Për aq kohë sa Ebu Bekri të jetë mes njerëzve të mi, nuk i takon

askujt tjetër të drejtojë faljen."[89]

A nuk e kishte treguar këtë Profeti edhe më parë, kur kishte urdhëruar që të gjitha dyert në xhamitë mbylleshin, përveç derës së shtëpisë së Ebu Bekrit? Profeti nuk mundej më të ishte i vetëdijshëm për periudha të gjata kohe. Edhe një herë tjetër ai humbi ndjenjat, dhe kur u përmend, pyeti nëse kishte filluar falja. Këtë herë Ebu Bekri po drejtonte faljen ashtu siç ai kishte urdhëruar. Profeti fisnik u ngrit me ndihmën e dy sahabëve, të cilët e mbështetën në shpatullat e tyre. Me këmbët që i dridheshin, ai vështroi pas perdes. Me fytyrën që i ndrinte si hëna e plotë, ai pa xhematin e tij për herë të fundit. Kur pa Imamin e tij të zgjedhur që qëndronte në krye, një buzëqeshje rrëzëllitëse u shfaq në fytyrën e tij fisnike. Disa prej njerëzve të cilët e panë atë, thuajse e prishën faljen, por ai i bëri një shenjë duke u treguar se duhet të vazhdonin. Më pas, ai u afrua dhe qëndroi në krah të Ebu Bekrit, i cili u përpoq të kalonte pas tij, por Profeti nuk e lejoi. Kjo do të ishte falja e fundit që ata kryen së bashku.[90] Më në fund, perdja ra për të mos u ngritur më kurrë…

Pas faljes, duke menduar se Profeti po ndihej pak më mirë, Ebu Bekri u nis të vizitonte të afërmit e tij që jetonin në rrethinat e Medinës, në zonën e quajtur Sana. Ndërkohë Dielli kishte perënduar dhe Medina ishte mbuluar nga re të errëta.

Sahabë si Omeri, të cilët as nuk mund ta mendonin mundësinë e largimit të Profetit nga kjo botë, kishin nxjerrë shpatat dhe bërtisnin:

"Do t'ia pres kokën kujtdo që thotë se ai ka vdekur!"[91]

Ata shpresonin që Profeti i Allahut të kthehej tek ata ashtu siç ishte kthyer Musai nga mali i Sinait. Për këtë arsye, ata hakërreheshin ndaj kujtdo që pretendonte se Profeti kishte vdekur, duke e akuzuar si jo të sinqertë.

[89] Bejheki, *Sunen,* 8/152.
[90] Nesai, *Sunen,* 1/280.
[91] Hejthemi, *Mexhmau Zeuaid,* 9/38.

Kështu, një grup njerëzish shkuan tek Ebu Bekri dhe i shpjeguan se çfarë kishte ndodhur. Ebu Bekri nisi të vraponte si një gazelë. Dukej sikur ai fluturonte dhe turma hapte rrugën për të.

Kur Ebu Bekri u fut në dhomë, pamja e tij ishte aq prekëse, sa dukej sikur trupi i ishte thyer më dysh. Zemra i rrihte aq fort sa dukej se do t'i shpërthente nga kraharori. Ai nuk mund ta mbante më veten dhe përqafonte trupin e pajetë të Profetit. Ai ngriti copën e pëlhurës që mbulonte fytyrën e tij rrezatuese dhe filloi të puthte ballin e tij të bekuar. Me të shpejtë, ai vendosi veshin në gojën e Profetit duke dëshiruar t'ia dëgjonte frymëmarrjen edhe një herë të vetme, por nuk pati asnjë lëvizje. Vërtet, ai ishte një njeri, dhe, si të gjithë njerëzit, i duhej të largohej një ditë nga kjo botë kalimtare. Profeti fisnik ishte nisur drejt përjetësisë. Në kuptimin fizik, ai nuk ishte më me ta.

Si zakonisht, i takonte Ebu Bekrit të merrte nën kontroll situatën kaotike. Ashtu si në ditët e para të Islamit, kur të tjerët i zinte paniku në situata të tilla të papritura, ishte Ebu Bekri i cili i qetësonte ata. Megjithatë, kjo ishte një ditë e jashtëzakonshme. Edhe një herë, të gjitha shpresat ishin tek Ebu Bekri. Ai e vështroi trupin e Profetit Fisnik dhe tha:

"T'u bëfshin kurban nëna dhe babai im! Ashtu siç ishe i bukur gjatë jetës, je i bukur edhe i vdekur! Megjithatë, e provove vdekjen, ashtu siç e kishte shkruar Allahu!"[92]

Më pas, Ebu Bekri tha një pohim, i cili reflektonte interpretimin e një ajeti nga Kurani i Shenjtë: "Është e sigurt që ti do të vdesësh (një ditë), e edhe ata me siguri do të vdesin (gjithashtu)."[93]

Hutimi i fytyrave të Sahabëve ishte drejtuar tek Ebu Bekri. Ata pyetën:

"O mbrojtësi i Profetit të Allahut! Vërtetë ka vdekur i Dërguari

[92] Buhari, *Sahih,* 3/1341.
[93] Zumer, 30.

i Allahut?"

Ebu Bekri tundi kokën i hidhëruar dhe më pas tha: "Po!"

Ebu Bekri dëshmoi të vërtetën. Dielli i shndritshëm që kishte ndriçuar jetën e tyre dhe botën e përtejme, kishte perënduar. Ata vazhduan të pyesnin:

"O miku i dashur i Profetit të Allahut! A ka një namaz për xhenazen e Profetëve?"

"Po!", u përgjigj Ebu Bekri, dhe më pas u tha atyre të vinin me grupe për faljen e namazit të xhenazes. Ai u shpjegonte atyre çdo gjë me detaje. Hap pas hapi, Ebu Bekri shpjegoi se çfarë duhej bërë. Ata kishin aq shumë besim tek ai, saqë ndoqën udhëzimet e tij deri në detajet më të hollësishme. Ata bënin pyetje në çdo fazë të shërbesës:

"O miku i dashur i Profetit të Allahut! A do ta varrosim Profetin?"

"Po!", u përgjigj Ebu Bekri pa hezitimin më të vogël.

Ata pyetën serish:

"Ku do ta varrosim?"

"Në vendin ku Allahu ia mori shpirtin", u përgjigj Ebu Bekri, i cili më pas vazhdoi: "Sigurisht që Allahu ia ka marrë shpirtin atij në një vend të pastër."

Megjithatë, t'i shpjegoje këto çështje pak individëve, nuk mjaftonte. Ishte detyra e tij që të informonte këdo. Ebu Bekri shkoi në xhami dhe foli:

"O njerëz! Më dëgjoni dhe mbani vesh mirë! Kush adhuron Muhamedin, le ta dijë se ai ka vdekur! Por, kush adhuron Allahun me sinqeritet, le ta dijë se Ai nuk vdes kurrë!"

Ebu Bekri e vazhdoi ligjëratën e tij duke recituar këto ajete të

Kuranit: "Muhamedi nuk është tjetër veçse Profet, dhe Profetë të tjerë kanë vdekur para tij. Nëse ai vdes ose e vrasin atë, a do të tërhiqeshit ju? Kushdo i cili tërhiqet, nuk mund ta dëmtojë Allahun, por Allahu do t'i shpërblejë (pa masë) falënderuesit (ata të cilët janë të palëkundur në rrugën e Tij)."[94]

Ndërsa Ebu Bekri recitonte ajetin, shumë prej Sahabëve të pranishëm dëgjonin sikur të ishte hera e parë që u thuhej ky ajet.[95] Ndoshta, ky ishte një ajet të cilin ata e kishin recituar shumë herë gjatë faljeve ose gjatë leximeve të Kuranit.

[94] Al Imran, 144.
[95] Ibn Hibban, *Sahih,* 14/589.

DREJT KALIFATIT

Ndërkohë, muhaxhirët dhe ensarët ishin mbledhur për të diskutuar dhe vendosur se kujt do t'ia jepnin besën pas Profetit. Si fillim u përqendruan në idenë e të pasurit të një lideri nga çdo fis. Sidoqoftë, një mendje e ndritur si ajo e Omerit, e kuptoi se kjo do të sillte përçarje dhe konflikt midis njerëzve. Omeri e dinte se sapo shpatat të nxirreshin nga milli, ato nuk futeshin më lehtë mbrapsht. Ai i bindi të pranishmit se duhet të kishin një lider të vetëm.

Ebu Bekri ishte ftuar me insistim në mbledhje. Sapo u bashkua me të tjerët në mbledhje, Omeri u ngrit në këmbë dhe tha:

"O njerëz të ensarëve! A nuk e dini ju se i Dërguari i Allahut urdhëroi Ebu Bekrin të dilte imam në namaz për të prirë besimtarët? A do të kishte guxim ndonjëri nga ju të dilte para Ebu Bekrit dhe të zinte vendin që vetë i Dërguari i Allahut ka caktuar për të?"

Omeri po u fliste një grupi burrash seriozë dhe të drejtë. Prandaj ata u përgjigjën njëzëri:

"I frikësohemi Allahut dhe kërkojmë mëshirë prej Tij nëse dalim para Ebu Bekrit!"[96]

Ishte një situatë konfuze. Nga njëra anë ishte i Dërguari i Allahut i cili sapo ishte larguar për në botën e përtejme dhe në anën tjetër po diskutohej se kush do të pasonte atë si lider. Me të vërtetë, nga njëra anë ishte dhimbja dhe dëshpërimi i largimit të Profetit dhe nga ana tjetër sfida e ruajtjes së një drejtpeshimi midis besimtarëve. Anija e Islamit duhet të lundronte drejt brigjeve të qeta dhe

[96] Hakim, *Mustedrek,* 3/70.

kjo duhet të bëhej pa shkaktuar dëm në shpirtin e fesë. Natyrisht, në atë kohë duhet të merreshin masa të rrepta në mënyrë që të shmangej përçarja. Vendi bosh i liderit duhet të plotësohej tashmë nga një person i denjë për të. Përndryshe do të vendosë një njeri që nuk e meritonte.

Ebu Bekri mbeti i habitur nga biseda. Ai tentoi të ndërhynte duke thënë se vendi i liderit duhet të zëvendësohej nga një ekspert si Omeri ose Ebu Ubade. Megjithatë, Omer ibn Hatabi nuk e la të fliste gjatë. Me një ton autoritar ai tha:

"Më lejo të të bëj një pyetje," dhe vazhdoi: "I dyti nga ata të dy kur ishin në shpellë dhe ai i tha shokut: 'Mos u mërzit, Allahu patjetër është me ne.'(Teube, 40) Kush është ai që përmendet në këtë ajet? Kush është personi që është nderuar me shoqërinë më fisnike?"

Në këtë pikë, zëra të tjerë e mbështetën Omerin:

"Si mund t'i japim ne besën dikujt tjetër kur midis nesh është një *Siddik* dhe i 'dyti nga ata të dy'?" Për më tepër, fjalët e të Dërguarit të Allahut përsa i përket drejtimit ishin akoma të freskëta në mendjet e tyre:

"Dy personat të cilët duhet të diskutoni pas meje janë Ebu Bekri dhe Omeri."[97]

Në këtë moment të gjithë po mendonin të njëjtën gjë. Rreziku i një konflikti kishte qenë i afërt. Të gjitha çështjet ishin zgjidhur brenda një dite, pa rënë ende nata. Më në fund, Omeri mori dorën e Ebu Bekrit dhe e vendosi mbi të tijën. Kjo do të thoshte se Kalifi i parë i të Dërguarit të Allahut ishte zgjedhur. Pas Omerit, të gjithë erdhën një nga një për t'i dhënë besën Ebu Bekrit. Ky ishte fillimi i një momenti sfidues për Ebu Bekrin. Ai ishte tashmë Kalifi, Kalifi i Profetit të Allahut dhe të gjithë besimtarëve.

Pas betimit Ebu Bekri u ngjit në minberin e mesxhidit. Ky ishte

[97] Tirmidhi, *Sunen,* 5/609.

minberi nga i cili Profeti fisnik mbante ligjëratat para besimtarëve. Ndërsa ngjitej në minber, Ebu Bekri qëndronte në majë të gishtave. Ai mbante një respekt të madh për kujtimin e të Dërguarit të Allahut. Ai ndali në mes të shkallëve dhe filloi t'u flasë njerëzve. Kjo ishte ligjërata e parë për Ebu Bekrin. Ai foli me një zë të butë dhe të ndjeshëm:

"O njerëz! Ju më keni zgjedhur si liderin tuaj megjithëse unë s'jam më i mirë nga ju. Ndaj, kërkoj ndihmën dhe mbështetjen tuaj nëse veproj drejt, dhe të më ftoni në rrugën e duhur nëse shmangem nga ajo. Pa dyshim se drejtësia është një dhuratë e çmuar dhe padrejtësia një formë tradhtie. Me shpresën tek Allahu, më i dobëti nga ju do të jetë më i forti kur unë të mbroj të drejtat e tij. Po ashtu, më i forti nga ju do të jetë më i dobëti kur unë të korrigjoj gabimet e tij. Kini kujdes, askush nga ju nuk duhet të tërhiqet nga përpjekja në rrugën e Allahut. Kujtoni se kush ka neglizhuar në këtë çështje, ka merituar poshtërimin e Allahut. Allahu do të sjellë fatkeqësi të mëdha mbi atë popull ku imoraliteti është shpërndarë lirisht. Bindmuni mua për sa kohë unë i bindem Allahut. Nëse bëj ndonjë gabim në bindjen ndaj Allahut dhe të Dërguarit të tij, atëherë mos m'u bindni!"[98]

Autori i këtyre fjalëve do të ishte më pas ai që do të mposhtte Perandoritë e Persisë dhe të Bizantit. Pozita e lartë dhe rangu, vetëm sa ai kishin shtuar modestinë e tij. Ebu Bekri ishte bërë akoma më i dhembshur tani që kishte mbi shpatulla të gjithë umetin e Profetit Muhamed. Sipas Ebu Bekrit, fuqia nuk jepej për të shtypur të tjerët. Përkundrazi, ajo ishte një barrë e rëndë që duhet të mbahej dhe një detyrë që duhej përmbushur.

Ebu Bekri ishte person tejet i ndjeshëm. Megjithatë, ai ishte gjithashtu një gjeni i cili do të vendoste një sistem të përkryer në një kohë kur bazat e shoqërisë po lëkundeshin nga themelet. Kjo arritje do të përshëndetej me lavdërime të mëdha nga Omeri, i cili

[98] Ibn Hisham, *Siretu Nebeuije,* 6/82.

do të bëhej Kalifi i dytë pas Ebu Bekrit. Sipas dëshmisë së Omerit, Ebu Bekri la pas një rrugë shumë të volitshme për ata që do të vinin më pas.

KUNDËRSHTIM I PAVLERË

Sigurisht, disa vendosën të notonin në ujëra të turbullt. Të pakënaqur me zgjedhjen e Ebu Bekrit si Kalif, ca individë kishin filluar tashmë të mendonin për një zgjidhje tjetër. Një grup i vogël shkoi tek Aliu dhe i thanë:

"Si mund ta lemë këtë punë në duart e individëve më të dobët të kurejshëve?"[99]

Ata po kërkonin një mbështetje për të justifikuar kundërshtimin e tyre. Një personalitet si Aliu mund të shërbente si një sfidë edhe për Kalifin Ebu Bekr. Ata po përpiqeshin me dëshpërim të tërhiqnin vëmendjen e Aliut. Një person provokues shkoi tek Aliu dhe i tha:

"Vetëm prano të bëhesh ti Kalif dhe unë do të vij me një ushtri të madhe me kalorës dhe këmbësorë ta pushtoj Medinën. Unë do të të mbështes deri në fund."[100]

Të gjitha këto tentativa kishin një qëllim të vetëm: dobësimin e Islamit nga radhët e në brendësi. Pa dyshim që kjo duhet të vihej në provë. Pasi dëgjoi të gjitha propozimet dhe sugjerimet, Aliu mori në kontroll situatën dhe tha:

"Ne kemi menduar se Ebu Bekri është personi më i aftë për këtë punë."[101]

Me këtë pohim, Aliu i mbylli të gjitha dyert e përçarjeve dhe

[99] Taberi, *Tarih*, 2/237.
[100] Po aty.
[101] Po aty.

konflikteve.

Në një rast tjetër, kur Aliu ishte përballur përsëri me një propozim të tillë, ishte ndjerë aq i irrituar, saqë kishte dhënë një përgjigje të ashpër:

"I Dërguari i Allahut e urdhëroi Ebu Bekrin të drejtonte namazin! Unë nuk mungoja, por isha në mes tyre! Nuk isha i sëmurë, por i shëndetshëm! Nëse ai do të dëshironte që unë të drejtoja namazin, do të më kishte urdhëruar! Nga vështrimi hyjnor, Allahu dhe i Dërguari i Tij ishin të kënaqur me të, kështu që nga këndvështrimi jonë, ne duhet të jemi të kënaqur gjithashtu."[102]

Ky pohim i prerë i kishte vënë vulën të gjitha pretendimeve për ata që ishin në kundërshtim me vendimin. Pas kësaj, Aliu shkoi tek Ebu Bekri dhe i dha besën.

[102] Ebu Xhafer Taberi, *Rijadu Nadira,* 2/177.

SJELLJA E TIJ NDAJ TRASHËGIMTARËVE

Vajza e Profetit fisnik dhe xhaxhai i tij, Abasi, shkuan tek Kalifi dhe kërkuan trashëgiminë e tyre. Gjendej një copë e vogël toke e cila i përkiste Profetit dhe ata kishin pjesën e tyre në këtë tokë. Megjithatë, kjo ishte kur Profeti ishte akoma gjallë.

Ebu Bekri i donte ata që i kishte dashur Profeti. Nëse do të kishte pasur mundësi, do t'u kishte dhënë gjithçka atyre. Sidoqoftë, kjo ishte një çështje fetare e cila duhet të zgjidhej në bazë të parimeve të fesë. Dispozitat fetare ishin të qarta: Profetët nuk lënë trashëgimi, gjithçka mbetej pas tyre jepet sadaka. Ebu Bekri e kishte dëgjuar këtë nga goja e vetë Profetit, prandaj ai e refuzoi këtë kërkesë menjëherë.[103]

Më vonë ai kërkoi konfirmim për këtë thënie Profetike duke u konsultuar me Omerin, Talhën, Zubejrin, Sad ibn Vakasin dhe Abdurrahman ibn Aufin. Këta persona me peshë në dijet fetare ranë dakord me Ebu Bekrin. Sigurisht që edhe familja e të Dërguarit Fisnik nuk do të kërkonte të përfitonte diçka që nuk i takonte, atëherë, Fatimja u interesua për mundësinë e dhurimit. Ajo i tha Ebu Bekrit:

"Ti e di se, kur ishte gjallë i Dërguari i Allahut, ma pati dhuruar mua këtë tokë. Kjo më bën mua dikë që pranon dhuratën, jo një lypëse."

Ebu Bekri u përgjigj me një argument:

"Po, unë jam në dijeni për këtë. Megjithatë, i Dërguari i Allahut

[103] Muslim, *Sahih*, 3/1381.

të dha një pjesë toke që ishte e mjaftueshme për nevojat e tua. Unë e kam parë atë t'ia shpërndajë pjesën tjetër personave të varfër. Kjo do të thotë se të varfrit kanë të drejta të vazhdueshme mbi atë tokë."

Çështja nuk ishte zgjidhur akoma, kështu që Fatimja erdhi me një propozim tjetër:

"Meqë çështja qëndron kështu, atëherë na lër ta mbajmë tokën dhe të përfitojmë prej saj ashtu siç kemi bërë kur Profeti ishte gjallë."

Ebu Bekri iu përgjigj propozimit të mësipërm me këtë arsyetim:

"Unë nuk besoj se kjo është një zgjidhje. Pas Profetit, është detyra ime të përballem me çështjet e besimtarëve. Unë kam më shumë të drejta se ti, kështu që do të kujdesem dhe të sigurohem që ajo të ndahet në mënyrën më të drejtë, ashtu siç bëhej kur Profeti ishte gjallë."[104]

Sigurisht që kjo nuk ishte një çështje besimi. Ata që ishin të afërt me Profetin, ishin të afërt edhe me Ebu Bekrin, dhe kishin vend të veçantë në zemrën e tij. Sidoqoftë, kjo ishte një çështje private, e cila duhet të rregullohej nëpërmjet rregullave dhe parimeve të fesë. Të drejtat e shoqërisë civile duhet të mbroheshin. Përndryshe, ligjet e fesë do të ndryshoheshin sipas personave dhe eventualisht, nuk do të mbeteshin rregulla në emër të fesë.

[104] Buhari, *Sahih*, 3/1126.

HIXHAZI TRONDITET NGA POLEMIKAT

Sipas dëshmisë së të bijës së Ebu Bekrit dhe nënës së besimtarëve, Aishes, barra e problemeve dhe shqetësimeve që ra mbi të atin kur mori postin e Kalifit, ishte aq e rëndë, saqë po të kishte qenë vendosur mbi malet, ata do të ishin bërë copë e thërrime.[105]

Largimi i Profetit nga kjo botë kalimtare ishte një shans i madh për mendjet e djallëzuara që të fillonin dhe të shpallnin profecinë e tyre të rreme. Në të gjithë krahinën e Hixhazit filluan të dalin profetë të rremë. Gjithashtu kishte njerëz të cilët nuk ishin nënshtruar Islamit plotësisht. Megjithëse ata faleshin si të tjerët, nuk pranuan të japin zekatin. Kishin dalë risi në lidhje me fenë dhe kishin filluar sërish konfliktet midis fiseve të ndryshme. Ambienti ishte mbushur me debate dhe rebelime. Madje, edhe në ditën e ndërrimit jetë të Profetit, filluan thashethemet në lidhje me ushtrinë e Usames të përgatitur nga vetë Profeti. Themelet e bashkësisë islame po rrezikoheshin nga këto përçarje dhe debate.

Pavarësisht nga këto, Ebu Bekri ishte njeriu i duhur për këtë gjendje. Kështu kishte dashur kaderi hyjnor. Allahu i Lartësuar i kishte dhënë atij një pozitë pranë Profetit në mënyrë që ai të ishte i përgatitur për kohë të tilla. Ebu Bekri ishte i pajisur me aftësitë për të qenë një lider dhe për të vendosur një sistem të qëndrueshëm që do të mbronte unitetin e Islamit pas largimit të Profetit. Kjo ishte kaq e qartë, saqë Omeri, vite më vonë, do të ndjehej i detyruar të bënte pohimin e mëposhtëm:

"Kam vënë re se qëndrimi i rreptë i Ebu Bekrit ndaj rebelimit

[105] Ibn Kethir, *El Bidaje uen Nihaje*, 6/304.

dhe trazirave ishte më i efektshëm se i imi. Gjatë qeverisjes së tij, ai kishte bërë aq përpara në edukimin e njerëzve me Islamin saqë unë nuk e pata fare të vështirë t'i administroja ato gjatë qeverisjes sime."

Ibn Mesudi gjithashtu e nderoi Ebu Bekrin me këto fjalë:

"Pas të Dërguarit të Allahut, ne na është dashur të përballemi me shumë incidente shqetësuese. Nëse Allahu nuk do të na kishte dhënë një lider si Ebu Bekri, do të ishim shkatërruar."[106]

[106] Halid Muhamed, *Xhae Ebu Bekr,* fq.89.

ZGJIDHJE VENDIMTARE NDAJ REFUZIMIT TË ZEKATIT

Kishte nga ata të cilët e përdorën largimin e Profetit nga jeta për t'u shmangur nga dhënia e zekatit. Megjithëse këta njerëz vazhdonin të falnin namazet, etja e tyre për pasuri i kishte bërë t'i kthenin shpinën zekatit. Ata deklaruan se nuk do të jepnin më shumën e caktuar të parave. Ndoshta pretendimi i tyre nuk ishte nga fakti që nuk e konsideronin zekatin si detyrim fetar, por sepse mendonin që tashmë ai nuk duhej më, pasi Profeti kishte ndërruar jetë.

Mendja e mprehtë e Ebu Bekrit menjëherë e kuptoi se çfarë fshihej pas një veprimi të tillë, i cili mund të kthehej në një sëmundje për shoqërinë. Lëshimi më i vogël në një rast si ky do të hapte rrugën e kërkesave të reja dhe si përfundim, bashkësia islame do të përmbysej akoma më shpejt se ato para saj. Për këtë arsye, Ebu Bekri, më i vendosur se kurrë, i shpalli luftë këtyre njerëzve. Sahabët si Omeri kundërshtuan:

"Si mund të shpallësh luftë ndaj një grupi që dëshmon se nuk Zot tjetër përveç Allahut dhe se Muhamedi është i Dërguari i Tij?"

Ebu Bekri u përgjigj me deklarimin:

"Edhe po të kishte qenë një litar kapistre dhe të ishte mbledhur në kohën e Profetit, unë gjithashtu do ta mblidhja atë."[107]

Me këtë qëndrim të patundur Ebu Bekri parandaloi një kolaps të bashkësisë. Edhe Sahabët e tjerë të cilët në fillim kundërshtuan, tani po e kuptonin arsyen e vendosmërisë së tij. Ata kishin shkuar tek Ebu Bekri duke pranuar se kishin qenë gabim. Sahabët si Ebu

[107] Muslim, *Sahih,* 1/51.

Hurejre, i cili e kishte parë vendosmërinë e Ebu Bekrit në kohë të vështira, e lavdëroi atë me pohimin e mëposhtëm:

"Nëse nuk do të kishte qenë për Ebu Bekrin, ne do të kishim rënë në kaos dhe nuk do të ishim rimëkëmbur më kurrë."[108]

[108] Ebu Xhafer Taberi, *Rijadu Nadira,* 2/47.

EPISODE TË DALJES NGA FEJA

Një grup njerëzish, besimi i të cilëve ishte i dobët, e shfrytëzuan këtë rast për t'u mbledhur në një vend në periferi të Medinës, të quajtur Dhu'l Kissa. Mes tyre ishin edhe ata të cilët shkaktonin shpesh situata të tilla. Ebu Bekrit i kishin mbërritur fjalë se këta njerëz po planifikonin të shpallnin luftë në Medinë.

Ebu Bekri nuk humbi kohë, mori shpatën dhe u nis drejt atij vendi. Ai ishte aq i shqetësuar, saqë nuk i vinte re njerëzit që ndeshte rrugës. Aliu e kishte kuptuar se kjo nuk ishte një shenjë e mirë. Menjëherë iu vu pas Ebu Bekrit derisa e arriti atë. E mbërtheu kalin e Ebu Bekrit nga frerët dhe bërtiti i zemëruar:

"Ku po shkon, o Kalif i Profetit të Allahut! Më lejo të të kujtoj fjalët që Profeti të tha në ditën e Uhudit: 'Mos na hidhëro ne duke vënë veten tënde në rrezik!' Betohem për Allahun, se nëse të ndodh gjë sot, nuk do të ketë më rregull dhe harmoni në emër të Islamit![109]

[109] Po aty, 2/46.

PROFETË TË RREMË

Mjedisi ishte i përshtatshëm për shtimin e mashtruesve. Disa filluan të pretendonin se ishin profetë dhe se ata kishin të drejtën për të udhëhequr. Një njeri i quajtur Tuhejle pretendonte se ishte profet. Ai i përkiste fisit të Esedit, në të cilin gjeti shumë mbështetje. Për një kohë jo të gjatë, ndikimi i tij kishte mbërritur tek bijtë e Amirit, Huazanit dhe Sulejmit. Shumë njerëz problematikë ishin bashkuar me lëvizjen e tij.

Pak kohë më pas, një grua me emrin Sexhah nga të bijtë e Tamimit, po ashtu pretendoi se ishte profete. Megjithatë, më shumë bujë bënë zërat e ardhur nga Jemame. Një njeri me emrin Musejleme deklaroi profetësinë e tij dhe pretendonte se po i vinin shpallje. Musejleme ishte dikush i cili kishte vetëm kultin e vetvetes. Ai madje kishte shpikur gjëra të paqena duke i paraqitur ato si shpallje. Pjesa e trishtueshme e gjithë kësaj ngjarjeje ishte se ai kishte gjetur një numër të konsiderueshëm mbështetësish. Këta njerëz i ngjanin një kori djallëzor i cili përsëriste vazhdimisht: "Ne ju bindëm Profetit të Allahut për aq kohë sa ai ishte mes nesh. Megjithatë, pas largimit të Profetit, ne nuk do t'i bindemi Ebu Bekrit apo ndonjë shërbëtori tjetër të Allahut."[110]

Ata nuk dëgjonin asgjë veç egos së tyre. Megjithatë, kishte prej atyre të cilët ishin krejtësisht të nënshtruar ndaj Allahut. Ata nuk do të qëndronin të mënjanuar dhe të shihnin sesi këto pretendime false shkatërronin ndërtimin e vërtetë të shoqërisë. Ebu Bekri ishte një prej këtyre njerëzve të guximshëm. Me të shpejtë, ai përgatiti

[110] Halid Muhamed, *Xhae Ebu Bekr,* fq.94.

ushtritë dhe i dërgoi ato në çdo cep të shkretëtirës për t'i asgjësuar.

Ebu Bekri dhe ushtritë e tij ishin shumë të vendosur, dhe kjo ishte e mjaftueshme për të bindur shumë nga ata të cilët largoheshin vjedhurazi prej kësaj detyre. Brenda një kohe të shkurtër, ky problem do të zgjidhej, dhe të gjithë mashtruesit që pretendonin profetësi, do të zhdukeshin.

USHTRIA E USAMES

Ebu Bekri u zgjodh të ishte Kalifi i ri, por ushtria priste tashmë prej disa kohësh urdhrat e tij. Kjo ushtri ishte përgatitur nga vetë Profeti i Allahut gjatë kohës kur ishte ende gjallë. Ai kishte zgjedhur Usamen si komandant të kësaj ushtrie të madhe. Në atë kohë, Usame ishte vetëm 28 vjeç. Ishte e qartë se Profeti dëshironte ta çonte në të katër anët e botës flamurin e Allahut, pavarësisht se së shpejti ai vetë do t'i jepte lamtumirën kësaj bote. Kjo ishte një lutje veprimore e bërë nga Profeti, i cili dëshironte ta përhapte fenë e Allahut në çdo vend ku lindte Dielli. Emri i zgjedhur për këtë mision tregonte se ky synim i shenjtë mund të arrihej vetëm nëpërmjet një njeriu me shpirt të guximshëm si Usame.

Misioni i kësaj ushtrie ishte i qartë. Ata do të marshonin drejt atyre që kishin vrarë të atin e Usames, Zejdin, në betejën e Mu'tes.

Disa njerëz iu drejtuan Ebu Bekrit duke i thënë se ekspedita ushtarake duhet të shtyhej sepse njerëzit ishin akoma në zi për vdekjen e Profetit. Disa thonin se ushtria duhet të qëndronte në Medinë për të zgjidhur mosmarrëveshjet.[111] Kishte madje edhe nga ata që grindeshin sepse Usame ishte shumë i ri dhe se ai ishte i biri i një skllavi të liruar.[112]

Por Ebu Bekri nuk mund të prapësonte me vullnetin e tij një ushtri të përgatitur nga vetë i Dërguari i Allahut. Pasi i uli të gjithë, ai i tha:

"Hapini rrugë ushtrisë së Usames! Betohem për Allah, se edhe

[111] Taberi, *Tarih*, 2/246.
[112] Po aty.

nëse do të më sulmonin ujqërit dhe të më shqyenin, përsëri do ta përcillja këtë ushtri. Unë nuk do të mund të thyeja urdhrin e dhënë nga Profeti i Allahut![113]

Në të vërtetë, ushtria që ishte përgatitur nga Profeti duhet të nisej dhe dëshira e Profetit duhet të përmbushej.

Ata kishin bindur Omerin dhe duke përdorur influencën e tij, donin të shprehnin pakënaqësinë në lidhje me Usamen. Sipas tyre, Usame ishte shumë i ri dhe pa përvojë. Midis ushtarëve kishte Sahabë të vjetër të cilët kishin më shumë përvojë si komandantë. Omeri nuk kishte përfunduar akoma fjalinë kur Ebu Bekri, si gjithmonë i qetë dhe i matur, ndërhyri si një luan i egërsuar. Ai e kapi Omerin nga mjekra dhe i bërtiti:

"Turp të kesh o bir i Hatabit! Si më kërkon të zëvendësoj dikë që vetë i Dërguari i Allahut e ka caktuar në atë detyrë?"[114]

Omerit nuk i mbeti gjë tjetër veçse të heshtte. Vendosmëria e Ebu Bekrit kishte mbyllur një tjetër derë që mund të çonte në konflikte.

Usame me ushtrinë e tij nisën marshimin nga Medina. Ebu Bekri ecte në këmbë ndërsa i përcillte ata. Djaloshi Usame që qëndronte mbi kalë po përjetonte ankth dhe turp njëkohësisht, sepse Kalifi i myslimanëve ecte në këmbë krah tij. Ai i tha Ebu Bekrit të hipte mbi kalin e tij, por Ebu Bekri refuzoi duke bërë me dorë:

"Për Allah, as ti nuk do të zbresësh, as unë nuk do të hipi në kalin tënd. Më lër që këmbët e mia të pluhurosen në rrugën e Allahut, të paktën për pak kohë."[115]

Me siguri, nëse Ebu Bekri nuk do të kishte mbi shpatulla një detyrë të rëndë si ajo e Kalifit, patjetër që do të ishte edhe ai në radhët e ushtrisë së Usames. Detyra që kishte nuk e linte të bash-

[113] Po aty.
[114] Po aty.
[115] Po aty.

kohej me ushtrinë, kështu që të paktën do të tregonte se zemra e tij ishte me ta. Ndoshta ecja për pak kohë në krah të ushtarëve do ta ngushëllonte sadopak shpirtin e Ebu Bekrit.

Kalifi kishte një kërkesë të vogël për komandantin. Ai i kërkoi leje të mbante në Medinë Omerin. Kishte nevojë për ndihmën dhe mbështetjen e Omerit.

"Nëse nuk ka problem, doja që Omeri të qëndronte me mua në Medinë, për ta pasur si mbështetës. Në situatën ku ndodhemi, e shikoj me vlerë që ta kem pranë Omerin."

Faktikisht, Ebu Bekri ishte kalifi i të gjithë myslimanëve, njëherazi edhe i komandantit të ushtrisë. Ai mund ta merrte këtë vendim pa pyetur askënd. Por, edhe në një situatë të tillë të vështirë, ai kërkoi leje nga komandanti riosh që të mbante Omerin në Medinë. Për më tepër, e kishte bërë këtë me sinqeritetin më të madh. Ishte e qartë se nëse Usame do të kishte refuzuar, atëherë Omeri do të shkonte me të.

Megjithatë, Usame ishte rritur në një shtëpi ku mbizotëronte paqja. Ai ra dakord me kërkesën e Kalifit dhe veproi ashtu, me modesti.

Koha e nisjes kishte arritur. Sidoqoftë, ushtarët kishin pritshmëri nga Kalifi. Ata donin këshilla dhe udhëzime në lidhje me strategjinë dhe objektivat e luftës. Ebu Bekri heshti për pak minuta dhe më pas vijoi:

"O njerëz! Qëndroni në vendet tuaja dhe dëgjoni këto 10 këshilla:

- Mos tradhtoni.

- Mos mashtroni askënd.

- Mos trajtoni askënd me padrejtësi.

- Respektoni të vdekurit dhe mos përdhosni kufomat e tyre.

- Mos vrisni gratë, fëmijët apo pleqtë.

- Mos shkatërroni të mbjellat.

- Mos vrisni bagëti apo deve, përveç se kur ju duhen për ushqim.

- Nëse hasni njerëz të përkushtuar pas adhurimit dhe lutjes, lërini të qetë dhe mos i ngacmoni ata.

- Gjithashtu mund të hasni njerëz që do t'ju ofrojnë ushqim dhe pije me enë të ndryshme; mos hani apo pini pa përmendur emrin e Allahut më parë.

- Do të hasni njerëz të cilët duken sikur janë në anën tuaj, por ata do të përpiqen të gjejnë mënyra për t'ju mposhtur dhe planifikojnë shkatërrimin tuaj. Këta janë njerëzit të cilët duhet t'i luftoni deri në fund!"

Ebu Bekri kishte përfunduar porositë dhe ishte kthyer për t'i dhënë lamtumirën. Në fillim i tha: "Nisuni dhe fillojeni udhëtimin me emrin e Allahut!" Pastaj i sugjeroi këtë lutje: "Allahu ju ruajttë nga tirania e armikut dhe nga murtaja!"[116]

Ky ishte ndryshimi midis një njeriu normal dhe një njeriu të edukuar pranë Profetit. Edhe në luftë kishte caktuar rregulla njerëzore. Njeriu duhet të trajtohej si njeri edhe në kushte të tilla, dhe këto rregulla ishin vendosur nga ligjet hyjnore, dhe jo nga ndjenjat njerëzore si urrejtja, armiqësia dhe egoizmi. Sot, ata që ndjekin parimet e humanizmit modern, duhet të kuptojnë se sa larg janë nga horizonti i Ebu Bekrit. Si përfundim, Ebu Bekri i dha lamtumirën ushtrisë dhe u kthye në Medinë për t'u përballur me konfliktet që kishin rrëqethur Hixhazin.

[116] Po aty.

PAQE DHE QETËSI

Brenda një kohe të shkurtër, të gjithë ata që ishin hedhur në kryengritje dhe luftonin me njëri tjetrin, ishin ndalur. Në një farë mënyre ishte vendosur rregulli. Që nga ky moment, Ebu Bekri nisi planet për të arritur një sërë objektivash afatshkurtra dhe afatgjata. Këto objektiva ishin pika të treguara nga i Dërguari i Allahut. Ebu Bekri i mblodhi të gjitha energjitë e tij për këtë qëllim dhe iu përkushtua punës natë e ditë.

Pa dyshim se mbështetësi i tij kryesor ishte Omer ibn Hatabi. Ebu Bekri caktoi Omerin për çështjet e drejtësisë. Konfliktet dhe mosmarrëveshjet ndërmjet qytetarëve të Medinës silleshin përpara Omerit. Drejtësia ishte puna e Omerit dhe ai jetonte me drejtësi. Ndjeshmëria e Omerit për drejtësinë i kishte dhënë atij titullin "*Faruk*", që do të thoshte "diferencuesi i drejtësisë nga padrejtësia."

Kishte kaluar një vit dhe Omeri shkon tek Kalifi dhe kërkon të dorëzojë detyrën. Natyrisht e kishte një arsye, andaj Ebu Bekri e pyeti për arsyen. Përgjigjja e Omerit ishte shumë interesante. Ai u ankua se që nga caktimi i tij në detyrën e gjykatësit para një viti, askush nuk kishte ardhur për të kërkuar zgjidhej për ndonjë çështje.[117]

Dëshmia e Omerit tregoi gjithashtu se njerëzit e përkushtuar sinqerisht në shërbimin e Allahut dhe të Dërguarit të Tij nuk shfaqnin probleme në shoqëri. Arsyeja për këtë ishte se ata kishin jetuar në epokën më të bekuar dhe po bëheshin gati të hynin në epokën tjetër më të bekuar. I Dërguari Fisnik i Allahut një herë

[117] Muhamed Thabit, *Ebu Bekr Siddik,* fq.96.

kishte thënë:

"Njerëzit më të bekuar të të gjitha kohërave janë ata që jetuan epokën time, të ndjekur nga një tjetër dhe një tjetër."[118]

[118] Muslim, *Sahih*, 4/1962.

VËSHTIRËSI EKONOMIKE

Ditët e para të kalifatit të Ebu Bekrit, Omer ibn Hatabi dhe Ebu Ubejde ishin nisur për në shtëpinë e Kalifit për një vizitë. Gjatë rrugës panë dikë që kishte mbi shpinë një rulon basme. Ai kishte veshur rroba të vjetra. Në fillim nuk dyshuan, por papritur dëgjuan një zë që i përshëndeti: "Paqja e Allahut qoftë mbi ju!" Ky ishte zëri i Ebu Bekrit. Të tronditur e pyetën:

"O Kalifi i të Dërguarit të Allahut, ku po shkon?"

Ebu Bekri u përgjigj me zë të ulët:

"Në treg."

Në fakt, Ebu Bekri, një ish-tregtar i pasur, tani përpiqej të fitonte bukën e gojës për të mbajtur familjen. Qëllimi i tij ishte të shiste rulon e basmës. Omeri i tha:

"Ç'punë ke ti në treg, kur e gjithë pesha e rëndë e Kalifatit është mbi ty?"

Ebu Bekri i bëri me shenjë të largoheshin nga rruga. Pastaj i tha:

"Si do t'i ushqej fëmijët e mi?"

Omeri e mori në kontroll situatën duke përdorur logjikën e tij të mprehtë:

"Eja me ne! Do të të caktojmë një rrogë nga thesari i shtetit."

Omeri i mblodhi menjëherë në xhami Sahabët më të rëndësishëm. Në fillim u shpjegoi si qëndronte puna dhe më pas shprehu mendimin e tij mbi këtë çështje. Të gjithë ishin të një mendimi

me Omerin. Caktuan një shumë parash për Kalifin në mënyrë që ai të merrej vetëm me punët dhe çështjet e besimtarëve.[119]

Përpara se të bëhej Kalif, Ebu Bekri kishte disa zakone të cilat ishin kthyer në detyra për të. Ai shkonte në ndihmë të të varfërve, bënte bukë për jetimët dhe kryente punët e atyre që nuk ishin në gjendje të punonin më. Një nga këto punë ishte të milte delet. Ai ndihmonte të vejat të cilave u kishin vdekur burrat në luftë dhe jetimët pa përkrahje financiare.

Pavarësisht problemeve që kishin dalë në Hixhaz, Ebu Bekri vraponte çdo ditë në ndihmë të nevojtarëve. Një ditë trokiti në një derë dhe një vajzë e vogël e hapi atë. Sapo pa Ebu Bekrin aty, i foli së ëmës: "Mami, ka ardhur burri që mjel lopën tonë!"

Gruaja e vjetër doli në derë dhe pa Ebu Bekrin. Ajo u vu jashtëzakonisht në siklet. U kthye nga e bija dhe i bërtiti: "Turp të kesh! Si fole ashtu për Kalifin e besimtarëve?"

Disa pjesëtarë të tjerë të një fisi që kishin dëgjuar për detyrën e re të Ebu Bekrit, po mendonin se kush do t'i kryente punët e tyre tani. Sidoqoftë, Ebu Bekri ishte një njeri i sjellshëm dhe nuk do t'i zhgënjente ata. Kalifi doli përpara turmës dhe u tha:

"Po, unë do të vazhdoj të mjel lopët tuaja. Shpresoj që detyra ime e re të mos më pengojë nga kryerja e këtyre punëve."[120]

Pas kësaj ngjarjeje, Ebu Bekri vazhdoi të milte lopët e tyre për një vit. Ai ishte aq modest, saqë gjatë mjeljes ndiqte udhëzimet që i jepte bariu që ruante tufën. Ebu Bekri, Kalifi i Profetit, nuk e ktheu këtë në një çështje nderi dhe krenarie.[121]

[119] Halid Muhamed, *Xhae Ebu Bekr,* fq. 110.
[120] Ibn Sa'd, *Tabakatul Kubra,* 3/186.
[121] Po aty.

DEVOTSHMËRIA DHE FRIKA NDAJ ALLAHUT

Askush nuk mund të vinte në diskutim devotshmërinë dhe frikën e tij ndaj Allahut. I vetmi shqetësim që kishte ai në jetë ishte kauza e tij. Ai përdori çdo gjë të vetën në këtë kauzë. Pasuritë e kësaj bote, paraja, fisnikëria dhe pozita nuk kishin asnjë vlerë në sytë e tij. Ata nuk mund ta ndryshonin dot Ebu Bekrin, dhe nuk e bënë.

Një ditë ishte shumë i etur dhe i sollën një gotë me ujë. Në ujë i kishin shtuar pak mjaltë. Ndërsa po e kthente gotën për të pirë, ndali dhe zuri të qajë. Po qante aq shumë, saqë edhe të tjerët rreth tij filluan të qajnë bashkë me të. Pas pak, të gjithë pushuan së qari përveç Ebu Bekrit, i cili vazhdonte të qante me zë të lartë. Pati nga ata që menduan se Kalifi do të mbytej nga lotët. Në fakt kjo ishte mënyra më e mirë për të dhënë një shembull. Ai u jepte një mësim përmes veprave. Pasi e mori veten, e pyetën:

"O Kalif i të Dërguarit të Allahut, çfarë të bëri të qash kaq shumë?"

U përpoq të përgjigjej duke rënkuar me dënesë:

"Një ditë, isha ulur me Profetin. Ai papritur filloi të shtynte me dorë sikur refuzonte diçka. Unë nuk shihja se çfarë ishte, kështu që e pyeta: 'O i Dërguari i dashur i Allahut, çfarë po përpiqesh të largosh, pasi unë nuk po shoh asgjë?' Ai m'u përgjigj: 'Ajo ishte Dynjaja, e cila mu shfaq përpara syve. Unë e largova dhe bëra ashtu me duar. Ajo u largua, por u kthye përsëri duke thënë: Edhe nëse ti arrite të më largosh, ata që do të vijnë pas teje nuk do t´ia arrijnë.' M'u kujtua kjo ngjarje dhe pata frikë se Dynjaja kishte gjetur prani

tek unë. Për këtë qava."[122]

Megjithëse ai zotëronte aftësitë për të duruar çdo lloj vështirësie dhe fatkeqësie, ndodhte që ai donte të qëndronte i veçuar me natyrën. Në këto çaste ndjehej i brengosur. Në një nga këto ditë melankolike, pa një zog që qëndronte i lirë mbi pemë. Zogu këndonte dhe hidhej nga njëra degë në tjetrën. Për pak minuta e soditi me admirim. Pastaj tha:

"Qofsh i gëzuar kështu! Sa do të dëshiroja të isha kështu si ty! Sa do të doja të isha një zog si ty, pa përgjegjësi dhe detyrë. Do të doja të qëndroja nëpër degë të ndryshme, të ushqehesha me fruta dhe të fluturoja pastaj."[123]

Një ditë tjetër, kur pesha e përgjegjësisë po i rëndonte shumë mbi shpatulla, pa një pemë. I tha:

"Sa do dëshiroja të isha një trung që të më prisnin dhe të më digjnin."[124]

Atij nuk i pëlqente kur njerëzit i kërkonin të lutej për ta. Sa herë që përballej me një situatë të tillë, hapte krahët dhe lutej:

"O Allah, ti më njeh më mirë sesa unë njoh veten time. Dhe unë e njoh veten time më mirë se sa njerëzit më njohin mua. Më bëj mua të tillë që t'i meritoj këto lutje. Më fal mua për gjërat që ata nuk i dinë. Mos më bëj përgjegjës për atë që thonë ata."[125]

Ata të cilët e dinin që Ebu Bekri ishte shumë i ndjeshëm ndaj këtyre gjërave, i sollën ndërmend fjalët e Profetit fisnik në lidhje me të. Ai nuk ishte kurrë i sigurt për veten e tij. U përgjigj:

"Betohem në Allah! Edhe nëse e shoh veten time me të dyja këmbët në Parajsë, prapë nuk jam i sigurt nëse e meritoj apo jo."[126]

---

[122] Ebu Xhafer Taberi, *Rijadu Nadira*, 2/136.
[123] Bejheki, *Shu'abul Iman*, 1/485.
[124] Po aty.
[125] Ibn Ethir, *Usdu'l Gabe*, 3/324.
[126] Halid Muhamed, *Xhae Ebu Bekr,* fq.113.

Të garoje në një garë për punë të mira ishte në natyrën e tyre dhe kjo jo vetëm për Ebu Bekrin. Omer ibn Hatabi po ashtu i kishte vënë qëllim vetes që do të ndihmonte një plakë të verbër që jetonte në periferi të Medinës. Ai kalonte rregullisht pranë shtëpisë së saj për ta pyetur nëse kishte nevojë për diçka. Sa herë që ai shkonte pranë saj, plaka i tregonte se dikush kishte ardhur para tij dhe ia kishte kryer të gjitha punët.

Omeri i nderuar u bë kureshtar se kush ishte ky njeri që i bënte parapritë çdo herë. Vendosi të shkonte më herët se zakonisht për të takuar të panjohurin. Sidoqoftë ai vinte gjithmonë përpara. Më vonë e kuptoi që ky person ishte Ebu Bekri.

Përballimi i jetesës me rrugë të lejuara ishte jashtëzakonisht e rëndësishme për Ebu Bekrin. Ai do të vinte në rrezik jetën e tij vetëm që një kafshatë e vetme haram të mos kalonte në stomakun e tij.

Një ditë, një shërbëtor i solli Ebu Bekrit një pjatë me ushqim dhe Ebu Bekri e hëngri. Më vonë shërbëtori e pyeti Ebu Bekrin:

"O Kalif i Profetit, a e di nga ka ardhur ky ushqim?"

Për pak sekonda Ebu Bekri u mbush me djersë dhe filloi të dridhej nga frika. Me sa duket shërbëtori dinte diçka. Ebu Bekri pyeti me ndrojtje:

"Nga ka ardhur?"

Shërbëtori nuk kishte zgjidhje tjetër veçse të tregonte të vërtetën:

"Në kohën e injorancës, një burrë më pati kërkuar t'i parashikoja fatin. Unë nuk para merrja vesh nga kjo punë, kështu që e gënjeva. Sot, e takova dhe më dha paratë që më kishte borxh për punën që i bëra. Ushqimi që hëngre ishte blerë me ato para."

Para se shërbëtori të mbaronte fjalën, Ebu Bekri kishte futur gishtat në gojë. Po përpiqej me dëshpërim të villte. Donte të nxirrte gjithçka që kishte ngrënë. Një person që pa gjendjen e Ebu

Bekrit i tha:

"Allahu të mëshiroftë! Po e bën këtë vetëm për një kafshatë ushqim?"

Prijësi i besimtarëve u përgjigj:

"Betohem në Allah! Do të isha gati të jepja edhe jetën për ta nxjerrë këtë ushqim nga stomaku, sepse e kam dëgjuar të Dërguarin e Allahut të thotë: 'Zjarri i Xhehenemit është më i përshtatshëm për trupat që janë ushqyer me haram dhe me të ndaluara.' U frikësova nga ushqyerja me këtë ushqim, andaj e volla të gjithë ç'kisha ngrënë.[127]

[127] Isfahani, *Hiljetul Eulija,* 1/31.

BASHKIMI ME UMU EJMENIN

Profeti fisnik ishte një shembull besnikërie dhe i kishte inkurajuar ndjekësit e tij të silleshin në të njëjtën mënyrë. Ebu Bekri vizitonte vazhdimisht dadon e tij, Umu Ejmenin kur ishte gjallë. Pa dyshim, Ebu Bekri ishte ndër të parët që ndiqte traditën Profetike. Pasi përfundonte punët e përditshme dhe kishte kohë të lirë, ai merrte Omerin si shoqërues dhe shkonte për vizitë tek Umu Ejmeni. Një ditë, ata shkuan tek shtëpia e saj. Sapo pa Kalifin në shtëpinë e saj, filloi të qante. Ajo nuk mundi të përmbahej kur pa sesi këta burra kishin lënë punët e shtetit për të shkuar tek ajo për vizitë. Për më tepër, ata i kujtonin asaj Profetin. Ata e pyetën:

"Pse po qan? Sigurisht të qenit pranë Allahut është më e mirë për Profetin!"

U përpoqën ta qetësojnë, por ajo vazhdoi të qante për pak kohë. Më pas fshiu lotët dhe i tha:

"E di se të qenit pranë Allahut është më e mirë për të Dërguarin e Allahut! Nuk po qaj për të. Po qaj sepse nga qielli nuk po zbret më shpallja Hyjnore."

Si mund të mos prekeshin nga kjo Ebu Bekri dhe Omeri? Ata u bashkuan me Umu Ejmenin dhe filluan të qajnë.[128]

Ebu Bekri thoshte të vërtetën kudo pa hezitim dhe në çdo rast që kishte mundësi përfitonte për të informuar dhe paralajmëruar njerëzit për parimet e fesë. Një ditë po dëgjonte dy persona të diskutonin gjithë pasion rreth disa parimeve fetare. Njëri nga ata

[128] Muslim, *Sahih*, 4/1907.

thoshte se njeriu duhet të zbatojë rregullat e fesë, por nuk duhet të shqetësohet për veprimet e të tjerëve. Ai e mbështeste këtë pretendim me një ajet kuranor.

Një njeri i ndjeshëm në çështjet e fesë si Ebu Bekri nuk mund të qëndronte indiferent në këtë moment ku ishte përfshirë komenti i Kuranit Famëlartë. Megjithatë, ai nuk donte ta kufizonte këtë çështje në një grup kaq të vogël. Ai donte ta analizonte çështjen me të gjithë bashkësinë e myslimanëve. Në fillim përfunduan namazin e drekës dhe më pas iu drejtua njerëzve, duke thënë:

"O njerëz! Është një ajet kuranor të cilin ju po e keqkuptoni ose po e keqinterpretoni: 'O ju të cilët keni besuar! Çdo njeri ka përgjegjësi vetëm për veprat e tij (pra konsideroni pasojat e veprimeve tuaja). Ata që janë të paudhëzuar nuk mund të bëjnë asgjë për t'ju devijuar nga rruga e drejtë nëse jeni vërtetë të udhëzuar.'"

Ebu Bekri u përqendrua në këtë ajet sepse kishte dëgjuar një nga burrat të thoshte se nëse një njeri fal namazet, agjëron dhe jep zekatin, nuk ka pse të shqetësohet për ata që kanë devijuar nga rruga e drejtë. Pretendimi i këtij ishte kundër logjikës se ftesës në Islam, urdhërimit të së mirës dhe ndalimit të së keqes. Ky ishte një shembull i interpretimit të ligjit hyjnor sipas dëshirës njerëzore. Askush nuk ka të drejtë ta bëjë këtë. Urdhërimi i të mirës dhe ndalimi i të keqes është një detyrim fetar për të gjithë. Nëse kjo braktiset, mund të ketë pasoja të rënda për të gjithë shoqërinë. Për këtë arsye Ebu Bekri vijoi të mbante fjalimin me fjalët e dëgjuara nga Profeti dhe tha se nëse njerëzit kalojnë pranë një tirani dhe nuk përpiqen ta ndalojnë atë, duhet të frikësohen se dënimi i Allahut mund të bjerë mbi të gjithë shoqërinë.

"Pastaj ata ngrenë duart duke kërkuar falje, por Allahu nuk e pranon lutjen e tyre tashmë."[129]

[129] Ahmed ibn Hanbel, *Musned*, 1/7.

DY VITE TË BEKUAR

Brenda një kohe të shkurtër prej 2 vitesh si Kalif, Ebu Bekri kishte arritur të zgjidhte çështje shumë të vështira si dhe kishte vendosur bazat ligjore të shtetit që do të zbatoheshin nga Kalifët e tjerë. Arritjet e Ebu Bekrit do të reflektonin mendjen e këtij gjeniu i cili do t'i jepte lamtumirën kësaj bote sapo të përfundonte misionin e tij. Jo vetëm kishte zgjidhur disa çështje të brendshme, por gjithashtu kishte hedhur firmën e tij në shumë nisma dhe fitore që do të mundësonin përhapjen e Islamit në të gjithë botën.

Një nga këto arritje të mëdha ishte mbledhja e Kuranit në një libër të vetëm. Shqetësimi i tij filloi të rritej më shumë kur hafizët e Kuranit, ata që e dinë Kuranin përmendësh, po martirizoheshin. Për këtë ai u këshillua me Omerin për ta mbledhur Kuranin në një libër të vetëm. Omeri ishte dakord dhe ideja e tij u finalizua.

Si rezultat i shumë betejave të zhvilluara në të gjithë rajonin, Iraku u çlirua nga myslimanët, Irani u detyrua të bëjë marrëveshje, rajoni i Damaskut ishte nën territoret myslimane dhe Perandoria Bizantine ishte tundur nga themelet. Të gjitha këto ngjarje kishin ndodhur brenda 2 viteve. Asokohe, Perandoria Bizantine dhe ajo Perse ishin superfuqitë e botës dhe askush nuk kishte guxuar të përballej me to deri në kohën kur Ebu Bekri erdhi në pushtet.

KUR BIE PERDJA

Ndarja nga i Dërguari i Allahut, me të cilin Ebu Bekri kishte kaluar pjesën më të madhe të jetës, kishte qenë e rëndë. Kishin kaluar plot 2 vjet nga ndarja e Profetit nga jeta. Siç fati e kishte caktuar, Ebu Bekri po ndiqte hapat e Profetit të tij. Mosha 63 vjeçare kishte arritur edhe për të.

Sëmundjet po e kapnin njëra pas tjetrës.[130] Ndërsa bëhej gati të nisej në udhëtimin e fundit, shokët i qëndronin pranë shtratit. Kur e kuptuan se gjendja e tij shëndetësore ishte rënduar, i thanë:

"O Kalif i të Dërguarit të Allahut, na lejo të të sjellim një mjek!"

Ebu Bekri u përgjigj me maturi:

"Unë jam konsultuar tashmë me një mjek."

"Çfarë të tha mjeku?", e pyetën.

"Mund të bësh çfarë të duash, je ti që vendos.", u përgjigj Ebu Bekri.[131]

Ishte e qartë se ai kishte marrë ftesën dhe se kishte ardhur koha për t'u larguar. Ai thirri vajzën e tij, Aishen, nënën e besimtarëve, dhe e porositi që të kthente në thesarin e shtetit tepricën e rrogës së tij. Gjithashtu kishte edhe një amanet. Ai donte të varrosej pranë mikut të tij të dashur prej të cilit nuk ishte ndarë kurrë. Porositi të mos i bënin ceremoni pompoze dhe të përdornin rrobat e tij të vjetra si qefinë. Dëshira e tij ishte që trupi të lahej nga e shoqja

[130] Sipas disa transmetimeve, u sëmur nga helmimi i ushqimit. Shih: Ebu Xhafer Taberi, *Rijadu Nadira*, 2/243.
[131] Ibn Sa'd, *Tabakatu'l Kubra,* 3/198.

Esma, e bija e Umejes, dhe djali i tij, Abdurrahmani.

Ashtu siç kishte bërë edhe i Dërguari i Allahut, Ebu Bekri porositi Omerin të printe namazin. Ai kishte caktuar kështu personin tjetër që do të ishte Kalif.[132]

Omeri ishte imami i namazit të tij të fundit.[133] Bekri kishte jetuar një jetë kaq të ndershme dhe me përgjegjësi, saqë kishte refuzuar shpenzimin e parave të fundit nga rroga që i kishin caktuar me gjithë refuzimet e vazhdueshme të tij. Sapo e kuptoi se vdekja po i afrohej, filloi të tregonte shenja frike. Iu kujtua shuma që kishte kursyer. Menjëherë mblodhi të gjithë të afërmit dhe u tha ta dërgonin shumën e parave në thesarin e shtetit. Kishte përdorur vetëm një sasi të vogël për nevoja jetike. Ebu Bekri u tha:

"Omeri nuk më la të refuzoja dhe u detyrova të marr nga thesari i shtetit 6 mijë dirhemë. Kjo sasi është e fshehur në një mur diku. Merrini paratë dhe kthejani Omerit."[134]

Pastaj, Ebu Bekri mori pranë vetes Aishen për të folur. Duke folur me vështirësi i tha:

"Që nga momenti kur kam marrë përsipër detyrën e shërbimit ndaj besimtarëve, nuk kam shpenzuar asnjë dirhem nga paratë e tyre. Përkundrazi, kam jetuar si më i varfëri prej tyre. Kam veshur rroba të vjetra dhe kam vuajtur urinë në shumë raste. Gjithçka që kam është kjo cohë dhe ky shërbëtor që i përkasin shtetit. Merri dhe çoja Omerit."[135]

Pas vdekjes së Ebu Bekrit, Omeri i pa për një kohë të gjatë shërbëtorin dhe cohën e sjellë përpara tij dhe tha:

"Allahu të mëshiroftë o Ebu Bekr! Na ke lënë një detyrë të vështirë neve që jemi akoma gjallë."[136]

[132] Ebu Xhafer Taberi, *Rijadu Nadira,* 2/242.
[133] Po aty, 2/241.
[134] Ibn Sa'd, *Tabakatu'l Kubra*, 3/193.
[135] Po aty, 3/196.
[136] Po aty.

Vajza e Ebu Bekrit, Aishja i shpjegon kështu momentet e fundit të babait të saj:

"Kur babait tim i ra të fikët nga rëndimi i sëmundjes, unë i recitova një poezi: 'Pavarësisht sa përpiqet dikush të fshehë lotët, pa dyshim ata do të rrjedhin një ditë.' Kur babai u përmend, më tha: 'Mos thuaj ashtu bija ime! Duhet të recitosh këtë varg: Dhe dhimbja e vdekjes vjen me të vërtetë. Kjo ishte o njeri ajo që përpiqeshe t'i shpëtoje.'" (Kaf, 19).

Dhe pastaj e pyeti:

"Cilën ditë ndërroi jetë i Dërguari i Allahut?"

"Ishte e Hënë", u përgjigja.

Ai vazhdoi të pyeste:

"Çfarë dite është sot?"

"E Hënë!"

Kur dëgjoi përgjigjen time, tha:

"Shpresoj në Allahun të mos shoh një natë tjetër pas kësaj!"

Edhe një herë pyeti:

"Me sa qefinë ishte mbështjellë atë ditë?"

"Ne e mbështollëm me 3 pëlhura të bardha nga *Sahulja*! Ai nuk kishte këmishë apo çallmë."

Pastaj tha:

"Laje rrobën time sepse ka një njollë në të dhe merr edhe 2 copa të tjera."

Unë do t'i thosha që copa e tij ishte ngrënë nga krimbi, kur ai ndërhyri:

"Nuk ka rëndësi. Të gjallët kanë më shumë nevojë për rroba të

reja sesa të vdekurit. Për më tepër, qefini i të vdekurit do të kalbet shpejt.[137]

Pikërisht atë ditë, Ebu Bekri fluturoi drejt botës shpirtërore. Ai kishte ndërruar jetë në të njëjtën ditë dhe në të njëjtën moshë si i Dërguari i Allahut. Diferenca e moshës midis Ebu Bekrit dhe Profetit ishte plotësuar nga 2 vitet e kalifatit. Fjalët e fundit të Ebu Bekrit ishin:

"O Allah, ma merr shpirtin si mysliman dhe më bashko me të drejtët."[138]

Kjo ishte lutja e Profetit Jusuf, i cili përjetoi gëzimin e bashkimit me të drejtët pas një jete plot vështirësi.

Medina kishte shpërthyer në lot kur lajmi u bë i ditur. I gjithë Hixhazi po përjetonte ditë të ngjashme me ato pas vdekjes së Profetit. Kur dëgjoi lajmin, Aliu shpërtheu në lot dhe vrapoi për tek shtëpia e Ebu Bekrit. Qëndroi gjithë respekt pranë shtratit të Ebu Bekrit dhe tha:

"Allahu të mëshiroftë o Ebu Bekr! Ti ishe figura e liderit të Islamit, shembulli më i mirë i besimit, një njeri që i frikësohej shumë Allahut dhe ai që mbajti peshën më të madhe mbi shpatulla se gjithë njerëzimi. Pas Profetit, askush nuk ishte më i sinqertë se ty dhe askush nuk ishte më i ndjeshëm ndaj shokëve sesa ti.[139]

[137] Ebu Xhafer Taberi, *Rijadu Nadira,* 2/240.
[138] Ebu Xhafer Taberi, *Rijadu Nadira,* 2/242.
[139] Hejthemi, *Mexhmau Zeuaid*, 9/48.

TRASHËGIMIA E TIJ

Burri i cili dikur kishte qenë tregtari më i dëgjuar i Mekës dhe një njeri të cilin Mekasit e respektonin deri në përulje, Ebu Bekr besniku, Kalifi i Profetit, kishte lënë pas një deve për qumësht, një shërbëtor dhe një tas për të futur qumështin.[140] Këto ishin gjithçka që kishte mbetur nga gjërat e tij. Megjithatë, titulli Ebu Bekr "Sidiku" do të ishte i tillë që askush nuk do ta arrinte deri në ditën e gjykimit.

Tashmë Ebu Bekri kishte shkuar pranë Allahut dhe Profetit dhe Omeri, veziri i dytë ishte Kalifi i ri. Pikë së pari i sollën gjërat e Ebu Bekrit tek Omeri. Gjendej një enë e madhe argjile që kishte brenda diçka. Nuk kishin zgjidhje tjetër veçse ta thyenin për të parë se çfarë kishte brenda. Sapo e thyen, paratë u shpërndanë nëpër tokë. Kur pa këtë, Omeri nuk u përmbajt dot dhe tha me lot në sy: "Allahu të mëshiroftë o Ebu Bekr! Nuk ke lënë asnjë fjalë për ata që do të vijnë pas teje. Tani jam unë personi që do të marr përgjegjësinë e kësaj detyre."[141]

Kjo ishte mënyra se si Omeri e vuri veten në detyrë. Ai e kuptoi se duhet të ishte jashtëzakonisht i kujdesshëm në marrjen përsipër të postit nga një njeri i cili kishte shërbyer me përpikërinë më të madhe dhe që i kishte diskutuar çështjet në detajet më të vogla. Sipas Omerit, arritja e një ndjeshmërie kaq të madhe ishte pothuajse e pamundur.

Pas vdekjes së Ebu Bekrit, Omeri shkoi tek shtëpia e tij dhe foli me gruan e tij, Esma bint Umejes. Ai e pyeti për jetën fetare të burrit të saj në detaje. Ajo i shpjegoi si më poshtë:

[140] Ibn Sa'd, *Tabakatu'l Kubra,* 3/196.
[141] Ebu Xhafer Taberi, *Rijadu Nadira,* 2/245.

Ai ngrihej para agimit dhe merrte abdes. Pastaj falte namazin. Ai falej shumë. Më pas lexonte Kuran dhe qante. Ai gjithashtu qante në sexhde gjatë namazeve. Në këto raste unë ndjeja një erë që ngjante si mëlçi e pjekur.

Omeri, ndërsa dëgjonte fjalët e përmalluara të Esmës, u prek. Ai filloi të qante bashkë me Esmën duke i thënë: "Si mund ta krahasosh veten me një shërbim si ky, o bir i Hatabit!?"

JETA FAMILJARE

Familja e Ebu Bekrit kishte disa cilësi të cilat nuk i posedonte asnjë familje tjetër. Familja e tij kishte qenë shkaku i zbritjes së ajetit kuranor që i lejonte myslimanët të merrnin tejemum kur nuk kishte ujë për abdes. Pas zbritjes së këtij ajeti, Usejd ibn Hudejri tha:

"Pa dyshim, ky nuk është i vetmi bekim i ardhur mbi familjen e Ebu Bekrit".[142]

Midis Sahabëve, familja e Ebu Bekrit ishte e vetmja që kishte namin për 4 breza myslimanësh. Kjo ishte arritur përmes Abdurrahmanit dhe Esmës.

Siç dihet, Ebu Bekri është martuar 4 herë në kohë të ndryshme. Nga këto martesa ai pati 6 fëmijë.

Gruaja e tij e parë ishte Katila bint Abduluza. Ebu Bekri e divorcoi atë gjatë kohës së injorancës. Pas divorcit, ajo erdhi për të vizituar vajzën e saj Esma me disa dhurata. Esma i refuzoi dhuratat dhe u përpoq ta ndalte të futej në shtëpi. Pas incidentit, Katila i tha Aishes të fliste me Profetin për të gjetur një zgjidhje për çështjen. Më vonë, ajetet kuranore treguan se këto lloj marrëdhëniesh ishin të lejuara në kohë paqeje.[143]

Pas Katilas, Ebu Bekri u martua me Umu Ruman bint Amir, e cila ishte nëna e Aishes dhe e Abdurrahmanit. Umu Rumani e kishte pranuar Islamin përpara martesës me Ebu Bekrin. Ajo i kishte dhënë besën Profetit në Mekë. Umu Ruman ndërroi jetë në

[142] Buhari, *Sahih,* 1/27.
[143] Mumtehine, 8.

vitin e gjashtë të hixhretit.

Pas Umu Rumanit Ebu Bekri u martua me Esma bint Umejs. Ajo ishte e veja e Xhafer ibn Ebu Talibit i cili kishte rënë shehid në luftën e Mu'tes. Nga kjo martesë Ebu Bekrit i kishte lindur djali më i vogël, Muhamedi. Esma ishte ndër gratë e para që kishte pranuar Islamin. Ajo ishte bërë myslimane përpara se Profeti të hynte në shtëpinë e Ibn Erkamit. Ajo gjithashtu ishte në grupin e personave që emigruan në Abisini, ku kishte shkuar bashkë me bashkëshortin, Xhafer ibn Ebu Talib.

Gruaja e fundit që u martua me Ebu Bekrin ishte Habibe bint Harixhe. Ajo ishte nga fisi hazrexh i ensarëve. Habibja ishte shtatzënë në kohën kur vdiq Ebu Bekri. Ajo lindi më vonë një vajzë që e quajti Umu Kulthum.

Abdurrahmani ishte fëmija më i madh. Ai pranoi Islamin ditën e Hudejbijes. Përpjekjet e tij gjatë emigrimit ishin të jashtëzakonshme. Ai shoqërohej me idhujtarët gjatë ditës dhe më pas informonte ata që do të niseshin për emigrim për të rejat më të fundit në Mekë. Ai ra shehid nga një shigjetë në ditën e Taifit. Në atë kohë Ebu Bekri ishte Kalif.

Djali i Ebu Bekrit, Muhamedi kishte lindur ditën e Hutbes së Lamtumirës. Ai e humbi të atin në moshën 3 vjeçare. Muhamedi u rrit nga Aliu. Më vonë ai ishte emëruar si guvernator i Egjiptit dhe atje ra shehid.

Vajza e madhe e Ebu Bekrit, Esma, të cilës Profeti i kishte vënë titullin "Dhunitakajn" gjatë emigrimit të shenjtë, ishte martuar me Zubejr ibn Avamin. Nga kjo martesë lindi Abdullah ibn Zubejri. Esma ishte e vetmja grua shtatzënë gjatë emigrimit. Ajo ishte e para muhaxhire që lindi në Medinë. Për këtë, Abdullah ibn Zubejri ishte fëmija i parë i palindur akoma që kishte emigruar. Esma vdiq në vitin e 73 të hixhretit. Ajo ishte e njohur për bujarinë e saj.

Nëna jonë Aishja, bashkëshortja e të Dërguarit të Allahut, ndërroi jetë në vitin e 57 të hixhretit.

Përpara se Ebu Bekri të ndërronte jetë kishte folur me Aishen për Umu Kulthumin, vajzën që nuk kishte lindur akoma. Ai e këshilloi Aishen për pjesëtarët e familjes: "Këta janë vëllezërit dhe motrat tuaja." Aishja nuk po e kuptonte se ç'donte të thoshte i ati dhe e pyeti: "E di se kush janë vëllezërit dhe e di se Esma është motra ime, por kush qenka motra tjetër?"

Ebu Bekri i kujtoi Aishes Harixhen. Ajo lindi një vajzë, ashtu siç kishte thënë Ebu Bekri. Më vonë Umu Kulthumi u martua me Talha ibn Ubejdullahun.

Është e qartë se midis Sahabëve të tjerë, familja e Ebu Bekrit qëndron lart me cilësi të dallueshme. Edhe ndërmjet Sahabëve nuk gjendet një i dytë si Ebu Bekri. Ai është i vetmi, babai, nëna dhe fëmijët e të cilit ishin të gjithë myslimanë. Për më tepër, 4 gjenerata të familjes së tij ishin takuar me Profetin duke marrë gradën e Sahabëve. Ebu Bekri kishte arritur këtë përmes 2 degëve të familjes:

1. Abdullah ibn Zubejri dhe nëna e tij Esma, Ebu Bekri dhe babai i tij Ebu Kuhafe.

2. Muhamedi, i biri i Abdurrahmanit i cili ishte djali i parë i Ebu Bekrit dhe Ebu Bekri dhe babai i tij Kuhafe.

Si përfundim, mund të themi se Ebu Bekri ishte një person i cili u ngrit nga tregu i qytetit në rangun e Kalifit. Arritjet dhe rangu i lartë në të cilin u ngjit e bënë atë një shembull të paharrueshëm për të gjithë ata që do të pasonin.

Mënyra e jetesës së tij gjithmonë në progres dhe përmirësim të vetvetes duhet të merret parasysh dhe të ndiqet nga të gjithë. Ai ishte një model qëndrueshmërie që kurrë nuk tha, "Mjaft kam bërë." Ai ishte në një garë për të bërë gjithnjë e më shumë. Në

rrugën e të drejtëve u përpoq deri në fund pa hezitimin më të vogël dhe frikën se mos humbiste nga pasuria e tij.

Ka vetëm një gjë që mund të themi për ata që e shikojnë Ebu Bekrin me zili: "Asnjëherë nuk është shumë vonë! Ndoshta ju kurrë nuk do të jeni si Ebu Bekri, por më ndihmën e Allahut, ju mund t'i shërbeni Islamit ashtu si Ebu Bekri dhe të mbaheni mend në përjetësi."

Për ta arritur këtë, në fillim duhet të keni qëllimin, të ndjekur nga një aksion i përjetshëm…

JETA E SAHABËVE

Ebu Bekri radijallahu anhu mund të merret shembull si njeriu që arriti majat midis Sahabëve. Që nga çasti kur u takua me Profetin Fisnik paqja qoftë mbi Të!, Ebu Bekri u bë një model për njerëzimin. Historia magjepsëse e jetës së tij fillon në tregun e qytetit. Një jetë në përpjekje të pandërprerë, e cila do ta ngrinte atë në rangun e Kalifit. Këmbëngulja, qëndrueshmëria dhe lavdia e Ebu Bekrit shërben si burim frymëzimi për të gjithë myslimanët e sotëm.

ISBN: 978-9928-156-06-8

9 789928 156068

PRIZMI

Çmimi: 400 Lekë / 4 Euro